monumentet



DO NOT COPY

19, 1980

DO NOT COPY

Kopertina e parë: Pamje nga fshati Vuno – Vlorë.

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E KULTURËS
INSTITUTI I MONUMENTEVE TË KULTURËS
TIRANË

DO NOT COPY

monumentet

19, 1980

PASQYRA E LËNDËS

Faqe

ARTIKUJ

Emin RIZA

– Arkitektura e banesës popullore – në zonën e «Bregut të Detit» (Labëri) 3

Apollon BAÇE

– Banjat e shekujve të parë të erës sonë në Shqipëri. 51

Aleksandër MEKSI, Pirro THOMO

– Arkitektura pasbizantine në Shqipëri. 89

Leonard SULI

– Restaurimi dhe arkitektura e dy banesave në fshatin Sopot. 117

Koço ZHEKU

– Teknika dhe materialet e ndërtimit në muret rrethues të qyteteve Ilire të njohura në vendin tonë. 131

DO NOT COPY

DO NOT COPY

TABLES DES MATIERES

Pages

ARTICLES

Emin RIZA

– L'architecture de l'habitation populaire dans la zone de «Bregu i Detit» (en Laberi). 3

Apollon BAÇE

– Les bains en Albanie pendant les premiers siècles de notre ère. 51

Aleksandër MEKSI, Pirro THOMO

– L'Architecture postbyzantine en Albanie (Les églises à nef unique). 89

Leonard SULI

– La restauration et l'architecture de deux habitations dans le village de Sopot. 117

Koço ZHEKU

– La technique et les matériaux de construction des murs d'enceinte des villes illyriennes connues à ce jour dans notre pays (Des efforts en vue d'un réexamen du problème). 131

Emin RIZA

ARKITEKTURA E BANESËS POPULLORE NË ZONËN E «BREGUT TË DETIT» (LABËRI)*)

Ky artikull mbyll paraqitjen tërësore të vlerave në fushën e banesës popullore në Krahinën e Labërisë, pas dy artikujve të mëparshëm mbi banesën popullore në Kurveleshin e Sipërm, dhe mbi disa njësi të tjera etnografike të kësaj krahine[1]. Materiali është mbledhur gjatë dy ekspeditave të kryera nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, në kuadrin e gjurmimit dhe dokumentimit të ndërtimeve fshatare në mbarë vendin[2]. Në këtë artikull përfshihet dhe materiali i grumbulluar në fshatin – rrënojë të Tragjasit dhe në fshatin Dukat, të cilët megjithëse nuk përfshihen në zonën e Bregut të Detit, siç emërtohet kjo nga vendasit, përsa i përket banesës paraqesin afëri të dalluara qartë me të deri aty rreth mesit të shek. XIX.

Zona e Bregut të Detit bën pjesë në njësinë e madhe etnografike, krahinën e Labërisë. Qendrat e banuara të kësaj zone, në shumicën e tyre fshatra, janë të vendosura në pjesën perendimore të lartësive që shtrihen thuajse paralel bregut të Detit Jon, që prej qafës së Llogorasë e deri në Sarandë, në lartësi 300-600 m. Trualli është në përgjithësi i ashpër, pa tokë buke, por me kullota të mira. Klima e butë mesdhetare ka favorizuar kultivimin e ullinjve, agrumeve krahas vreshtarisë që është mjaft e përhapur.

Këto kushte kanë ndikuar në të kaluarën për krijimin e një ekonomie të larme, në të cilën krahas blegtorisë, (përjashtim bëjnë fshatrat e Tragjasit e Dukatit ku mbisundonte ekonomia blegtorale) një vend jo pa rëndësi të zinte kultivimi i ullinjve, agrumeve e vreshtarisë, me atë pak tokë që i merrej me shumë mund natyrës së ashpër, nëpërmjet tarracimesh. Deti ka luajtur një rol me rëndësi në jetën ekonomike të kësaj zone, jo vetëm për peshkim, por dhe si rrugë ndërlidhjeje me zonat e afërta, që prej

+) Rilevimet janë të autorit, B. Penxhës, L. Lazimit dhe S. Terezit, vizatimet të B. Penxhës dhe F. Zarshatit.

1) E. Riza, **Banesa popullore në Kurveleshin e Sipërm,** Monumentet 9/1975, E. Riza, **Banesa popullore në fshatrat e rrethit të Vlorës,** Monumentet 15-16, 1978.

2) Gjatë ekspeditës së parë të kryer në vitin 1976, u gjurmuan fshatrat: Tragjas, Dukat, Palasë, Dhërmi, Qeparo, Himarë, Borsh, si dhe rrënojat e ndërtimeve jashtë mureve të kalasë së Sopotit. Gjatë ekspeditës së dytë, të vitit 1979, u gjurmuan fshatrat: Vuno, Pilur, Kudhës, Piqeras, Lukovë, Përparim (Shën Vasi) dhe Nivicë Bubar.

DO NOT COPY



Fig. 1

7 ishujve e deri në brigjet perendimore të Italisë së Jugut. Shumë familje kishin varkat e tyre me të cilat transportonin kryesisht produktet e frutikulturës dhe olivikulturës.

Varfëria e vendit bënte që krahas emigracionit ekonomik mjaft banorë për një pjesë të vitit të pajtoheshin në punë të ndryshme veçanërisht në ishujt e afërt. Mjetet e thjeshta të lundrimit, nuk kërkonin ngritjen e porteve të mirëfillta, por të tillë kishte Himara, e cila deri aty nga shek. XVIII si kryeqendër e zonës, mbi një truall të fortifikuar, kishte tiparet e qytetit. Më vonë ajo shkallë-shkallë, humbet rëndësinë e saj, duke u kthyer thuajse në një qendër fshatare, siç tregojnë ndërtimet e saja që ruhen ende. Me interes është dhe një port i vogël (fig. 1) i fshatit Vuno, në qendrën e një gjiu të bukur[3]. Kjo ekonomi e larme e dallonte qartë këtë zonë nga pjesa e brendshme e Labërisë, ku siç dihet mbisundonte ekonomia blegtorale.

Burimet e ujit të pijshëm nuk janë të shpërndara barazisht në qendrat e banuara të kësaj zone. Kështu krahas fshatrave me burime të mjaftueshme si Dhërmija, ka qendra si Vunoi, e Himara ku për sigurimin e ujit të pijshëm janë ndërtuar stera të cilat grumbullojnë ujrat që rrjedhin prej mbulesës së çatisë. Të njohura janë dhe sterat e ndërtuara diku në tokat e punueshme, të cilat grumbullonin ujrat sipërfaqësore, që pastaj përdoreshin për vaditje.

Zona e Bregut të Detit, në pragun e pushtimit turk, ka qenë mjaft e populluar. Disa të dhëna burimore lejojnë që të krijohet një ide e dinamikës së vendbanimeve gjatë periudhës së sundimit osman. Sipas regjistrit fiskal të vitit 1431-32, zona në shqyrtim paraqitet mjaft e dendur me vendbanime, shumë prej të cilave janë zhdukur në rrjedhje të kohës, për arsye të ndryshme. Këto qendra të banuara luhatnin nga 2 banesa, si fshati Kamati, deri tek qendra e Himarës me 134 banesa. Prej qendrave të banuara që përmenden në këtë regjistër[4], del se Dukati, Palasa, Vunoi, Himara, Piluri, Kudhësi, Qeparoja, Borshi, qendra e Sopotit, Kokni (varoshi i Sopotit), dhe Lukova, kanë ekzistuar pra të paktën që në shek. XIII. Sipas një të dhëne të vitit 1531[5] përmendet veç të tjerash dhe Aios Baziles (Shën Vasia) Heliates (mundet Iliasi pranë Dhërmisë) dhe Picernates (mundet Piqerasi). Në vitin 1693[6] përmendet krahas djegjes së Shën Vasisë dhe ajo e Nivicës nga turqit. Dhërmia në këtë vit është një qendër e zhvilluar me 1850 banorë, ndërsa Himara me 1430 banorë, Vunoi me 660 banorë dhe Piluri me 500 banorë, pra kanë një rritje të ndjeshme në krahasim me gjendjen e tyre në vitet 1431-32 (duke llogaritur një familje me 5 banorë). Në vitin 1721[7] ndeshim Piqerasin me drejtëshkrimin e saktë, Pichierosi, krahas

3) Porti i Vunojt formohet nga një bankinë me mur guri, e cila ka në të dy krahët shkallë. Përbri saj janë ndërtuar dy magazina, nga të cilat ajo e veriut është më e vona. Në gjendjen e sotme, deti është larguar, duke formuar një plazh të gjërë përpara skelës së vjetër. Ndërtimi i kësaj skele të vogël që i shërbente një fshati të vetëm, është mjaft domethënës për peshën e marëdhënjeve me zonat përtej detit, në jetën e këtyre qendrave. Të dhënat gojore tregojnë dhe për ndërtimin e një porti të vogël, që i shërbente fshatit Dhërmi.

4) H. Inalçik, **Suret-i Defter-i Sancak-i Arvanid, Ankara** 1954 dok. 1, 59, 60, 86.

5) N. Borgia, **I monaci basiliani d'Italia in Albania,** Roma 1942, 21.

6) N. Borgia, **Vep. Cit.** 49.

7) N. Borgia, **Vep. Cit.** 133.

DO NOT COPY

Hundëcovës, dhe Lëkurësit. Për vetë karakterin e përmendjes në vitet 1581, 1693 dhe 1721, këto data nuk mund të formojnë kurrsesi të dhëna të sigurta se në këtë kohë, apo më parë nuk kanë ekzistuar qendra të tjera, duke përfshirë dhe ato të përmendura në datat e mëvonëshme.

Vendbanimet e zonës së Bregut të Detit janë ndërtuar mbi troje të ashpër shkëmborë, asnjëherë në buzë të detit. Sipas formës së truallit mbi të cilën ngrihen, vendbanimet zenë pjerrësinë, me shtrirje disa herë në formë harku si Dhërmija (fig. 2) Vunoi (fig. 3) e Nivica, lartësi kodrash apo rrafshe malore si Himara (fig. 4), Qeparoi (fig. 5) e Piluri, ose ndjekin terrene kurrizorë me shtrirje karakteristike si Kudhësi, Lukova e Piqerasi. Kompaktësia e ndërtimeve, lidhja e përsosur me truallin dhe vendosja e shkallëzuar e ndërtimeve, bëjnë që ato të shfaqen qartë, pa mbluar njera tjetrën, duke dhënë kështu ansamble piktoreske e dinamike.

Në rjedhje të kohës vendbanimet nuk kanë pësuar çvendosje të shumta. Me sa njohim lëvizje ka pësuar fshati Pilur, i cili më parë ka qenë në një pjerrësi poshtë vendbanimit të sotshëm, siç tregojnë rrenojat. Vendosja në truallin e ri është bërë për arsye mbrojtëse duke parpëlqyer rrafshinën e lartë me pozitë më të mirë, megjithëse rrihet ashpër nga erërat e veriut. Çvendosje ka pësuar në fillim të shekullit tonë dhe fshati Borsh duke u vendosur pranë kalasë së Sopotit, prej ngulimit të parë në jug-perendim të fshatit Fterrë, siç tregojnë rrënojat. Për tu shënuar është fakti se rrënojat



Fig. 2



Fig. 3

DO NOT COPY



Fig. 4



Fig. 5



Fig. 6

e Borshit të vjetër, në dallim nga fshati i ngjeshur i Bregut të Detit, paraqesin një shtrirje relativisht të gjërë me dendësi të vogël ndërtimesh.

Nga pikpamja urbanistike, siç përmendëm, qendrat e banuara të Bregut të Detit i karakterizon kompaktësia e madhe e ndërtimeve, e cila siç duket përveç nevojës për mbrojtje kolektive, është kushtëzuar në disa raste nga synimi për të kursyer pakë truall, që mund të kultivohej. Ndërtimet shumë afër njëri tjetrit, kanë krijuar një rrjetë të dendur rrugor, i cili përgjithësisht ndjek vijat e niveleve, ashtu si dhe vetë banesat, por krahas tij ndeshen dhe rrugë me pjerrësi (fig. 6) shpesh me shkallëzime, që ndërlidhin arteriet kryesore, thuajse horizontale, apo me pjerrësi të vogël. Dendësia e madhe e ndërtimeve, ka bërë që në mjaft raste të ngrihen banesa edhe mbi rrugë duke siguruar kalimin nëpërmjet qemeresh cilindrike. Shembujt më me interes në këtë drejtim i ndeshim në Vuno (fig. 7) dhe Himarë (fig. 8). Përgjithësisht qemeri zhvillohet në një drejtim të vetëm dhe në të njëjtën lartësi nga rruga, ndërsa në Vuno ku kjo praktikë është e përhapur gjërësisht ndeshen dhe zgjidhje me qemere, që kanë lartësi të ndryshme gjatë zhvillimit të tyre, për të ruajtur lartësinë e nevojshme për kalim, në rrugën që ngjitet. Një shembull tjetër të rrallë në këtë fshat, paraqet kryqëzimi i dy qemereve cilindrike, mbi kthesën e një rruge. Rrugët janë të shtruara me kalldrëm, duke pasur zakonisht kunetën e kullimit të ujrave në aksin e rrugës, për të mos ju dhënë lagështi ndërtimeve anash rrugës. Shpesh, kur pjerrësia e rrugës është e fortë ajo ndërtohet në formë shkallësh. Për të lehtësuar kalimin në kthesat e forta, qoshet e ndërtimeve zbuten me thyerjen karakteristike. Shembullin e vetëm të kanalizimit të ujrave të zeza e ndeshim në Vuno. Kanalet prej pllakash guri, mbuluar po me to sipër, ndjekin aksin e rrugës.

Ashtu si në mbarë Labërinë dhe në fshatrat e Bregut të Detit, ndeshen lagjet në bazë vëllezërie. Përveç banesave që përbëjnë masën mbizotëruese të ndërtimeve, takohen dhe ndërtime kulti. Këto të fundit ndërtohen zakonisht jashtë fshatit, në vende dominuese, duke mos marrë pjesë në pamjen e vendbanimit. Por të shpeshta janë dhe rastet kur këto ndërtime përfshihen brenda ansambleve të banuara.

Aty nga fundi i shek. XIX fillojnë të duken dhe shtëpitë-dyqane, si dhe dyqanet, të cilët shtohen gjatë fillimit të shek. XX. Për tu përmendur në këtë drejtim janë Dhërmia e Vunoi. Mullinjtë e drithit ndërtoheshin zakonisht jashtë qendrave të banuara, pranë burimeve të ujit, ndërsa mullinjtë e vajit vendosen dendur në katojt e banesave të ndryshme.

Banesa përbën elementin kryesor, ndërtimor për

DO NOT COPY

DO NOT COPY

të mos thënë të vetmin. Ajo rrethohet gjithmonë me mure, por ngushtësia e truallit ka bërë që shpesh banesa të dalë me një, dy apo tre faqe në rrugë, madje dhe me pamjen kryesore. Kështu, pamja e rrugëve të këtyre fshatrave është shumë e pasur dhe e larme. Orientimi i banesave, si i të gjithë ndërtimeve në troje të aksidentuar është i detyruar prandaj krijohen ansamble shumë dinamike që veshnin pjerrësinë e trojeve shkëmbore. Megjithë terrenin e vështirë, në saj të punës së palodhur, banorët kanë krijuar një gjelbërim të dëndur, veçanërisht me pjergulla e fiq. Kështu në stinët e vegjetacionit gjelbërimi luan një rol me rëndësi në pamjen e këtyre qëndrave. Shpesh pjergullat në formë tënde mbulojnë rrugët, duke fituar hapësirë, dhe duke krijuar kështu hije për kalimtarët.

Ambientet ndihmës jashtë banesës, për vetë natyrën e ekonomisë së fshatrave të kësaj zone kanë qenë të pakta. Ndër to për tu përmendur janë furrat, ndërsa gjurmë lëmenjsh nuk kemi ndeshur.

Kuptohet se banesa, përbën njësinë themelore ndërtimore të kësaj zone. Në dallim nga pjesa tjetër e krahinës së Labërisë, zona e Bregut të Detit, (me përjashtim të fshatrave të Tragjasit e Dukatit) duke filluar aty rreth gjysmës së dytë të shek. XIX, përfshihet në rrymën e disa koncepteve të reja, si në aspektin kompozicional ashtu dhe në atë të trajtimit të elementeve të ndryshme arkitektonikë. Kjo dukuri është e një thellësie dhe shtrirje të tillë, që bën të nevojshme studimin e banesës në dy njësi të mëdha: në banesën që prej fillimeve të njohura, pra rreth shek. XIV, e deri aty rreth mesit të shek. XIX, dhe në banesën e periudhës që prej rreth gjysmës së dytë të shek. XIX e deri rreth çerekut të parë të shek. XX. Njësia e parë do të ndahet në dy grupe: banesa pa tipare mbrojtëse, dhe banesa me tipare mbrojtëse. Grupi i parë me përjashtim të trajtimit të dëshmive më të hershme, të cilat me që janë tepër të pakta do të jepen siç janë gjetur, do të trajtohet sipas klasifikimit tipologjik në banesat përdhese, me gjysmëkat perpendikulare, të kombinuara, me kat, pastaj do të trajtohen rastet e veçanta si dhe komplekset ndërtimore, që zakonisht janë formuar në faza të ndryshme ndërtimi. Grupi i banesave të fortifikuara do ndahet në: kulla dhe banesa me kullë (duke e përdorur termin kullë, të cilin e përdorin dhe vendasit, si sinonim të banesës së fortifikuar).

Sipas kësaj ndarje, e cila ka në bazën e saj kriterin tipologjik, po kalojmë në analizën e llojeve të ndryshme të banesave duke mos lënë pas dore, aq sa lejojnë të dhënat, kronologjinë dhe shpërndarjen e tyre.

Dëshmitë më të herëshme të banesave. Kur flasim për dëshmitë më të hershme të banesave, kemi



Fig 7



Fig. 8

DO NOT COPY





Fig. 9



Fig. 10

parasysh rrënojat e ruajtura deri më sot mbi sipërfaqen e tokës, kurse gërmimet arkeologjike mund të japin dëshmi të shumta e mjaft më të lashta.

Nga gjurmët e banesave të vjetra, një vend të rëndësishëm madje jo vetëm për zonën në shqyrtim, paraqesin rrënojat e disa banesave pranë mureve rrethues, në juglindje të kalasë së Sopotit. Me shumë gjasë ato i përkasin, varoshit të qendrës së banuar brenda mureve rrethues të kalasë së Sopotit, e cila në vitet 1431-32 numëronte 60 zjarre. Varoshi sipas K. Lukës[8] emërtohej në regjistrin fiskal të përmendur, me emërtimin Kokni dhe kishte në këtë kohë 14 zjarre. Po ky autor përpos identifikimit na jep riprodhimin e një harte të Koronelit, ku shihet qartë varoshi në fjalë. Lidhur me mendimin se Varoshi nuk mund të shtrihej fare afër kështjellës së Sopotit, sepse vendi është shumë i pjerrët[9], vërejmë se rrënojat flasin qartë se aty është ndërtuar, duke kompozuar ndërtimin me thyerje në volum, pikërisht për t'iu përshtatur kësaj pjerrësie.

Numëri i banesave të përmendura që ruhen në gjendje rrënojë është i vogël, me përjashtim të njërës, ndërtuar me teknikën e muraturës lidhur me llaç gëlqereje, të tjerat janë ndërtuar me teknikën e murit të thatë. Prej këtyre të fundit njera (banesa Nr. 1), ruan muraturën në lartësi deri 1,5 m, duke lejuar ndjekjen e formës planimetrike. Ashtu si gjithë të tjerat, ajo (Tab. I) është kompozuar në volum me gjysmëkat, duke iu përshtatur kështu terrenit të pjerrët shkëmbor.

Ambienti i poshtëm (2,75 x 4.40) ka hyrje të veçantë (71 cm) e cila mbulohet nga një gur i vetëm (185 x 68 x 22 cm). Në muraturë ruhet një kamare.

8) Kolë Luka, **«Gjurmime të toponomastikës mesjetare në trevën e Sopotit»,** Etnografia Shqiptare, VIII/1976, 165, 167, 168.

9) Kolë Luka, **Art. cit.** 167.

Ambienti i sipërm, i banueshëm, duket se ka qenë një volum i vetëm (6,55 x 4.40 m). Shkallë të jashtme guri, një rampshe të çonin në hyrjen e këtij ambienti. Në faqen fundore të tij gjejmë kamaren (fig. 9) karakteristike pranë vatrës, ndërsa anash, në mënyrë jo simetrike dhe me përmasa të ndryshme janë ndërtuar tre kamare të zakonshme. Gjurma e një kamareje të katërt, ruhet në pjesën e sipërme të murit jugperendimor. Përngjitur po këtij muri zhvillohet një kontur i mbyllur murature, që të le të mendosh se kemi të bëjmë me ambientin sanitar. Teknika me gurë të thatë është realizuar me gurë të punuar trashë, me përjashtim të një punimi më të mirë të qosheve. Arkitrarët e dyerve dhe kamareve janë njëgursh (fig. 9). Muratura nuk është punuar me rreshta, në të janë përdorur gjërësisht gurët e vegjël horizontalisht dhe vertikalisht. Banesa Nr. 2 (Tab. I, Fig. 10) gjithashtu në varoshin e Sopotit, paraqet një arritje më të zhvilluar nga ana teknike, ndërsa kompozimi volumor i saj përsërit atë të banesës Nr. 1, pra është me gjysmëkat. Nga ana teknike, ajo dallon për teknikën e murit të gurit me llaç gëlqereje dhe përdorimin e qemerit cilindrik, që mban sheshpushimin e shkallëve të jashtme që të çojnë në katin e banuar. Përmasat relativisht të mëdha të katit të banuar (9,25 x 4.60 m) të lejojnë të mendosh për ndonjë ndarje me materiale të lehtë në volumin e katit të banuar. Në faqen fundore gjejmë dy kamare, por jo kamaren karakteristike të vatrës. Të dy këta shembuj tregojnë për banesa të thjeshta që kanë ngjashmëri të qartë me ato të Kamenicës[10]. Lidhur me datimin e këtyre rrënojave, duhet mbajtur parasysh mospërmendja e varoshit (Kokni) në vitin 1507, e natyrisht më 1533[11], të cilat të shtyjnë ti datosh këto si të shek. XIV-XV.

Siç përmëndëm banesat pa tipare mbrojtëse të Bregut të Detit i kemi ndarë: në banesa përdhese, me gjysmëkat perpendikulare, të kombinuara dhe me kat, ndërsa veças do të trajtohen rastet e veçanta si dhe komplekset. Përpara se të kalojmë në parashtrimin e materialit faktik, po japim tiparet kryesore të ambienteve formuese të banesës dhe pikërisht të: shtëpisë së zjarrit, odës së miqve dhe katoit. Këta tre



Fig. 11

ambiente, i gjejmë në variantet më të përhapur të banesës së Bregut të Detit, por natyrisht ka dhe variante të thjeshtë me një ambient të vetëm, apo dhe me më shumë se këta, duke u shtuar përgjithësisht numëri i ambienteve të banuarë.

Shtëpia e zjarrit, është ambienti kryesor i banesës, i cili e ndjek atë gjatë gjithë kohës, duke u zhvilluar vetë ai drejt një trajtimi përherë e më të përparuar. Ky ambient, në variantet e thjeshtë ka funksione qëndrimi, gatimi dhe fjetje, ndërsa në të zhvilluarit, ai humbet pjesërisht ose plotësisht funksionet e qëndrimit dhe të fjetjes. Elementi kryesor i tij është

10) A. Meksi, E. Riza, **«Ndërtimet në fshatin rrënojë të Kamenicës** Monumentet 7-8/1974.

11) K. Luka, **Art. Cit.**

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 12



Fig. 13

vendi i zjarrit, vatra. Shembujt e hershëm të këtij elementi pranë kalasë së Sopotit, tregojnë se ai ndizej në vatër pranë murit fundor, duke qenë përbri vatrës, kamarja karakteristike. Krahas vatrës pranë murit fundor, kujtesa popullore përmend vatrat rreth mesit të shtëpisë së zjarrit. Mënyra e parë ka gjetur zbatim dhe gjatë shek. XIX, siç tregojnë mjaft shembuj. Mungesa e banesave të datuara, nuk lejon të vendoset në kohë përdorimi i oxhakëve me tambur, por dihet se gjatë shek. XIX, ai është përdorur gjërësisht, veçanërisht në odat e miqve. Vendosja e vatrës në shtëpinë e zjarrit ka diktuar përkujdesjen për vendosjen e këtij ambienti drejtpërdrejt mbi trualli, për të mënjanuar rrezikun e zjarrit. Për këtë arsye në banesën mjaft të përhapur me gjysmëkat perpendikulare, shtëpia e zjarrit vendoset gjithmonë në pjesën përdhese të katit të banuar, ndërsa në disa raste, dyshemeja e padjegshme arrihet me ndërtimin e qemereve cilindrikë. Shtëpia e zjarrit është pa tavan, me ndriçim të pakët dhe e paisur zakonisht me kamare e dollapë muri. Në banesat e gjysmës së dytë të shek. XIX shtëpia e zjarrit pëson ndryshime. Ajo në banesat me kat ndërtohet në katin përdhe, e paiset me tavan dhe oxhak me tambur.

Oda e miqve, ose thjesht oda, kronologjikisht është ambienti i dytë i banuar. Vendi i zjarrit me oxhak së pari ka hyrë në këtë ambient, i cili zakonisht ka pasur tavan.

Katoi është një element i zakonshëm i banesës në të gjitha variantet e banesës me përjashtim të asaj përdhese. Katoi zakonisht shërbente për strehimin e kafshëve të ngarkesës dhe bagëtive. Kur pjesa e katoit, nën shtëpinë e zjarrit ndërtohej me qemerë cilindrikë, atëhere në disa raste, njëra, apo të dyja volumet nën qemer shërbenin si depozita produktesh blegtorale e bujqësore. Zakonisht së brendshmi prej katoit me shkallë të thjeshta druri kalohej në shtëpinë e zjarrit apo në odë. Në banesat e gjysmës së dytë të shek. XIX, katoi nuk ndërtohet më. Zakonisht ambientet e katit përdhe përdoren për banim, ose rrallë për vendosjen e mullinjve të vajit.

Tremat e hapura janë një shfaqje tepër e rrallë në banesën e Bregut të Detit, ku mbizotëron banesa e mbyllur. Dhe në këto pakë raste ato janë në forma të thjeshta dhe me përmasa të vogla. Sterat janë të njohura dhe ndërtohen zakonisht brenda volumit të banesës. Ambientet sanitare ndërtohen jashtë volumit të banesës, përjashtim bëjnë fshatrat e Tragjasit e Dukatit.

Banesa përdhese. Ndërsa në pjesën tjetër të Labërisë kjo banesë është pak e përhapur, në zonën e Bregut të Detit ajo ndërtohet shumë rrallë. Në gjendjen e sotme shembuj të tillë mezi gjenden aty këtu. Ata janë një, apo dy kthinash me hyrje drejtpërdrejt nga jashtë dhe portikun karakteristik në ballë, që mbron hyrjen.

Banesa me gjysmëkat perpendikular. Koncepti i gjysmëkatit, ashtu si në mbarë Labërinë është i përhapur dhe në banesat e Bregut të Detit, sepse përgjithësisht trualli mbi të cilin ngrihen ato është i pjerrët. Megjithëse ky koncept ndeshet në banesa me kompozime të ndryshme, ai shfaqet më qartazi në banesën me gjysmëkat përpendikulare. Kjo banesë e thjeshtë, zakonisht me dy kthina banimi, me hyrje të veçanta dhe shkallë të jashtme guri, ndërtohet



Fig. 14



Fig. 15

DO NOT COPY

në të gjitha fshatrat e Bregut të Detit. Përshtatja terrenit, numëri i mjaftueshëm i ambienteve dhe familjarizimi i gjatë me të, kanë kushtëzuar këtë parapëlqim të dukshëm për këtë lloj banese, e cila siç përmendëm ndërtohet në këto treva që në shek. XIV, e sigurisht dhe më lashtë.

Banesa e kombinuar. Me banesë të kombinuar do të kuptojmë banesën e formuar nga dy njësi, prej të cilave njëra është përdhese ndërsa tjetra me kat. Kjo banesë përbën një lloj jashtëzakonisht të rrallë në këtë zonë, ashtu si në mbarë Labërinë. Një shembull me interes të kësaj zgjidhje e takojmë në banesën Nr. 3 (Tab. II, fig. 11) në fshatin Vuno. Ajo ka një shtrirje të theksuar horizontale, e cila thyhet nga pjesa me kat, në krye të ndërtimit. Pjesa me kat, nuk ndërlidhet së brendshmi me tre ambientet përdhes, prej të cilëve ai pranë volumit dykatsh është ambient gatimi, ndërsa dy të tjerët, katoj. I tillë është dhe ambienti nën ambientin e banimit të katit. Të pesë ambientet kanë hyrje të drejtpërdrejtë nga jashtë, me dyer mbuluar së jashtmi me hark guri. Kalimi në ambientin e katit, arrihet me shkallë guri dyrampëshe, duke qenë e dyta mbi një qemer cilindrik. Nuk kuptohet pse ai nuk është normal me ballin e banesës. Oda, në kat me dritare të pakta, nuk shquan për ndonjë karakteristikë për tu shënuar, përveç numërit relativisht mjaft të madh të frengjive për pushkë, që kontrollojnë truallin përreth. Ambienti i gatimit, në njerin kënd ka të ndërtuar një furrë.

Banesa me kat. Kjo banesë përbën llojin më të përhapur, apo më saktë mbizotërues në tipologjinë e banesës së Bregut të Detit. Ajo ndërtohet zakonisht me një, dy dhe tre ambiente banimi, përveç ambienteve të pabanuara të katit përdhe. Varianti me dy ambiente banimi është ai më i përhapuri. Më poshtë po japim shembujt më tipikë të kësaj banese në zonën që trajtojmë.

Llojin më të thjeshtë të banesës me kat, e përbën banesa me një ambient banimi, e cila ndeshet rrallë. Banesa Nr. 4 (Tab. II) në fshatin Tragjas (sot ruhet vetëm muratura) është një shembull tipik i kësaj zgjidhje. Ajo formohet nga ambienti përdhes, i pabanuar dhe ambienti i katit, i banuar. Në katin e banuar të çojnë shkallë të jashtme guri të cilat përfundojnë me një platformë relativisht të gjerë, që mbështetet në dy qemere cilindrikë paralelë. Mbyllja me muraturë e ballit përkundrejt shkallëve, tregon qartë se këtu kemi të bëjmë me një lloj çardaku të vogël, zgjidhje kjo e njohur në Labëri. Kalimi në katua arrihet nën njërin nga qemeret e çardakut. Organizimi i katoit paraqet një zgjidhje të veçantë, që ndeshet rëndomë në fshatrat e Bregut të Detit, ndërsa shumë rrallë në pjesën tjetër të Labërisë. Një pjesë e mirë e volumit të këtij ambienti mbulohet nga dy qemere cilindrike paralele. Kjo zgjidhje është diktuar nga nevoja për të krijuar dyshemenë e padjegëshme rreth vendit të zjarrit, i cili duket se ka qenë një vatër diku rreth qendrës së ambientit (mungesa e kanalit të tymit, apo kamares në mur, pranë vatrës të shtyjnë në këtë mendim). Njëri prej volumeve mbuluar me qemer, është i mbyllur rreth mesit të tij, duke pasur aty një derë kalimi. Ky fakt provon vërtetësinë e të dhënave gojore, sipas të cilave volumi mbuluar me qemer përdorej dhe për depozitimin e rezervave ushqimore, veçanërisht për kohën e dimrit,

praktikë e përhapur gjerësisht në të kaluarën jo vetëm në fshat, por madje dhe në qytet. Ndërlidhja së brendshmi me ambientin e katit ka shumë mundësi të ketë qenë, siç e ndeshim rëndomë në këto kompozime. Ambienti i banuar, është tepër i thjeshtë, siç përmendëm, vatra duket se ka qenë rreth qendrës së ambientit, duke bërë të padyshimtë mungesën e tavanit. Për të shënuar është ndërtimi i ambientit sanitar, që del si volum më vete, me ndërlidhje të drejtpërdrejtë me odën.

Një shembull tjetër të banesës me kat me dy kthina paraqet banesa Nr. 5 (Tab. III, fig. 12) në la-



Fig. 16

gjen brenda mureve rrethues të Himarës (më tutje për këtë lagje do të përdorim thjeshtë emërtimin Himarë). Ajo paraqet një ndërtim kompakt, ku të bie veçanërisht në sy organizimi i katoit, i cili pjesërisht mbulohet nga dy qemere cilindrikë me formuese normale njëra tjetrës. Një pjesë e tij është krejtësisht në mbushje, ndërsa vetëm një volum i vogël mbulohet nga dyshemeja e drurit e ambientit të banuar. Me interes është dhe zgjidhja e volumit të shkallëve të jashtme, i cili shtrihet përtej qemerit, që lejon hyrjen në katua, për të krijuar platformën mbi të cilën është ndërtuar furra. Banesa mbulohet me çati dyujshe. Fillimisht hyrjet për në katua dhe në odë, kanë qenë në faqen ku sot është ndërtuar tymari, por çvendosja e tyre nuk ka prurë ndryshime që të prekin konceptin kompozicional të ndërtimit.

Një shembull tjetër me interes i këtij lloji është banesa Nr. 6 (Tab. III, Fig. 13) po në Himarë. Ajo mund të konsiderohet dhe me gjysmëkat, meqë pjesërisht pranë vendit të zjarrit (oxhaku është ndërtuar më vonë) ajo është përdhese. Zgjidhje me interes në këtë banesë paraqet një lloj çardaku i vogël, në murin anësor të të cilit është ndërtuar një sqoll. Sheshi i tij mbahet nga një mur mbajtës normal pamjes kryesore. Për tu shënuar është se shembujt me kat dykthinësh të Himarës, në dallim nga ata në qendra të tjera të banuara të Bregut të Detit, në zhvillimin planimetrik i afrohen katrorit.

Ndërtimet e ngjeshura në fshatrat e kësaj zone, kanë detyruar shpesh daljen e banesës me një apo dy pamje në rrugë. Madje në disa raste dhe hyrja kryesore e saj, del në rrugë. Në variantet e thjeshta të banesës me kat, të cilëve i mungon ambienti ndërlidhës i divanit, ku mund të zhvilloheshin shkallët për në kat (kjo kryesisht sepse kati përdhe është i pabanuar), shpesh ndeshet një zgjidhje interesante kompozicionale, e cila qëndron në ndërtimin e një kalimi brenda volumit të katit përdhe. Ky kalim zakonisht mbulohet me qemer cilindrik. Pas këtij kalimi, me shkallë nga pjesa e prapme e banesës kalohet në kat.

Zgjidhje të tilla takohen dhe në banesën qytetare shqiptare. Një zgjidhje tipike, sipas këtij kompozimi, paraqet banesa Nr. 7 (Tab. III) në fshatin Qeparo. Vendin kryesor në katin përdhe e zë volumi i katoit, ndërsa përbri tij është ndërtuar qemeri, që mbron kalimin nga rruga në oborr. Një qemer i dytë, normal me të parin, si dhe një hapësirë mbuluar me dysheme druri krijojnë mbështetjen për në çardak, që zhvillohet paralel me aksin gjatësor të banesës. Formulimi arkitektonik i dritareve si dhe i tamburit të oxhakut në ambientin e banimit, të shtyjnë të mendosh se ndërtimi i banesës duhet ti përkasë fundit të shek. XIX, apo fillimit të shek. XX.

Shembujt me kat, me dy kthina banimi, janë mjaft të përhapura në këtë zonë. Ata i përgjigjeshin mirë nevojave jetësore të banorëve. Banesa Nr. 8 (Tab. III, fig. 14) në fshatin Tragjas (sot rrënojë), paraqet një zgjidhje mjaft të përhapur në zonën e Bregut të Detit. Ajo ka një kompozim të shtrirë, duke pasur një katua të vetëm në katin përdhe, dhe dy ambiente banimi në kat. Nyjet sanitare, një për secilin ambient dalin anash volumit prizmatik të banesës. Blloku i shkallëve, përmban si zakonisht qemerin cilindrik, nën të cilin kalohet në katua. Qemeret çifte, për të siguruar dyshemenë e padjegëshme zhvillohen gjatë gjithë sipërfaqes së shtëpisë së zjarrit, ndërsa në odën e miqve, ato kanë një shtrirje të vogël pranë oxhakut. Ky fakt tregon sheshit për funksionin e këtyre qemereve, lidhur me krijimin e shtresës së padjegëshme. Katoi nuk ka asnjë hapësirë ndriçimi. Në katin e banesës, ambientet kanë hyrje të veçantë nga jashtë dhe ndërlidhje së brendshmi. Katarahu (shuli i sigurimit) i derës së katoit, nuk le

DO NOT COPY

DO NOT COPY

dyshim për ndërlidhjen e brendshme të të dy kateve. Shtëpia e zjarrit, ka qenë me zjarr në mes, qenja e një dritareje të vetme dhe ajo mjaft e vogël të bën të mendosh për qenjen e baxhasë. Oda e miqve, e ka vendin e zjarrit me oxhak, anash të cilit janë dy dritare të vogla. Për të penguar kalimin e tymërave të shtëpisë së zjarrit në odë, muri ndarës tërthor, përfundon me kallkan. Dollapet e murit dhe kamaret i gjejmë në të dy ambientet e banimit.

Një rëndësi të veçantë në tipologjinë e banesës me dy kthina banimi, e zë banesa Nr. 9 (Tab. IV fig. 15) në Himarë. Arsyet janë dy: datimi i saj, relativisht i hershëm më 1782 dhe pozicioni i saj karshi rrugës. Për të shfrytëzuar truallin e kufizuar brenda mureve rrethues të fortifikimit, kjo banesë, ashtu si dhe disa të tjera, është ndërtuar pjesërisht mbi rrugë, duke ngritur mbi të një qemer cilindrik, i cili mundëson kalimin nën të. Banesa sot është e ndryshuar në katin e banuar, por gjendja fillestare arrihet duke pasur parasysh gjurmët ekzistuese si dhe dëshmitë gojore të cilat plotësojnë njëra tjetrën. Në plan banesa nuk ka formë të rregullt drejtkëndëshe, për shkak të pjerrjes në plan të murit të djathtë, anësor. Volumi nën qemer, që i përket rrugës, e ka ndarë funksionalisht katin përdhe në dy njësi, dy katoj me hyrje nga faqe të ndryshme. Katojt nuk kanë ndriçim, me përjashtim të atij nga krahu i majtë, të cilit dy rreze drite i hyjnë vetëm nga dy dritare në formë frengjije. Katoi i djathtë ka pranë murit kufizues me rrugën çiftin e qemerëve cilindrikë. Kati i banuar formohej nga dy ambiente banimi, shtëpia e zjarrit djathtas dhe oda majtas. Vendi i zjarrit ka qenë pranë murit fundor, mbi njërin prej qemereve të katoit, duke pasur pranë kamaren tipike. Hyrjet për në ambientet kanë qenë të veçanta, duke pasur dhe ndërlidhje ndërmjet tyre. Dritaret e vogla mbuloheshin me hark gjysëm rrethor, ashtu si dhe dyert e katoit.

Banesa me tre kthina banimi është një ndërtim relativisht i rrallë në këtë zonë, por shembujt nuk mungojnë. Në zhvillim planimetrik, kjo banesë përgjithësisht merr formën e shkronjës L, sepse ambienti i tretë është një shtesë normal njërit ambient të bllokut kryesor. Ky i fundit është në të vërtetë banesa tipike me dy kthina banimi, pra në këtë zgjidhje nuk vinë ndryshime në konceptin kompozicional por thuajse kemi një shtesë numerike të një ambienti të ri. Shkallët e gurta mbeten të jashtme, ndërsa sheshi ndërlidhës për të tre ambientet veçse zmadhohet pak.

Shembullin tipik të kësaj zgjidhje e jep banesa Nr. 10 (Tab. V, fig. 16) në fshatin Tragjas (sot rrënojë). Kati përdhe ka një katua të vetëm, ndërsa dy volumet e tjera janë të mbushura. Në katin e banuar të tre ambientet kanë hyrje të drejtpërdrejtë nga jashtë, pa ndërlidhje së brendshmi. Në qendër është vendosur shtëpia e zjarrit, me vatër në mes, ndërsa në të dy krahët e saj dy oda me oxhakë dhe përkatësisht me ambient sanitar të veçantë.

Një zgjidhje më të përparuar të banesës me tre kthina banimi paraqet banesa Nr. 11 (Tab. V) në fshatin Vuno. Ashtu si dhe shembulli i Tragjasit, kati përdhe ka vetëm një katua, ku ka qenë vendosur një mulli vaji, ndërsa dy volumet e tjera janë në mbu-



Fig. 17

shje. Ambientet e banuara të katit (më vonë kanë pësuar disa ndryshime, që kanë prekur kryesisht ritrajtimin e ballit të odës që del me një faqe në rrugë, duke ndërtuar në të dhe një ballkon) janë vendosur si në banesën Nr. 10, por hyrja për në shtëpinë e zjarrit, që zë vendin qendror, është e ndërmjeme. Një arritje më e përparuar se shembulli i Tragjasit, duhet mbajtur çardaku relativisht i gjërë, i cili ngri-



Fig. 18

het mbi dy qemere, i pari i shfrytëzuar si sterë uji, ndërsa i dyti si hapësirë kalimi për në katua. Një sterë e dytë është ndërtuar në oborr, rast ky që ndeshet dhe në banesa të tjera të fshatit Vuno. Më vonë banesës i është shtuar një ambient gatimi, në një kënd të të cilit është ndërtuar furra. Siç u parashtrua, në dy shembujt e fundit koncepti i gjysmëkatit, në kompozimin volumor ka një zbatim të gjërë.

Zgjidhjet e veçanta. Krahas tipologjisë së zakonshme, e cila përbën shumicën dërmuese të zgjidhjeve, ashtu si kudo edhe në zonën e Bregut të Detit ndeshen kompozime, që paraqesin zgjidhje të veçanta. Këto zgjidhje në radhë të parë janë kushtëzuar nga funksioni, por dhe terreni në disa raste ka ndikuar në kërkim të zgjidhjeve të pazakonta. Këta shembuj janë gjithashtu një provë e aftësive krijuese të mjeshtrave popullorë, për të cilët familjarizimi me tipologjinë e zakonshme nuk ishte pengesë për kërkime dhe arritje jashtë saj. Vetkuptohet se në këto zgjidhje të veçanta e reja duhet kërkuar kryesisht në kompozim dhe jo në programin e banesës.

Një nga shembujt më me interes të një kompozimi të rrallë, ndikuar kryesisht nga ngushtësia dhe pjerrësia e truallit paraqet banesa Nr. 12 (Tab. VI, fig. 17) në Himarë. Volumi ballor i saj ngrihet mbi rrugë, duke siguruar lirinë e kalimit nëpërmjet një qemeri cilindrik, relativisht të gjatë. Për të shfrytëzuar pjerrësinë e terrenit të fortë shkëmbor, i cili me vështirësi mund të përpunohet, koncepti i gjysmëkatit është zbatuar gjërësisht, duke dhënë thyerje të theksuara volumesh dhe zhvillimin në lartësi të banesës, pjesërisht dy dhe pjesërisht tre katësh. Qemeret dhe harqet janë përdorur gjerësisht në këtë banesë, duke zgjidhur me mjeshtëri probleme konstruktive që lindnin nga kushtet e veçanta të truallit të ndërtimit.

Siç përmendëm banesa është e kompozuar me gjysmëkat. Kati përdhe, dyshemeja e të cilit është thuajse në nivelin e shtresës së rrugës formohet nga volumi i sterës në ballë dhe një lloj parahyrje mbuluar me dy qemerë cilindrikë, në vazhdim të njëri tjetrit, por me hapësira të ndryshme. Stera është një ndërtim i mëvonshëm, ndërsa fillimisht, krejt volumin e katit përdhe e zinte katoi. Trualli i aksidentuar, si dhe sipërfaqia mbi qemerin në formë tuneli, që mbulon rrugën, ka lejuar zgjerimin e katit të parë, i cili pjesërisht është përdhes. Volumi i shtuar nga shfrytëzimi i terrenit ndahet nga një mur gjatësor, duke u mbuluar volumi i parë me qemer. Podiumet e gurit në pjesën fundore të tyre, flasin qartë për funksionin e qilarit për rezerva ushqimore. Shkallë druri të çojnë në katin e dytë, i cili gjithashtu zgjerohet në krahasim me katin nën të. Kati i dytë, i vetmi i banuar, ka



Fig. 19

DO NOT COPY



Fig. 20



Fig. 21

nji planimetri të ngjeshur, pak a shumë me konfiguracion që i afrohet katrorit. Ndërmjet dy ambienteve fundore, respektivisht djathtas shtëpia e zjarrit, ndërsa majtas një ambient gatimi me furrë, është lënë një rruginë ndërlidhëse për të mënjanuar kalimin nga një ambient në tjetrin. Por kompozimi i ngjeshur ka çuar në mbylljen e ambientit përbri shtëpisë së zjarrit, tek i cili kalohet nëpërmjet dy ambienteve që e rrethojnë. Banesa, ka pësuar një rindërtim i cili ka prekur formulimin arkitektonik të ballit të banesës, ku janë hapur dy dyer për të shfrytëzuar ballkonin shtuar me këtë rast.

Kjo banesë është një shembull me të vërtetë i arritur i lidhjes me truallin, që mund të gjejë paralele në shfrytëzimin e terrenit vetëm me shembujt e shquar në këtë drejtim në lagjen Mangalem, të qytetit-muze të Beratit.

Banesa Nr. 13 (Tab. VII, fig. 18). pranë kalasë së Sopotit, ndërtuar rreth fundit të shek. XIX, paraqet një zgjidhje të përparuar në krahasim me shembujt me dy ambiente me shkallë të jashtme. E reja në këtë kompozim plotësisht simetrik, është krijimi i dy ambienteve qendrorë ndërlidhës, relativisht të ngushtë. Në fundin e të parit zhvillohen shkallët. Kati përdhe formohet nga dy katojt mbuluar me qemerë cilindrikë. Mbi ta në katin e banuar janë ndërtuar dy odat e banimit të barastrajtuara në brëndësi. Ballin e çdo ode e zënë tre dritare relativisht të mëdha. Përballë hyrjes është ndërtuar oxhaku, dy kamaret anash, e më tej tyre nga një dritare. Në murin fundor janë vendosur një kamare dhe sqolli. Me zgjatimin e sallonit në katin e banuar, është sajuar një ambient i vogël, siç duket me funksionet e ambientit të banimit. Ndërtimi ka një përpunim të goditur të pamjes kryesore, veçanërisht në pjesën e sipërme të saj, ku sidomos shquajnë dy grupet me nga tre dritare, gjatë pjesës së poshtme të të cilave është ndërtuar një kornizë me dalje gurësh në formë dhëmbësh sharre, motiv i përhapur gjerësisht në Gjirokastër dhe rrallë në disa banesa të pjesës tjetër të Labërisë.

Një ndërtim, të cilin ndruhemi ta quajmë banesë, është ai Nr. 14 (Tab. VII, fig. 19) në fshatin Qeparo. Funksioni fillestar i saj nuk del i qartë, të dhëna jo të sakta flasin për një lloj shtëpie miqsh, ku zhvilloheshin takime me rëndësi të krerëve të krahinës. Ndërtimi është tre katsh me një lloj platforme, që mbahet nga një qemer cilindrik në nivelin e dyshemesë së katit të parë. Gjithashtu katoi është mbuluar me qemer cilindrik. Ambienti i katit të parë është mjaft i bollshëm, ashtu si dhe ay i katit të dytë, ku të çojnë shkallë druri, që zhvillohen në pjesën fundore të ndërtimit. Oda e katit të dytë, ka një tavan dekorativ, (fig. 20), që për nga trajtimi ndeshet shumë rrallë në këto anë. Ai ka për rozetë një yll me 6 cepa, qoshet e tavanit janë rakorduar me harkun tipik me tre qendra. Të dhënat gojore e vendosin këtë ndërtim në vitin 1830, trajtimi i tavanit flet për një kohë më të vonë, por nuk përjashtohet mundësia që ai ti përkasë një faze të dytë, së bashku me ballkonin.

Në fshatin Vuno, ruhet ende një ndërtim i veçantë, me funksionet e një lloj gazerme.[12] Ndërtimi është dykatësh, me kompozim të shtrirë, duke pasur

12) Kujtesa popullore e lidh këtë ndërtim me ndërmarrjen e një banori i cili kishte marrë përsipër luftën kundër piratëve nga këto anë, prandaj dhe mbante forca.

DO NOT COPY

INST. MON. KULTURES BIBLIOTEKA Nr. INV. 8673

DO NOT COPY



Fig. 22



Fig. 23



Fig. 24

katin përdhe mbuluar krejtësisht me qemere. Në katin e sipërm shtriheshin varg ambientet e qëndrimit. Nga dritaret origjinale, të vogla e të harkuara sipër kanë mbetur pak gjurmë, sepse janë hapur dritare të reja, por ruhen frëngji të shumta që shpjegohen me karakterin e ndërtimit.

Komplekset ndërtimore. Me komplekse ndërtimore, kuptojmë bashkimin në një njësi të vetme të disa ndërtimeve për banim, ose funksione të tjera, të cilat i shërbejnë një familjeje të vetme.

Për arsye se përgjithësisht, familjet e zonës së Bregut të Detit nuk kanë qenë numerikisht të mëdha, komplekset ndërtimore ndeshen rrallë megjithëse nuk mungojnë. Karakteristika e tyre kryesore, në kompozim, qëndron në krijimin e një konturi të mbyllur, pjesërisht me ndërtime e pjesërisht me mure, shpesh pa mbyllur hyrjet origjinale të ndërtimeve, të cilat nuk janë të drejtuara nga oborri, por lidhen drejtpërdrejtë me rrugën. Përjashtim në këtë drejtim bën kompleksi i kullave të Dervish Aliut[13], në fshatin Dukat, i cili duke qenë i fortifikuar, ka vetëm një hyrje të vetme për në oborr, prej të cilit me hyrje të veçanta kalohet në secilin ndërtim të veçantë të kompleksit.

Për tu përmendur nga komplekset ndërtimore të Bregut të Detit, përveç kullave të Dervish Aliut, janë dhe dy të tjerë, njëri në Himarë dhe tjetri në Vuno. Përveç vlerës së tyre në kompozim, këto komplekse të formuara me shtesa të njëpasnjëshme japin dhe një pasqyrë me vlerë për zhvillimin e formave dhe elementeve arkitektonikë.

Kompleksi Nr. 15 (Tab. VIII) ngrihet në pjesën më të lartë të lagjes së banuar, brenda mureve rrethues të kalasë së Himarës. Ai formohet nga katër ndërtime, secili prej të cilëve me dy ambiente, njëri përdhes ndërsa tjetri në kat. Brenda sipërfaqes së oborrit, është ngritur dhe një ambient ndihmës me furrën, si dhe ambienti sanitar. Me përjashtim të ndërtimit I, (fig. 21) që ruan edhe hyrjen fillestare prej rrugës, të gjitha ndërtimet e tjera kanë hyrjet nga oborri i përbashkët që ndërlidhet me rrugën me një portë.

Në kronologjinë relative vendin e parë e zë ndërtimi I. Ai paraqet një ndërtim tipik me kat, me katoin poshtë, që përveç qemerit kryesor me formuese paralel me aksin gjatësor, ka dhe një qemer tjetër më të vogël, me formuese normal të parit. Hyrja për në të është nën njërin nga dy qemeret paralele që formojnë sheshpushimin e shkallëve të gurta që të çojnë në hyrjen origjinale për në kat. Ky i fundit formohet nga

13) E. Riza, **Arkitektura dhe restaurimi i kullave të Dervish Aliut në fshatin Dukat (Vlorë),** Monumentet 18/1979.



Fig. 25



Fig. 26

një volum i vetëm me vendin e zjarrit me kamare në ballë. Rast i vetëm, nga sa njohim, është ndërtimi i një stere të vogël (fig. 22), i ndërtuar rreth mesit të njerit mur gjatësor, duke shfrytëzuar rënjen e qemerit. Ajo siç duket mbulohej me kapak druri në nivelin e dyshemesë, duke qënë dhe kjo zgjidhje e rrallë. Hyrja përbri sterës është e vonë dhe lidhet me nevojën për ndërlidhje me ndërtimet e mëpasme që formojnë kompleksin. Pa pasur ndonjë argument të sigurtë, mendojmë se ndërtimi II është ai pasuesi, për vetë ndërlidhjen e volitshme që mund të krijohej me ndërtimin I. Në katin përdhe ai është kompozuar sipas zgjidhjes së njohur me dy qemere paralelë në pjesën ballore, njëri prej të cilëve ka në pjesën fundore një sofa (fig. 23), provë e funksionit si qilar zahireje. Ndërtimet III dhe IV janë vendosur përngjitur, sipas brinjës më të shkurtër. Të dy ato kanë pasur të njëjtën skemë si ndërtimi II. Sigurimi i dyerve të katojve me shul, tregon për qenjen e ndërlidhjes së brendshme ndërmjet të dy kateve. Siç duket që me ngritjen e ndërtimit II, ka filluar ndërtimi i qemereve paralel me aksin gjatësor të tij. Më pas, me volume të mbushura me dhe, është krijuar një platformë e gjerë, shtruar me pllaka guri, e cila shërben për ndërlidhjen e njësive formuese të kompleksit. Ndërtimet II, III, IV, më vonë kanë pësuar një rindërtim, i cili ka prekur formulimin e dritareve, gjatë tij është bërë dhe shtrimi i dyshemeve me dërrasa, ndërtimi i tavaneve dhe çvendosja e një dere në ndërtimin II. Siç shihet ndërtimet formuese të këtij kompleksi nga ana kompozicionale nuk bien gjë të re, por përsërisin banesën e njohur me kat, me një ambient banimi.

Një rëndësi të veçantë mer kompleksi Nr. 16 (Tab. IX) në fshatin Vuno, për arsye se në ndërtimet formuese të tij shihen qartë ndryshimet që filloi të pësojë rreth gjysmës së dytë të shek. XIX, banesa e Bregut të Detit. Kompleksi i fshatit Vuno, është ndërtuar në tre faza ndërtimi, duke arritur në një kontur të mbyllur, që formohet pjesërisht nga ndërtimet dhe pjesërisht nga muret rrethues, brenda të cilëve krijohet një oborr, relativisht i gjërë. Ashtu si dhe kompleksi i Himarës, dhe ai i Vunoit është i pabanuar, meqë i mungon konstruksioni i çatisë dhe të gjitha strukturat dhe elementet prej druri. Në kronologjinë relative të ndërtimeve dallojmë tre faza ndërtimi. Ndërtimi fillestar (I), është në formën e shkronjës L në plan. Ai është kompozuar me gjysmëkat në volum duke pasur krahun fundor, të mbushur në katin përdhe, për të siguruar shtresën përdhese për shtëpinë e zjarrit. Krahu ballor ka pasur katoin poshtë dhe siç duket një ambient banimi sipër, me hyrje të veçantë nga jashtë. Ndërtimi II përbri të parit (fig. 24 siç tregon qartë vendtakimi i tyre në të cilin gurët e qoshes së ndërtimit II, janë të pa punuara) është një banesë tipike me kat. Kati përdhe me dy hyrje dhe ndërlidhje së brendshmi me ambientet e banuara, ka brenda volumit të tij dy çifte qemeresh, karshi njëri tjetrit. Ai pranë ndërtimit I, shërbente për qilar zahireje, siç tregon suvatimi i qemereve dhe ndërtimi i sofave. Sipër, dy ambientet e banuara, kanë hyrje të veçanta. Përpunimi më i kujdesshëm dekorativ i hyrjes (fig. 25) pranë ndërtimit I, tregon se ajo i shërbente odës së miqve. Së bashku me ndërtimin II, është ngritur dhe një sterë, jashtë volumit të tij. Faza e tretë e ndërtimit i përket ngritjes së krahut normal me

DO NOT COPY

ndërtimin II. Ai është i shkallëzuar në lartësi, për shkak të terrenit të pjerrët. Në një lartësi me ndërtimin II janë ngritur dy ambiente, katoi poshtë dhe një ambient banimi sipër, i cili zhvillohet përtej katoit duke qenë pjesërisht përdhes. Volumi që ngrihet një kat mbi pjesën tjetër të kompleksit, formohet në katin përdhe nga një kalim në formë tuneli, përbri të cilit ka qenë ndërtuar një furrë. Kati i sipërm, formohej nga një volum i vetëm, mbi kalimin dhe furrën e katit përdhe, i cili ishte dyqan dhe shërbehej



Fig. 27

nga një hyrje e veçantë nga rruga. Gjatë ngritjes së ndërtimit III, ndërtimet I dhe II, kanë pësuar një rindërtim, i cili ka prekur kryesisht formulimin e elementeve arkitektonikë, pa lënë mënjanë dhe disa ndryshime funksionale, të cilat tregojnë se njësitë formuese të kompleksit kishin fituar një far pavarësie



Fig. 28

nga tërësia, siç duket si refleks i ndarjes eventuale të familjes. Kështu balli i ndërtimit I (fig. 26), ritrajtohet, duke u zgjeruar dritaret dhe ndërtuar në qendër të tij një ballkon. Katoi ndahet më dysh, duke u hapur dy dyer, dhe një dritare. Kjo e fundit i shërbente dyqanit të sajuar në njërin volum të ish katoit. Ndërtimi II, gjithashtu pëson ndryshime me hapjen e derës në kat, përkundrejt dyerve origjinale. Shkallët dhe sheshpushimi i gjerë, që mbahet nga tre qemere janë ndërtuar për ti shërbyer këtij kalimi të ri për në katin e banuar. Dhe dritarja e odës së miqve është zgjeruar dhe kornizuar me bordurën karakteristike me gurë të punuar. Për arsye të panjohura është rindërtuar balli i ambientit përbri odës së miqve, si dhe



Fig. 29

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 30

një pjesë e muraturës ballore, siç tregon qartë teknika e murit (fig. 27) si dhe korniza karakteristike e gurit që lidhet me fazën e tretë të ndërtimit. Kësaj faze i përket dhe suvatimi i jashtëm i pamjeve kryesore të ndërtimeve I dhe II. Kështu në pamjen nga rruga kompleksi është trajtuar me një gjuhë të vetme arkitektonike, që thuajse ka shlyer fazat fillestare, të cilat mund të dallohen vetëm pas një vrojtimi të imtë.

Banesat e fortifikuara. Zona e Bregut të Detit është relativisht e pasur me banesa të fortifikuara, në dallim nga pjesa tjetër e Labërisë, në të cilën ato ndeshen më rrallë. Banesat e fortifikuara, apo kullat, siç i emërtojnë banorët, janë ndërtime të veçuara, ose ato i bashkangjiten banesës pa tipare mbrojtëse, duke formuar së bashku një unitet të vetëm të lidhur funksionalisht në mënyrë organike. Vërejmë se banesat e fortifikuara të veçanta (kullë), apo bashkangjitur banesës pa tipare mbrojtëse (banesë me kullë), janë ndërtuar veçanërisht në Vuno, Dhërmi dhe Himarë, por nuk mungojnë dhe në qendra të tjera të kësaj zone.

Kullat e veçuara në Dhërmi[14], relativisht të shumta, prej të cilave dy tre shembuj ruhen pak a shumë pa ndryshime të mëdha, janë ndërtime tipike mbrojtëse, të hedhura në lartësi, me tre kate njëri mbi tjetrin, dritare të vogla e frengji dhe pa elementët karakteristikë prej druri e guri të katit të sipërm në banesat e fortifikuara të Shqipërisë së Veriut.

Les exemples des habitations à «kulla» que l'on a décrits, ne représentent pas de grandes différences du côté compositionnel, de l'habitation à «kulla» de Kamenicë du 14-15 siècle. La «kulla» toujours d'un étage plus haute que l'habitation possède une liaison avec l'habitation et généralement une entrée à part. En composition la «kulla» occupe de différentes positions envers l'habitation. Elle a été construite en face d'elle suivant l'arrête la plus courte, perpendiculairement à son axe longitudinal, ou bien au milieu de l'une des côtés latérales. Ces habitations «kulla» se distinguent par leurs dynamisme de composition en volume qui est conditionnée par la différence des volumes. La construction en hauteur de ces habitations est une preuve de l'approfondissement des différences entre les classes ainsi que de l'incertitude qui existait dans les conditions de la domination ottomane même dans ces zones de Labëri.

La moitié du 19ème siècle marque un terme important au développement de l'habitation populaire de la zone de Bregu i Detit. Pendant ces années ont vu le jour de nouvelles conceptions tant dans la composition des habitations que dans le traitement des divers éléments architectoniques. Ceci est remarqué surtout par le caractère de l'habitation qui commence à devenir plus civilisé. Il faut chercher ceci dans le mode de vie, qui connaît des modifications, en comparaison avec les autres zones de Labëri, dès la moitié du 19ème siècle.

La grande misère de la zone de Bregu i Detit, la mer tout près ont été la cause de l'émigration qui parfois était saisonnier. Une partie de la population possédait de simples moyens de navigation, une autre était mise au service des patrons des navires étrangers.

A la naissance et au développement des relations capitalistes en général et du commerce en particulier, quelques uns des habitants de cette zone commencent à s'enrichir, mais ce qui compte dans les nouvelles manifestations dans l'habitation est l'éloignement du mode traditionnel de vie de cette couche. Le fait que l'on ne s'occupait plus d'élevage, des arbres fruitiers de l'agriculture a influencé dans la conception de l'habitation à qui l'on commençait à supprimer ses fonctions de garde-bétail au rez-de-chaussée. Les revendications pour l'utilisation des mobiliers ont causé des différences importantes dans l'habitation de cette zone.

La connaissance avec les réalisations des habitations des couches moyennes dans les villes méditerranéennes en particulier de celles qui ne se trouvaient pas loin, a facilité le passage au nouveau type d'habitation.

Comme on l'a mentionné dans les nouvelles conceptions ont été reflété deux phénomènes, la reconstruction des habita-

tions déjà construites ainsi que la construction des nouvelles habitations. Le processus de la reconstruction a touché surtout les vieilles habitations, tel que le montrent aujourd'hui les observations soigneuses des habitations de cette zone. Bien que ce phénomène touche surtout toute la zone de Bregu i Detit il n'avait pas la même intensité dans divers villages. Ce phénomène était plus répandu à Dhërmi et à Vuno, qui reflètent plus clairement l'architecture de l'habitation en question. Les anciennes habitations reconstruites, qui avec peu de changements ont eu un nouvel aspect, où seul un oeil de spécialiste peut le distinguer, montrent clairement que l'habitation traditionnelle se rapprochait à la nouvelle.

En ce qui concerne le début de l'apparition de la nouvelle habitation, les données sont relativement peu nombreuses et l'on peut compter par les doigts les datations. L'une des datations les plus anciennes celle de l'anée 1857 est d'une habitation de Dhërmi. Une des plus grandes habitations du type nouveau construites en 1870 à Vuno, montre clairement que maintenant le nouveau type était tout à fait consolidé.

La nouvelle habitation se distingue de l'habitation traditionnelle de sa fonction, de sa composition ainsi que du traitement des éléments architéctoniques. Comme on en a fait version la nouvelle habitation élimine la fonction de l'hébergement du bétail au rez-de-chaussée. Cet étage se convertit en étage habité où généralement l'on faisait la chambre du feu. Du point de vue de la composition elle s'éloigne de la conception du volume de demi-étage. D'habitude elle est d'une composition symétrique ayant au centre deux pièces de liaison, relativement petites. Au salon du rez-de-chaussée commence l'escalier qui mène à l'étage et qui d'habitude dans les types d'habitation traditionnelle se trouve en dehors. La nouvelle habitation se distingue d'un traitement architectonique plus soigné que les autres. On y trouve rarement l'utilisation des voûtes et des arcs. On remplace les petites fenêtres sous forme de meurtrières par de grandes fenêtres encadrées en pierres équarries. Les parties extérieures de l'habitation ont été crépies en couronnant la partie supérieure par un cadre en pierre. Un nouvel élément très répandu a été le balcon. Il a été construit en face du salon de l'étage marquant la partie centrale de la façade.

On trouve des exemples pareils surtout à Dhërmi et à Vuno.

L'habitation nr. 23 à Vuno présente un exemple typique de ce nouveau type. Elle s'élève dans la partie supérieure du village (aujourd'hui seuls les murs sont conservés), possédant à part la citerne dans la cour, une construction auxiliaire à quatre pièces. Cette habitation est d'une composition tout à fait symétrique ayant quatre pièces, deux au rez-de-chaussée et deux au premier avec deux salons dans chaque étage. La façade principale se distingue par un travail assez soigneux où l'on aperçoit le balcon. Il faut rappeler qu'il y a des habitations qui au rez-de-chaussée ou au premier ont eu des pièces fonctionnant comme boutiques pour la vente des produits prêts.

*
* *

Les habitations de la zone de Bregu i Detit, au cours des XVIII-XIX siècles, comme le témoignent les nombreuses constructions, qui ont été conservées jusqu'à nos jours ont été en majorité des habitations à étages. Elles étaient fermées et rarement on construisait de petits tchardaks. La diffrence fonctionnelle entre le rez-de-chaussée, qui était réservé au bétail et aux réserves alimentaires, et l'étage habité est une caractéristique importante de l'habitation de cette zone. Dans cette zone les habitations fortifiées du type «Kulla» et du type «habitation à kulla» occupent une place importante d'un grand intérêt. Dans les deux cas la «kulla» est de trois étages s'élevant, au deuxième cas, d'un étage sur l'habitation. La datation du XVIII siècle de ces habitations montre qu'une différence entre les classes existait déjà. L'habitation à «kulla», dont l'une est du XVIII siècle, dénote que la tradition de ce type de construction dont le témoignage le porte aux XIV-XV siècles, aux ruines de Kamenicë est conservé au cours des siècles donnant un exemple cristalisé de la symbiose des habitations avec «kulla» comme construction défensive.

L'habitation du Bregu i Detit jusqu'à la moitié du XIXe siècle s'unifie à la typologie de l'habitation de la région de Labëri dont elle fait partie. Comme nous l'avons mentionné, quelques circonstances ont obligé une partie de la population de s'écarter du mode de vie traditionnel. Ceci a donné libre cours à l'introduction des nouvelles conceptions dans l'habitation qui est reflétée à la réfection de maintes habitations anciennes et à la construction des nouvelles. Ceci exprime l'importance des conditions économiques et sociales qui ont déterminé le caractère et les traits de l'habitation.

La nouvelle habitation ainsi que la réfection des anciennes habitations n'ont pas apporté d'importantes modifications dans le caractère de l'architecture des campagnes de cettes zone. Les nouvelles coéxistent vers la moitié du XIX siècle, harmonieusement avec les traditionnelles parce que le nouveau n'a pas complètement nié la tradition, au contraire il a su s'y appuyer. C'est ainsi qu'il faut comprendre l'explicite unité des ensembles compactes des villages pittoresques de la zone de Bregu i Detit» où la nature est étroitement liée avec l'oeuvre faite par la main de l'homme dont les valeurs sont inestimables.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Apollon BAÇE

DO NOT COPY

BANJAT E SHEKUJVE TË PARË TË ERËS SONË NË SHQIPËRI

Deri më sot në vendin tonë njihen 14 banja[1] të shekujve të parë të erës sonë (fig. 1). Prej tyre është zbuluar, restauruar dhe studjuar vetëm ajo e stacionit rrugor Ad Quintum, pesë banja janë zbuluar dhe restauruar pjesërisht, ndërsa të tjerat vetëm sa mund të përcaktohen si të tilla, kryesisht nga pranija e sistemit të ngrohjes.

Duke marrë parasysh rëndësinë e banjave si dëshmi të një niveli të mirë higjenik dhe teknik si dhe të një arkitekture racionale, menduam që ti shqyrtojmë në një artikull përmbledhës, për aq sa e lejon gjendja e sotme. Shkaku tjetër i këtij shkrimi është se të trashëguara nga një e kaluar e largët, me struktura krahasisht të brishta, banjat e mësipërme arritën në ditët tona mjaft të dëmtuara, në rrezik të mëtejshëm degradimi. Rrjedhimisht në të janë kryer dhe do kryhen punime restaurimi dhe konservimi, të cilat kërkojnë së pari një njohje të mirë të konstruktit dhe arkitekturës së tyre.

Banjat e mësipërme mund ti grupojmë në:
1) Banja stacionesh rrugore
2) Banja publike qytetare
3) Banja familjare

BANJAT E STACIONEVE RRUGORË

Prej banjave të stacioneve rrugorë njohim pesë: në stacionin Ad Quintum (Bradashesh), në fshatrat Burizanë (rr. i Krujës), Papër (rr. Elbasanit), Darzezë (rr. Gramshit) dhe Ndërshkallë (rr. Kukësit). Prej tyre banjat në stacionin Ad Quintum dhe në Papër i përkasin rrugës Egnatia, ajo e Burizanës rrugës Dyrrah – Lis, ndërsa dy të tjerat rrugëve të një rëndësie të dorës së dytë: banja e Darzezës rrugës në luginën e Osumit, ndërsa e Ndërshkallës rrugës përgjatë luginës së Drinit. Pranija e dy banjave të fundit dëshmon për paisjen me stacione dhe banja dhe të rrugëve të brendshme të vendit tonë.

*) Skicat e artikullit janë të A. Qyshkës. Rilevimi i banjës në Ad Quintum nga F. Guralumi, A. Drazhi nën drejtimin e N. Cekës, L. Papajanit, i asaj në Burizanë nga G. Pani – L. Papajani, i banjës së Durrësit nga R. Alia nën drejtimin e K. Zhekut, i 4 banjave të Butrintit nga A. Baçe, E. Haxhiraj, E. Arifi, i Apollonisë nga A. Baçe. Fotot nga N. Ceka, R. Veseli, arkivi i Q.K.A. dhe autori.

1) Emërtimi banjë me prejardhje nga balneae βαλανεῖον balineum, balneum, balnea) i përgjigjet më drejt këtyre ndërtimeve se emërtimi termë, që ka hyrë edhe në literaturën tonë përkatëse, por që përdorej për banjat e mëdha monumentale, kryesisht të Romës. (A. May, **s. v. Bader,** në Pauly-Wysowa, **Real encyclopädie der classischen Altertumswissenschaft,** Stuttgart, 1896, II Kol. 2746 – 58). Lidhur me emërtimet e kthinave dhe pjesëve përbërëse të banjave, shpesh, si në literaturën e huaj ashtu dhe në atë të botuar tek ne, vihet re një mospërputhje. Kështu p.sh. emërtimi hypocausis (hypokaust) që i përket vetëm vendit të zjarrit ka marrë kuptimin e dyshemesë së pezullt (suspensurae pensilis), ose emërtimi frigidar përdoret vetëm për pellgun me ujë të ftohët dhe jo kthinën përkatëse. Për ta shmangur këtë i jemi përmbajtur emërtimeve sipas burimeve sa më të vjetra, kryesisht Vitruvit, duke i shqipëruar njëkohësisht për tu bërë të kuptueshme nga lexuesi. Nga njëherë në vështirësi të gjetjes së një fjale të vetme kemi përdorur dhe fjalinë.



Fig. 1

Banja e stacionit rrugor Ad Quintum[2] gjendet 7 km në perëndim të Skampinit (Elbasanit), përgjatë trasesë së rrugës Egnatia, rrëzë shpatit të një kodrine me burime të shumta uji. Banjat janë pjesë e një kompleksi i cili krahas tyre përmban dhe një shesh për qëndrimin dhe shëtitjen e klientëve (fig. 2).

Banjat kanë planimetri drejtkëndëshe 8 x 12 m (17,5 m bashkë me furrën dhe pellgun e ujit të ftohët), me kthinat e nxehta nga jugu dhe perëndimi (fig. 3). Kthina e parë, ajo e zhveshjes, shërbente dhe për larien me ujë të ftohët, praktikë e rëndomtë kjo. Në skajin e saj gjendet pellgu i ujit të ftohët, i shkëputur nga vëllimi kryesor i banjës dhe i mbuluar me kësulë sferike, përmasat e të cilit lejonin larjen e njëkohtë të disa klienteve. Prej kësaj kthine mund të kalohej drejtpërdrejt në kthinën e ngrohët, ose në pari në atë të lyerjes me kremra dhe prej këtej në të ngrohtën. Prej kthinës së ngrohët kalohej në kthinën e nxehtë të pajisur me një vaskë (alveum) në trajtë patkoi (fig. 4,5).

Sipas vendosjes së kthinave lëvizja në banjë kryhej si më poshtë:





Fig. 2

2) N. Ceka, L. Papajani, **Nymfeu dhe termet e stacionit Ad Quintum,** Monumentet, 4, 1973, f. 29-51. N. Ceka, **Ad Quintum,** Iliria VII, f. 287-298. Përshkrimi i jonë paraqet vetëm një përmbledhje dhe risistemim me plotësime të pakta të artikullit të parë, që paraqitet i gjerë dhe i saktë.

DO NOT COPY

Ku A është kthina e zhveshjes (Apodyteri); F--kthina e larjes me ujë të ftohët (Frigidari); Cu-kthina e lyerjes me kremra (Cella unguentaria); T-kthina e ngrohët (Tepidari); C-kthina e nxehët (kaldari).

Tabani i kthinave të nxehta ka qenë shtruar me tulla mbi të cilat vijonin shtyllëzat me tulla rrethore të mbajtjes së dyshemesë së pezullt (Suspensurae pencilis) (fig. 6). Vetë dyshemeja përbëhej prej tullave dykëmbëshe (bipedale), një shtrese llaçi me kokrriza tulle dhe copa tjegullash të vendosura pjerrët dhe shtresës së sipërme me llaç me pluhur tulle (fig. 7).

Sistemi i ngrohjes së banjës funksiononte si më poshtë: Gazet e krijuar në furrë kalonin nën dyshemenë e pezullt të kthinës së nxehtë dhe më tej brenda mureve, të paisura me sistem ngrohje. Një pjesë e gazeve kalonte nëpërmjet 6 hapësirash të mbuluara me hark (fig. 6), në kthinën e ngrohët dhe atë të lyerjes me kremra. Hapësira për kalimin e gazeve në brendi

DO NOT COPY



Fig. 3



Fig. 4



Fig. 5

të mureve, krijohej me anë rrodhanësh balte të gozhduar në muret.

Furnizimi me ujë i banjës kryhej prej një kanali që vijonte mbi murin mbajtës. Mbi pellgun e ujit të ftohët ai degëzohej me një tub qeramike, ndërsa më tej vazhdonte për në vaskat e ujit të ngrohët (fig. 3).

Zbrazja kryhej me anë të tubacioneve në tabanet e vaskave. Pellgu i ujit të ftohtë dhe vaska potkua shkarkonin në kolektor me anë kanalesh që gjendeshin jashtë banjës, ndërsa ujrat e vaskës drejtkëndëshe brenda ambienteve të nxehta prej ku një pusetë dhe një kanal i përcillnin në kolektor (fig. 3,8).

Muret e banjës janë punuar me «muraturë të përzier» me breza guri me teknikën «opus incertum» dhe breza tulle, 2 – 3 rreshtash me fuga thuajse sa trashësia e tullës (fig. 4). Me tulla janë punuar gjithashtu dhe tërë harqet e qemeret e banjës.

Banja ka qenë e paisur dhe me një sërë dritaresh prej të cilave ruhen ato në pellgun e ujit të ftohët (fig. 2) dhe pragu në kthinë e djersitjes në ajër të thatë; pranë tyre, gjatë gërmimeve, janë zbuluar dhe copra xhami që dëshmojnë paisjen e dritareve me xhama[3]. Përsa i takon dyshemesë së



Fig. 6

3) Informatë gojore e L. Papajanit.

DO NOT COPY



Fig. 7



Fig. 8

banjës ajo ka qenë e shtruar me llaç harasani, ndërsa muret, siç kuptohet nga fragmentet e ruajtur në ambientin e zhveshjes dhe atë të ngrohët, kanë qenë suvatuar dhe lyer në panela dhe breza ngjyrë vjollcë, blu, të kuqe, të gjelbër dhe të bardhë dhe me motive floreale.

Në një fazë të dytë në banjë u kryen një sërë ndryshimesh. Së pari kthina e nxehët u nda në dy pjesë në atë të djersitjes në ajër të thatë dhe të djersitjes në avull[4]. Rrjedhimisht skema e lëvizjes në banjë ndroi në:



Ku L është kthina e djersitjes në ajër të thatë (lakoniku) dhe S – kthina e djersitjes në avull (sudatori).

Krahas kësaj në kthinën e djersitjes në avull u shtua një vaskë drejtkëndëshe e paisur me furrë (fig. 3), u rrit lartësia e dyshemesë së pezullt nga tabani dhe u mbyll kalimi i gazeve të nxehët për në kthinën e ngrohët (fig. 6), duke ja humbur asaj qëllimin, dhe atë të lyerjes me kremra. Rrjedhimisht kthinat e fundit nuk ngroheshin më drejtpërdrejt nga gazet, por vetëm nga nxehtësija që vinte nga dyert e kthinave të nxehta.

Duke u nisur nga karakteristikat e mësipërme N. Ceka – L. Papajani caktojnë si kohë ndërtimi gjysmën e dytë të shek. II ose gjysmën e parë të shek. III dhe si kohë rindërtimi shek. e III. Po sipas tyre monumenti jetoi deri në fillim të shek. IV. Banja e mësipërme u ndërtua me një kthinë të nxehët, e cila gjatë rindërtimit u nda në kthinën e djersitjes në ajër dhe atë në avull. Ndryshe prej saj banja



Fig. 9

4) Për emërtimin e kthinave të mësipërme, që njëkohësisht shpjegon dhe funksionin e tyre, jemi bazuar tek C. Schneider (S. V. **Laconicum** në Pauly – Wisowa, **Real encyclopadie der clossischen Altertumswissenschaft,** Stuttgart, 1924, 12, 1, Kol 347-350).

DO NOT COPY

pranë kanalit në Buthrot u ndërtua që në fillim me të dy kthinat, pra me një skemë më të përparuar. Datimi i banjës së fundit në gjysmën e parë të shek. II na shtyn që dhe banjën e stacionit Ad Quintum ta mendojmë si të fillimit e jo fundit të këtij shekulli. Rënia e saj sipas autorëve të mësipërm, nuk do parë me heqjen dorë nga sistemi i stacioneve rrugorë dhe banjave, por me fuqizimin dhe kthimin e plotë të Skampinit në shek. e IV nga vicus në qytet dhe afrinë e Ad Quintum-it me të, por nga ana tjetër mendojmë se në të keq ka ndikuar dhe pranimi i kristianizmit si fe zyrtare, me kufizimet e tija në drejtim të banjave.



Fig. 10

Banja në fshatin Burizanë[5] ndodhet pak më në veri të Krujës, në afërsi të rrugës automobilistike për Lezhë e Shkodër (fig. 1). Banja që gjëndet në cakun e shkëmbimit të fushës me terrenin kodrinor, ku ende sot shpërthejnë burime të shumta uji, do parë e lidhur me ndonjë stacion të rrugës Dyrrah — Lis. Prania e qeramikës së ndërtimit në kodrat e afërta dëshmon më tepër për një stacion qëndrimi, mansio, se sa shkëmbimi, mutatio.

Banja është zbuluar në një pjesë të vogël gjatë hapjes së një rruge (fig. 9). Duke u nisur nga traktet e pakët të dalë në dritë, kuptohet se kthinat e nxehta gjëndeshin nga jugu. Në skajin perëndimor të kthinës së djersitjes në avull gjëndej vaska, përmasat e së cilës lejonin larjen e njëkohtë të dy vetëve. Muri i ulët i cili kufizon vaskën nga balli, përshkohet nën dysheme prej dy hapsirash të mbuluara me qemere tulle (fig. 10). Para kthinave të nxehta, po në këtë gjatësi gjendej kthina e ngrohët dhe ndoshta ajo e lyerjes me kremra.

Tabani i kthinave të mësipërme ka qenë shtruar me tulla katrore, mbi të cilat vijonin shtyllëzat me tulla rrethore. Mbi to vijonte dyshemeja e përbërë prej tullave dykëmbëshe (bipedale), shtresës së llaçit me kokriza tulle dhe shtresës së llaçit me pluhur tulle[6].

Muret e banjës nga jashtë janë punuar me gurë, ndërsa brenda me gurë dhe tulla. Muret 0,60 m të gjerë mund të mbanin shtytjet anësore të qemereve e kubeve, të cilat, për gjasi me ndërtimet e tjera, mendojmë se janë përdorur dhe në banjën e Burizanës.

Vendosja e kthinave dhe përmasat e njëjta na shtyn të paramendojmë se banja në Burizanë ishte e të njëjtit tip me atë të stacionit Ad-Quintum.

Banja në fshatin Darzezë[7] është zbuluar në një pjesë të vogël gjatë hapjes së themeleve të një ndër-

5) L. Papajani, G. Pani **«Rrugët dhe banjat pranë tyre në antikitetin e vonë»,** Tradita në arkitekturë dhe art (në shtyp). Autorët kërkojnë në këtë vend Pistum-in duke u nisur dhe nga gjurmë qeramike ndërtimi në një kodrinë të afërt.

6) L. Papajani — P. Gani, **Po aty,** venë në dukje se shtresa e sipërme hidroizoluese e vaskës është meremetuar.

7) A. Baçe — Gj. Karaiskaj, **Vrojtime arkeologjike në rrethin e Gramshit,** Monumentet 3, Tiranë, 1979, f. 199.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

tese në qendrën e fshatit. Prej banjës, që shtrihej në rreth 12 m gjatësi mbi një tarracë të sheshtë, shihet vetëm një pjesë e kthinave të paisura me dysheme të pezullt që mbahej prej shtyllëzash me tulla rrethore.

Banja ndodhet afër bregut të majtë të Devollit në një terren të përshtatur për kalimin e rrugës (fig. 1). Njëkohtas në këtë vend nis dhe një rrugë e tërthortë që duke prekur kështjellat në Irmaj dhe Prenjas e lidh luginën e Devollit me atë të Osumit[8]. Duke u nisur nga afrija me rrugët si dhe nga trajta planimetrike, mendojmë se ndërtimi i mësipërm i përkiste një stacioni rrugor, ndonse nuk përjashtohet mundësia që këtu të ketë qënë një banesë latifondisti (Villa rustica).

Qeramika e ndërtimit dhe ajo e përdorimit të përditshëm e daton ndërtimin rreth shek. II-III e. s.[9].

Banja në Ndërshkallë[10] (fig. 1) e zbuluar në një pjesë fare të vogël, gjendet në një terren të sheshtë në afërsi të fshatit Nangë. Dyshemeja e saj që mbahet prej shtyllëzash me tulla rrethore përbëhet prej tullave dykëmbëshe, shtresës së parë me llaç gëlqereje me grimca tulle dhe një shtresë të dytë të hollë me llaç me pluhur tulle. Afrija me rrugën na shtyn që ndërtimin e mësipërm ta shohim si stacion rrugor, ndonse dhe në këtë rast nuk përjashtohet mundësia që ajo të ketë qenë banesë latifondisti.



Fig. 11

BANJAT PUBLIKE TË QYTETEVE

Nga banjat publike njohim 4 banjat e Buthrotit, një në Dyrrah, një në qytetin në Grazhdan (Dober) dhe me dyshim, atë në Apolloni (fig. 1). Prej tyre banja pranë theatrit në Buthrot dhe banja e Dyrrahut kanë përmasa që i rradhisin ndër banjat e mëdha.

Banjat e Buthrotit gjenden në terren të rrafshët,

8) Për Irmajn, F. Prendi – Dh. Budina, Kalaja e Irmajt, B.U.SH. ses. Shk. shoq., 1963, 4, f. 3-60. Për Prenjasin dhe rrugën A. Baçe – Gj. Karaiskaj **vep. cit.** f. 199-201.

9) Gjatë hapjes së themeleve dolën tulla katrore (29,6x29,6x4 cm) të ndara diagonalisht në 4 pjesë dhe disa kupa me vernik të kuq me profile të kësaj periudhe.

10) K. Zela, **Kontribut për hartën arkeologjike të rrethit të Kukësit,** Buletin arkeologjik, Tiranë, 1971, f. 228.

DO NOT COPY



Fig. 12

të shpërndara në qytetin e poshtëm (fig. 11)[11]. E para ndodhet në skajin jugperëndimor, buzë Kanalit të Vivarit. Më e madhja që gjendet në afërsi të theatrit, thuajse ngjitur me ballin e jashtëm të skenës, merr pjesë në kompozimin urbanistik të qendrës, ndërsa banja e tretë ndodhet pranë Portës me Kulla dhe Baptisterit. Ndërtimi i fundit, tek i cili shohim një kompleks të ndërmjetëm, banjë-gjimnaz, ndodhet midis banjës pranë theatrit dhe asaj afër Baptisterit.

Pranija e një numri kaq të madh banjash, që përbën 1/3 e ndërtimeve të zbuluara të kësaj kohe, dëshmon në të mirë të mendimit se Buthroti në këtë kohë kish marë dhe tiparet e një qendre pushim bregdetar, ashtu si Pompei.

Banja e parë (15,50 x 13,00 m) ndodhet në te rren krejt të rrafshët, afër buzës së kanalit Vivarit (fig. 11) e orientuar me kthinat e nxehta nga dielli jugut (fig. 12,13,14). Trajtimi dhe renditja e kthinave të saja ka sjellë një planimetri afërsisht katrore, po të dhëmbëzuar dhe jo rreptësisht këndrejtë (fig. 15) që tregon se rëndësi kryesore kishte trajtimi i brend shëm e jo pamja e jashtme.

Banja përbëhet prej kthinës së zhveshjes, kthinës së ngrohtë, dy kthinave të nxehta, asaj të lyerjes me kremra dhe kthinës së shërbimit me furrat. Bërthama qëndrore e banjës ishte kthina e ngrohtë me të cilën lidheshin tërë kthinat e tjera.

Në përshkrimin e banjës i jemi përmbajtur rrugës që ndiqej gjatë larjes. Në këtë rrugë e para ishte kthina e zhveshjes, në trajtën e një drejtkëndëshi, që zinte tërë anën lindore të banjës (fig. 13, 15). Dy ndërprerje të murit të shtyjnë të mendosh se hyrjo kryesore ndodhej nga veriu, ndërsa një hyrje e vogël nga jugu.

Kthina e vetme që ndërlidhej me kthinën e



Fig. 13

11) Banjat janë gërmuar në vitet 1937-1938 nga misioni italian. Por për to përveç informacioneve të shkurtëra nga D. Mustilli, **Gli scavi di Butrinto,** estrat nga, Romana, Aprile 1940, XVIII, f. 9; **Relazione preliminari sugli Scavi arceologici in Albania** (1937-1940), në Rendiconti della classe die scienze morale e storiche, Roma, 1942, fasc. 12 serie VIII, Vol. II) f. 695-697) të shoqëruara me planimetri dhe fotografi, nuk ka ndonjë të dhënë tjetër. Përsa i përket rilevimeve planimetrike ata u kryen nën drejtimin e autorit duke ripërdorur në përpunim planimetritë e Mustilit. Në informacionin e parë Mustili gabimisht e mer për banjë dhe magazinën pranë Portës së Luanit, të kthyer më vonë në kolombarium.

DO NOT COPY



Fig. 14

zhveshjes, me një hyrje të paisur me flegër (fig. 16)[12] ishte kthina e ngrohtë (fig. 13, 14, 15).

Kthina me planimetri të rregullt tetëkëndëshe, siç kuptohet nga pjerrësimi i lehtë i mureve, ka qenë mbuluar me kupol. Ndjenja e një hapësire të rëndë thyhet në të nëpërmjet 4 nikeve rrethore të skajeve, të cilat e prishin monotoninë e sipërfaqeve të rrafshta dhe harmonizojnë me kupolën. Në tre prej nikeve ndodhen dhe dyert për në kthinat e tjera[13]. Për nga trajtimi arkitektonik kjo kthinë paraqitet e njëjtë me kthinën e ujit të ftohët të vilës së Masimo Negronit në Romë[14] dhe Heliokaminusin e vilës së Adrianit në Tivoli.

Në brinjën veriore, të ftohtë e të parrahur nga dielli, gjendej një vaskë drejtkëndëshe për ujë të ftohët, përmasat e së cilës lejonin larjen e njëkohshme të 3-4 vetëve (fig. 14, 17). Muri i saj ballor, nga brenda, pëson një shkallëzim për të lejuar hy-

12) Në prag ruhet vrima e boshtit të rrotullimit të flegrës së portës. Pranija e portës paraqet një rast të veçantë, pasi hapësirat e dyerve në banjat romake, sipas S. Charitonidis – R. Ginoueves (**Bain-romain de Zevgolatio,** Bulletin de correspondance hellenique, LXXIX, 1955, I, f. 106), liheshin të pambyllura.

13) Nuk është e kuptueshme në se fillimisht ka pasur derë dhe nikia veriperëndimore apo ajo është hapur më vonë.

14) N. Neuerburg, **L'architettura delle fontane e dei ninfei nell' Italia antica,** Napoli, f. 208.

rjen në të, ndërsa një thellim në murin e pasëm, ndoshta dikur i pikturuar, e thyen sipërfaqen e rrafshtë të kësaj ane. Faqet dhe tabani i vaskës kanë qenë veshur me pllaka mermeri të bardhë, mbi një shtresë llaçi me pluhur tulle. Një vaskë tjetër e veshur me mermer, po për ujë të ftohët, por në trajtë potkoi, zë brinjën perëndimore (fig. 13)[15]. Forma e vaskës e harmonizuar me niket e brinjëve anësore dhe e vendosur simetrikisht ndaj hyrjes, krijonte gjithaq një ndjesim arkitektonik të ekuilibruar. Së fundi nikeja jugore, po rrethore (fig. 13, 15) duket se shërbente për mbajtjen e ndonjë shtatoreje. Shtatore duhet të kenë pasur dhe dy niket veriore.

Pranija e dy baseneve me ujë të ftohtë tregon se



Fig. 15

15) Krijimi i shkallëzimit për ulje në brendi të vaskës mendojmë se do lidhur me fazën e II, pasi muratura e shkallëzimit ndron si teknikë dhe mbulon pllakat e mermerta të dyshemesë.

DO NOT COPY



Fig. 16



Fig. 17

kthina e ngrohtë shërbente në të njejtën kohë dhe për larjen me ujë të ftohtë. Kjo zgjidhje me sa dimë paraqitet e veçantë, pasi ndonse pellgu i larjes me ujë të ftohtë nganjëherë ndodhet së bashku me kthinën e zhveshjes, nuk njohim ndonjë rast ku ai të jetë së bashku me kthinën e ngrohtë.

Në skajin jugperëndimor kthina e ngrohtë ndërlidhet me një dhomë të vogël, tek e cila shohim kthinën e lyerjes me kremra (fig. 13, 15) ndoshta të lidhur dhe me mjedisin e jashtëm.

Kthina e ngrohtë ndërlidhej me anën e dyerve dhe me dy kthinat e nxehta (fig. 15, 18). Në to, në murin jugor, gjenden dy thellime në trajtë potkoi të paisura me furra nën nivelin e dyshemesë. Ndarja e kthinave të nxehta kryhet me anën e një muri të tërthortë, në mesin e thellimeve. Prej tyre në lindoren, shohim kthinën e djersitjes në ajër të thatë, në thellimin e së cilës, në gjasim me banjat e tjera, mendojmë se ka qenë vendi më i ngrohtë. Në ndryshim prej saj në zgjatimin e kthinës tjetër, atë të djersitjes në avull, gjendej një vaskë, ndërsa në thellimin vaska tjetër. Të dy kthinat e mësipërme duke u nisur nga planimetria katrore duhet të kenë qenë mbuluar me kupol, formë kjo e rekomanduar.

Së fundi furrat shërbeheshin nga kthina e shërbimit secila nëpërmjet një dritarjeje të mbuluar me hark rrethor tulle (fig. 12). Harkimi në lartësi i murit jugor të banjës dhe pjesë të rrëzuara qemeri, tregojnë se kjo kthinë, ashtu si në banjën afër baptisterit, mbulohej me qemer rrethor.

Duke u nisur nga përcaktimi dhe renditja e kthinave, skema e funksionimit të banjës ka qenë:



Sistemi i ngrohjes funksiononte si më poshtë: lënda djegëse ndizej në dy furrat, nën thellimet e kthinave të nxehta (fig. 15). Gazet e krijuar përshkonin së pari nëndyshemetë e këtyre kthinave për të vijuar pjesërisht në brendi të mureve të tyre[16]. Në këtë mënyrë në kthinat e nxehta, si nga qënia afër burimit të zjarrit, ashtu dhe nga kalimi i gazeve në

16) Në murin e ambientit të ngrohët shihet mbushja prej llaçi dhe copa mermeri në faqet e mureve, mbi nivelin e dyshemesë së pezullt. Këto gjurmë mungojnë tërësisht në faqet e mureve të kthinave të nxehta. Njëkohësisht shihet se muri ballor i vaskës potkua të kthinës të djersitjes në avull, nuk takon me muret anësore, njësoj si në banjën pranë baptisterit. Kjo dukuri shpjegohet vetëm me praninë e boshllëkut për kalimin e gazeve në faqet e murit.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 18



Fig. 19

muret, arrihej një temperaturë mjaft më e lartë se në kthinat e tjera.

Pjesa tjetër e gazeve vijonte, nën pragjet e dyerve, në nëndyshemenë e kthinës së ngrohtë. Prej këtu po nëpërmjet dyerve një pjesë kalonte në nëndyshemenë e kthinës së lyerjes me kremra dhe një pjesë në atë të kthinës së zhveshjes. Kjo e fundit ndërlidhej dhe me nëndyshemenë e kthinës së djersitjes në ajër të thatë (fig. 18).

Tabani i kthinave, me pjerrësim të lehtë drejt furrave[17], përbëhej prej një shtrese llaçi gëlqereje, me pluhur dhe kokriza tulle. Në kthinat e nxehta mbi, të gjenden tulla të plota, ndërsa në të tjerat copa tulle. Mbi këtë taban mbështeteshin shtyllëzat, që mbanin dyshemenë e pezullt (fig. 18). Lidhja e nëndyshemesë së kthinave me njera tjetrën sigurohej nga pllaka monolite guri të mbështetura në dhëmbëzimet e hapësirës së dyerve. Në një rast të vetëm, në kalimin kthinë e nxehtë – kthinë e zhveshjes, është përdorur dhe qemeri prej tulle. Vetë dyshemeja përbëhet prej tullave dykëmbëshe, të mbështetura në shtyllëzat, dy shtresash me llaç gëlqereje, njera të zakonshëm, tjetra me pluhur tulle, dhe pllakave të mermerta.

Për qarkullimin e ujit shërbente një sistem qyngjash qeramike (70 cm të gjatë, me diametër të brendshëm 6 cm) (fig. 17). Për mbushjen e vaskave me ujë të ftohtë, tubat pasi vinin nga jashtë, nën nivelin e truallit, kalonin diagonalisht dhe perimetralisht me tabanin e kthinës së ngrohtë. Për mbushjen e vaskave me ujë të ftohtë duket se tubat vijonin në muret e tyre ballorë, ndërsa për mbushjen e vaskave me ujë të nxehtë tubat kalonin dhe në brendi të dyshemesë së kthinës të djersitjes në avull. Shkarkimi i vaskave kryhej me tubacione të cilat e përcillnin ujin jashtë me një sistem kanalesh.

Së fundi muret e banjës në anën e jashtme janë punuar me muraturë të përzier me breza 3 rreshtash tulle (fig. 13), ndërsa brenda krejt me tulla[18] (fig. 18).

Në banjë dallohet një fazë e II dhe, ndonse jo dhe aq e sigurtë, dhe një fazë e III. Së fundi vërehet

17) Ky konstatim u bë i mundur nga pranija e ujrave nëntokësore më të thella pikërisht në kthinat e nxehta.

18) Lartësia e brezit të gurtë është 42-46 cm, ndërsa e atij prej tulla 0,20 m. Tullat kanë përmasa 29,5x29,5 cm. Brinjët janë punuar tërësisht me tulla.

DO NOT COPY

BANJA AFER PORTES ME KULLA – *Buthrot*



Legjenda

L _ *Kthina e djersitjes në ajër (6,20 × 3,70 m)*
S _ " " *në ngvull (6,20 × 4,13 m)*
V_1 V_2 _ *Vaskat e ujit të ngrohte (2,56 × 1,58 m)*
H _ *Furrat*
A sh _ *Ambientet e shërbimit*

Fig. 20

DO NOT COPY



Fig. 21



Fig. 22

se kthina e xhveshjes shkëputet nga sistemi i ngrohjes[19] dhe dyshemeja e saj, që tashmë ulet në nivelin e tabanit, mbulohet me mozaik (fig. 19). Mozaiku, gjeometrik dhe shumëngjyrësh, përbëhej prej brezit ndërlidhës, buzinës së jashtme dhe fushës me një panel në qendrën e saj. Brezi ndërlidhës i kufizuar skajeve nga dy vija, vijëzohej në rombe, në të cilët janë brendashkruar kryqe të vegjël me skaje të vizuar. Në dy rripat anësore të buzinës së jashtme, paraqitej motivi i valëdredhës, ndërsa në mes, i kufizuar nga vija teke, motivi i varglaqeve. Fusha paraqiste rombe të brendashkruar në drejtkëndësha, të kufizuar me meandra svastikash. Mesin e rombeve e zinin po kryqe të pikëzuar në mes. Prej panelit ruhet vetëm buzina ndërsa emblema është prishur. Pas një vije buzina vijonte me një varg trekëndëshash të mbivendosur dhe më brenda me një gërshetë dy fijëshe. Mozaiku është punuar me tesela të vendosura me mjaft rregullsi. Niveli teknik dhe i zbukurimit dëshmojnë për një shkallë të lartë punimi dhe e rrendisin mozaikun e mësipërm ndër shembujt e mirë të mozaikëve të kësaj periudhe.

19) Kjo kuptohet nga prishja e dyshemesë së pezullt, mbyllja me mur e hapësirës që i sillte gazet nga kthina e nxehët dhe ulja e lartësisë së pragut që e lidhte me kthinën e ngrohët.

DO NOT COPY

Më tej vihet re se shtyllëzat me tulla katrore zëvëndësohen pjesërisht me shtyllëza rrethore që dëshmon për një ndërhyrje të thellë e cila kërkonte prishjen e plotë të dyshemesë së pezullt dhe ribërjen e saj.

Së fundi banjës ju shtuan dy kthina të vogla në skajin veri perëndimor, muret e së cilës i mbështeten qartësisht ndërtimit të parë (fig. 14, 15). Lidhja me to kryhej me anë të një dere, ndoshta të hapur në këtë kohë, në niken përkatëse të kthinës së ngrohtë. Të dy kthinat, të bashkëlidhura me njera tjetrën, qenë paisur me vaska në formë potkoi dhe drejtkëndëshi dhe dysheme të pezullt. Këto shtesa i shohim si kthina të tjera të nxehta, krahas ekzistueseve. Po me këtë fazë do lidhur një meremetim, ndoshta zgjerim, i dritareve të furrës, mbyllja e derës që lidh kthinën e ngrohët me atë të djersitjes dhe ndërtimi në të i një vaske të vogël.

Skema e banjës në këtë rast ndron në:



Ku S_2, L_2 janë kthinat e nxehta të shtuara në fazën e II.

Për datimin e fazës së I, kryesore, ndihmon teknika e punimit të mureve dhe arkitektura. Teknika «opus incertum» me tendencën në «opus reticolatum», e shkëmbyer me breza prej tre rreshtash tulle, një këmbë të lartë i përket kryesisht shek. II.[21]. Nga ana tjetër ngjasimi i plotë me kthinën e ujit të ftohët të vilës së Negronit që daton rreth vitit 130 dhe heliokaminusin e vilës së Adrianit, po i kësaj kohe, ndihmon për datimin nga mesi i gjysmës së parë të shek. II,[22] ndërsa mozaiku e daton fazën e II në fund të shek III, fillim të shek. IV.



Fig. 23

Banja pranë baptisterit ndodhet në cakun ku terreni i rrafshët fillon e kalon gradualisht në shpatin e kodrës, në afërsi të ujësjellësit të qytetit (fig. 11).

Prej banjës janë zbuluar dy kthinat e nxehta, të vendosura rresht pas njera tjetrës dhe të orientuara nga jugu dhe perëndimi, kthina e shërbimit të furrave (praefurnium) dhe fillesat e mureve të kthinave të tjera (fig. 20-22).



Fig. 24

20) Për terminologjinë i jemi përmbajtur M. Blanchard – J. Christophe – J. P. Darmon – H. Lavagne – R. Prudhome – H. Stern, **Repertoire graphique du décor géométrique dans la mosaïque antique,** Bulletin de l'association internationale pour l'étude de la mosaïque antique, Mai, 1973, 4 fas – duke i shqipëruar termat sipas «fjalorit terminologjisë tekniko-shkencore, Vol. XII B. Daja, Ç. Fico, M. Qarri, **terminologjia e arkitekturës,** Tiranë, 1963.

21) G. Lugli, **La tecnica edilizia romana,** Roma, 1957, I, f. 519.

22) N. Neuerburg, **Vep. cit.,** f. 208.

DO NOT COPY



Fig. 25

Në kthinën drejtkëndëshe të djersitjes në ajër të thatë, gjenden dy dyer. E para, e ndërlidh me një kthinë pararendëse, gjasisht me kthinën e ngrohët, ndërsa dera e dytë, që gjëndet në një bosht me të parën, e ndërlidh me kthinën e djersitjes në avull. Kjo e fundit, po drejtkëndëshe, fillimisht ka qenë e paisur me një vaskë në trajtë potkoi, të ndërfutur në një dhëmbëzim drejtkëndësh të murit dhe të veshur me mermer (fig. 23). Para furrës së vaskës shihet një kthinë e shtruar me tulla, ndërsa para dy furrave të anës jugore ruhen gjurmët e një ndërtimi të ngushtë në trajtë korridori, nga i cili ruhet dhe një pjesë e qemereve (fig. 21).

Pjesa e zbuluar e banjës ka pasur skemën e mëposhtëme funksionale.

$$T\ (?) \rightleftarrows L \rightleftarrows S$$

Veçanti e kthinave të nxehta është mosndërlidhja e tyre nën dyshemenë e pezullt dhe shërbimi



Fig. 26

nga furra të veçanta. Kthina e djersitjes në avull ngrohej prej dy furrave, grykat e të cilave, të mbuluara me qemer rrethor, ndodhen njera nën vaskë dhe tjetra në brinjën e ngushtë jugore (fig. 20). Gazet e nxehtë kalonin së pari nën dyshemetë e pezullta, prej të cilave shihet ajo e kthinës së djersitjes në ajër të thatë (fig. 21, 22). Dyshemeja mbahej prej tubash qeramike, të biruar anash për një qarkullim më të mirë të gazeve (fig. 24), që mbështeten mbi tabanin e mbuluar me tulla dykëmbëshe. Prej këtej një pjesë e vogël e gazeve kalonte nëpërmjet një hapësire të mbuluar me pjatabandë në kthinën e ngrohtë. Mungesa e gjurmëve të suvatimit ose veshjes në muret e kthinave të nxehta dhe vazhdimi i boshllëkut brenda murit, nga vaska në faqet e mureve të kthinës së djersitjes në avull[23], tregon se gazet pasi kalonin nën dyshemenë e pezullt vijonin vertikalisht brenda mureve. Hapsira e duhur për kalimin e tyre siç shihet në vaskat krijohej prej pllakash tulle (tegulae mamatae) (57 x ? x 2,5 (8,5) cm) me katër të ngritura konike në skajet (fig. 25), të cilat krijonin një zbrazëti prej 6 centimetrash, ndërmjet murit dhe pllakës,

Në një periudhë të dytë, në kthinën e djersitjes në avull mbi furrën jugore, u shtua një vaskë e dytë, drejtkëndëshe e cila zë thuajse gjysmën e kthinës (fig. 23). Përmasat e vaskës lejonin larjen e njëkohëshme të 4-5 personave. Në ballin e vaskës muri është i shkallëzuar nga të dy anët, për të lehtësuar hyrjen dhe daljen. Dhe në të, ashtu si në tërë kthinën, është ruajtur ngrohja e faqeve anësore. Muret e vaskës janë punuar tërësisht me tulla,



Fig. 27



Fig. 28

DO NOT COPY

23) Muri ballor i vaskës nuk vijon i plotë. Në anët e tija, në takimin midis murit dhe faqeve të vaskës, shihet se zbrazëtira midis murit dhe faqes është lënë e hapët. Dukuri që shpjegohet vetëm me kalimin e gazeve në muret e pezullt.

ndërmjet të cilave shihen të ripërdorura tulla rrethore të kollonetave të dyshemesë së pezullt që dëshmon për një ribërje të dyshemesë. Gryka e furrës në vaskë është e mbyllur prej një muri, por nuk është e qartë në se mbyllja i përket pikërisht kësaj faze. Po e mbyllur me mur është dhe hapësira që lidh kthinën e djersitjes në ajër të thatë me kthinën pararendëse.

Muret e banjës 0,45-0,60 m të gjërë janë punuar sipas teknikës «opus reticolatum» me gurë, ndërmjet të cilëve ndërfutem në formë rripash, njësoj si brezat e tullës, pllaka gëlqerori. Vizimi i fugave të llaçit me mistri, ashtu si muret e skenës së theatrit, na shtyn që fazën e parë ta shohim të njëkohëshme me theatrin, në gjysmën e parë të shek. II.

Gjatë gërmimit në banjë është zbuluar një mbishkrim votiv që i kushtohet Zeus Kasiosit, hyut mbrojtës të lundërtarëve[24]. Mustili i cili është pjestar i



Fig. 29

24) Mbishkrimi që ka trajtën e një kollone me lartësi të pjesëshme 46,5 cm, diametër të poshtëm 20 cm dhe të sipërm 17 cm, paraqet një distik elegjiak në dialekt jonik. Transkriptimi i tij sipas A. Franciscis, **Iscrizioni di Butrinto,** Napoli, 1941, f. 6 është: μεζονά τοι προτέρις, Ζεῦ Κάσσιε, νῆα τιθησιν βαρβαρος εὐπλοίης χρεσσονος ἀντιτυχον κεῖνται δ'ἀλλήλησιν ἐναντίαι, εἰ δὲ και ὄλβον νενσειας, χρυσέην πᾶσαν ἀνακρεμάσε[ι

DO NOT COPY



Fig. 30 a



Fig. 30 b

gërmimit, ka mendimin se mbishkrimi lidhet me banjën[25], kurse Franciskis, i cili e transkripton dhe boton atë, e mendon të sjellë. Në se do të pranojmë mendimin e Mustilit, mbishkrimi do na tregonte se banja e mësipërme i përkiste kryesisht lundërtarëve dhe do të vinte njëkohësisht në pah rëndësinë e Buthrotit si skelë.

«Gjimnazi» ndodhet ndërmjet banjës pranë theatrit dhe asaj pranë baptisterit (fig. 11). Pjesa e tij qëndrore përbëhet prej një oborri drejtkëndësh, 25 x x 12,3 m, i cili në lindje kufizohet prej një muri, ndërsa nga jugu, perëndimi dhe veriu qarkohet prej një vargu kthinash me mozaik të ndërlidhura me të me pesë porta (fig. 26). Në mesin e oborrit gjendet një pellg i trajtuar si nymfe (fig. 28) i cili e ndan atë në dy pjesë thuajse katrore. Muret e nymfeut shtyhen mjaft afër mureve të oborrit, duke lënë vetëm dy kalime të ngushta ndërmjet dy pjesëve, ndoshta të mbyllura me mur. Dyshemeja e pjesës veriore është shtruar me pllaka drejtkëndëshe të latuara gëlqerori, ndërsa e pjesës jugore me mozaikë me panele me figura, nga të cilat ruhej njeri që paraqiste një derr të egër[26]. Në gjysmën jugore, në mesin e murit lindor, gjendet një absidë e rrahur nga dielli, që shërbente për mbrojtjen e plotë nga era.

Nymfeu ka planimetri drejtkëndëshe, me përmasa 9,20 x 5,00 m. (fig. 26-29). Ai përbëhet prej pellgut, i cili zë thuajse tërë sipërfaqen e brendëshme, dhe mbistrukturës së ndërtuar tërësisht me tulla dhe të veshur me mermer të bardhë mbi një shtresë llaçi me copra tulle. Në dy anët e ngushta nymfeu qarkohet prej muresh të cilët vijojnë paksa dhe në anët e gjata, por pjesa më e madhe e këtyre anëve është lënë e lirë. Në anën e jashtme forma e nymfeut është drejtkëndëshe. Për të prishur monotoninë e mureve të rrafshët, në muret e anëve të gjata, gjenden 4 nike absidale. Në të kundërt, pjesa e brendshme, në anën lindore, ka trajtë abside. Në të gjenden dhe tre nike rrethore, të veshura me mozaik me përfytyrime, hidriesh dhe kantarësh (fig. 30), sferike në pjesën e sipërme, dhe cilindrike, të veshura me shirita mermeri poshtë.



Fig. 31

Pellgu ka dy shkallë për zbritjen e lehtë në të. (fig. 29). Dyshemeja e tij e hidroizoluar me llaç me pluhur tulle, është veshur me rripa shumëngjyrësh mermeri që krijojnë vizatime të ndryshëm gjeometrikë. Pjesa absidale e nymfeut mbulohej me kupol, por për shkak të mosruajtjes së pjesëve të tjera, nuk mund të themi në se nymfeu ka qenë i mbuluar ose i hapur. Në se pranojmë mundësinë

25) D. Mustili, **Relazione..**, f. 696.
26) D. Mustilli, **Relazione..**, f. 692.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 32



Fig. 33

e parë, hapësirat e lira në brinjët e gjata duhet të kenë qenë kaluar me trarë druri dhe i gjithë konstruksioni duhet të mbulohet me çati.

Nymfeu ka mjaft afri me nymfetë e tipit «me ediкul»[27] Por në ndryshim prej këtij tipi që ka të zhvilluar në lartësi vetëm anën nga absida, ndërsa pellgun të qarkuar prej një buzine të ulët, nymfeu «gjimnazit» zhvillohet në lartësi dhe në anën përkundrejt absidës dhe ka një numër më të madh nikesh. Po kështu në të vërehet dhe një trajtim i kujdesshëm arkitektonik anës së jashtme. Nga anë tjetër për nga trajtimi i nikeve, sistemit hidrik dhe muraturës me tulla ai paraqitet mjaft i afërt me nymfeun e mirfilltë të Buthrotit, të tipit «me eksedër».

Furnizimi me ujë i basenit kryhej me anën e një tubacioni që degëzohej me tre tuba në murin lindor të nymfeut (fig. 29) Më tej uji vijonte në pjesën e poshtme të tre nikeve, në të cilat gjasisht si në nymfeun e mirfilltë gjendeshin shtatore, prej ku shpërthente për në basen (fig. 28, 29).

Në kthinat e anës jugperëndimore vërehen shtyllëzat e mbajtjes së dyshemesë së pezullt. Dyshemeja e kthinave të kësaj ane është e shtruar me mozaikë shumëngjyrësh, të cilët brenda buzinës për-

27) Sipas klasifikimit të N. Neuerburg **vep. cit.** f. 28-29. Më tepër afri ai paraqet me fontanat e Pompeit: fontanën binjake pranë Palestrës, me atë të shtëpisë me fontanën e madhe, të vilës me kolona e mozaik dhe shtëpisë në Vikolo di Tesmo, që datojnë nga gjysma e dytë e shek. të I. (Neuerburg **vep. cit.** f. 62).



Fig. 34



Fig. 35

mbajnë një panel të qarkuar e ndarë prej një gërshete teke në 8 fusha, me nyjen e Solomonit në qendër (fig. 27). Mozaiku i kthinës jugperëndimore, i një kohe më të vonë është punuar me motive të njëjta me ato të banjës kanalit.

Përsa i përket teknikës së ndërtimit ajo paraqitet e ndryshme: me tulla në nymfe, ndërsa në kthinat, e përzier, me breza tulle të këmbyera me mur guri, ndërmjet opus reticolatum-it të shpërbërë dhe opus incertum-it, dhe mure me spolje, dukuri që tregon praninë e disa duarve ndërtimore.

Mustili duke u nisur nga gjetjet e qeramikës dhe monedhat, e daton këtë ndërtim rreth shek. II e.s.[28]. Por teknika e ndërtimit[29] dhe parapëlqimi i tipit të nymfeut me edikul në shek. e I mendojmë se mund ta shtynë ndërtimin e tij në kapërcyellin e shek. I-II.

Lidhur me përcaktimin dhe funksionimin e këtij kompleksi, mendojmë se në anën veriore kryheshin ushtrimet e ndryshme gjimnastikore, baseni shërbente për larjen me ujë të ftohtë, pjesa jugore e oborit shërbente për qëndrim dhe shëtitje pas proçesit të larjes, ndërsa kthinat juglindore si pjesë e mirëfilltë e banjës. Në këtë mënyrë bëhet mjaft i mundur mendimi se ndërtimi i mësipërm ka qenë gjimnaz[30].

Banja pranë theatrit si për nga pozita, ashtu dhe për përmasat kuptohet se ka qenë banja qëndrore e qytetit (fig. 11). E ndarë prej skenës së theatrit vetëm nga një kalim i ngushtë, me një nga ballet të drejtuar nga rruga e sheshi kryesor, ajo mer pjesë aktive në trajtimin e qendrës, duke qenë një nga elementet kryesorë të këtij trajtimi (fig. 31). Prej banjës janë zbuluar plotësisht 4 kthina si dhe fillimet e dy kthinave të tjera, duke arritur gjatësija e saj në 28,70 m dhe gjerësia në 10,70 m. Rrjedhimisht planimetria e plotë e banjës, dhe aq më pak skema funksionale, është ende e paqartë. Për më tepër në muret e saja dallohen mbi 5 duar të ndryshme ndërtimi që e vështirësojnë dhe më tej studimin (fig. 32).

Duke mbetur në fushën e hamendjes supozojmë se nga banja është zbuluar vetëm gjysma veriore, duke e parë murin jugor të kthinës së nxehët si bosht simetrije. Në këtë rast nga salla qëndrore, mendojmë e zhveshjes dhe larjes me ujë të ftohët, e mbuluar me qemer[31], kalohej në kthinën e djersitjes në avull



Fig. 36

28) D. Mustilli, **Relazione**. . , f. 694.
29) G. Lugli **vep. cit**. . . . . .
30) Mendimi se kompleksi i mësipërmë ka qenë gjimnaz i përket Markonit (cituar tek D. Mustilli, **Relazione**. . , f. 693).
31) Në këtë mendim na shtyn gjetja e dy kontraforteve që i përkasin fazës së I, të cilët duhet të kenë shërbyer për shkarkimin e nervaturave të qemerit.

DO NOT COPY



Fig. 37

dhe në një kthinë tjetër me dysheme të paisur me mozaik (fig. 33). të punuar me tesela (fig. 34). Fusha e tij qarkohet prej një buzine të zezë me thjerza e shkopinj të bardhë dhe thjerza të kryqëzuara në qoshet. Fusha paraqet vija të valzuara me çifte peltesh, shpinë më shpinë me njëra tjetrën, të kryqëzuara po me çifte të tillë. Në mesin e sallës gjëndet dhe n'ë pllakë e biruar guri që luante rolin e pusetës për largimin e ujrave.

Përveç sallës qëndrore salla e mësipërme ndërlidhet drejtpërdrejt me mjedisin e jashtëm dhe me një kthinë tjetër të ngrohët (fig. 32). Nga kjo e fundit kalohej në sallën e djersitjes në avull të paisur me një vaskë në trajtë potkoi, nën të cilën gjendej furra e banjës[32]. Salla ka 5 dyer të vendosura simetrikisht, me patura mermeri. Prej tyre tre dyer e ndërlidhin me sallën qëndrore, me kthinën e ngrohët dhe një kthinë tjetër me funksion të paqartë, ndërsa dy të tjerat, të anës jugore, nuk dihet se ku dilnin.

Dyshemeja e sallës është shtruar me tulla, mbi të cilat vijonin shtyllëzat që mbanin dyshemenë me tulla dykëmbëshe, një shtresë llaçi me grimca tulle dhe copa tjegulle të vendosur sheshas ose pjerrët dhe një shtresë me llaç e pluhur tulle. Gjurmë të zbeta të lënë të kuptosh se dyshemeja ka qënë shtruar me pllaka mermeri.

Qarkullimi i gazeve kryhej si më poshtë: Gazet e krijuar nga djegja në furrën e madhe (3,85 x 2,15 m) nën basenin e ujit të nxehtë, kalonin nëpërmjet 5 hapësirash të mbuluara me tulla dykëmbëshe në nëndyshemenë e kthinës të djersitjes në avull. Mungesa e gjurmëve të suvatimit dëshmon në të mirë të mendimit se kthina ishte paisur me sistemin e ngrohjes së mureve dhe një pjesë e gazeve vijonte brenda

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 33

tyre. Më tej një pjesë e vogël e gazeve kalonte nëpërmjet një dritareje të mbuluar me hark dhe në nëndyshemenë e kthinës së ngrohtë.

La forme de la planimétrie des chambres des bains est essentiellement rectangulaire, mais les chambres chaudes souvent ont une forme carrée ce qui permet une couverture en coupole. Quant à la forme polygonale rare, elle se rencontre dans le bain pris du canal ce qui dénote un soin spécial pour l'architecture intérieure. Une construction très analogue ont les ruines au bord de la mer à Sarande, qui appartenaient probablement à des bains qui ressemblaient comme type avec ceux près du canal à Buthrot.

Le système du chauffage.

Les bains susmentionnés sont construits sur des terrains plats ou aplanis (Ad-Quintum, le bain près du baptistère-Buthrot) afin de créer des surfaces plates pour le pavé des chambres chaudes.

Dans les bains de Buthrot, ceux près du canal et du baptistère on remarque un abandon du pavage des chambres

DO NOT COPY

chaudes vers le four afin d'éliminer l'humidité que peut se concentrer dans le cas d'une pente à l'envers.

Dans tous les pavages des chambres avec chauffage, la couche supérieure est faite habituellement avec des briques posées sur un lit de mortier fait avec de la poudre de brique lequel servait pour le nivellement et en même temps comme isolant de l'humidité souterraine. Sur le pavé est édifié le système de support du plancher. Pour réaliser se système on construisait des petites colonnes en briques. Quant au système fait avec des tubes en céramique trouvées sur les côtés et qui permettait une plus large circulation des gaz mais qui était plus couteaux, a été exécuté seulement dans la seconde phase, dans le bain près du baptistère-Buthrot. Ce système de construire qui était rare dans tout le territoire de l'empire romain appartenait à l'époque entre le IIème et le IIIème siècle. Au contraire, le système de soutenir le plancher avec des canaux ou avec des arcs ou avec des voûtes manque complètement. D'autre part l'emploi des arcs pour le passage des murs en bains (Ad Quintum, Burizanë, Buthrot – avec des architraves) comme on le voit était connu, mais il ne fut pas exécuté à cause de son peu d'intérêt au point de vue de la construction ainsi que pour la perte de chaleur avec ce système.

Les petites colonnes ont une hauter de 0,61-1,05 m à partir du pavé avec la perspective d'une augmentation de cette hauteur pendant la reconstruction. Cette hauteur correspond à peu près avec la recommandation de Vitruvi, c'est-à-dire $2^1/_2$ pieds (à peu près 0,75 cm). Dans beaucoup des cas les colonnes des côtés sont en briques rectangulaires pour pouvoir s'appuyer sur le mur, tandis qu'au centre elles sont circulaires pour permettre une circulation meilleure des gaz. La dimension des briques circulaires arrive jusqu'à $^2/_3$ de pied (19.7 cm). Les briques sont liées dans la plus part des cas avec un mortier fait d'argile et rarement avec de la chaux, suivant le conseil de Vitruc. Les joints entre les briques des colonnes avaient une épaisseur de 1 cm., ce qui témoigne qu'elles appartiennent à une période ancienne, vers le IIème siècle.

L'espacement entre les petites colonnes ou des tubes était conditionné par les dimensions des briques du plancher lesquelles sont à deux pieds (bipédale) et dont les dimensions variaient très peu l'une de l'autre. Le plancher est fait avec 2 à 4 couches de mortier de chaux avec de la poudre et granules brique suivant l'importance et le soin donnés au bain. On remarque que les dimensions des granules de brique changent de 0,5 à 1 cm dans les couches inférieures et que les couches supérieures sont en poudre de brique. A ce qu'il paraît les couches inférieures avaient une fonction de soutien tandis que les couches supérieures étaient plutôt pour une isolation hydrique.

En même temps que le chauffage du plancher dans les chambres chaudes des bains on a employé aussi le chauffage des murs. Cette méthode nous donne comme «terminus post quem» la date de leur construction les années 70 à 80 de notre ère. L'ouverture nécessaire pour le passage des gaz dans les murs a été exécuté de trois manières suivantes: Par des tubes en céramique (tubuli), par des canaux en brique (tegula mamatae), et par des rocquetes en céramique. Il est intéresant que le chauffage par des tubes, peu répandu parmi les bains romains se rencontre plus souvent dans les deux centres Apollonie et Dyrrah. Au contraire le système avec des carreaux en brique (tegulae mamatae) se trouve seulement à Buthrot, dans un des bains près du baptistère. A Ad Quintum on rencontre le système avec des rocquetes rares dans les autres bains. Au troisième siècle le système de chauffage des bains a subi des modifications. Le «Caldarium» se divise en deux pièces (Ad Quintum et Dyrrah) le passage des gaz pour le «tepidarium» est fermé (Ad Quintum) on ajoute des nouvelles vasques pour le lavage à l'eau chaude (Ad Quintum, et les bains de Buthrot), et des nouvelles chambres chaudes (Bain près du canal-Buthrot).

Ces changements apportent une unification du schème de chauffage et du fonctionnement dans tout le territoire en même temps une augmentation de la chaleur dans les chambres chaudes.

Exécution architectonique

Les bains de Dyrrahu et ceux du théâtre à Buthrot prennent part à la formation du centre de la ville. Par conséquent nous pensons qu'ils devaient être construits extérieurement avec une architecture soignée. Au contraire dans les autres bains pour l'architecture extérieure on n'a pas donné un grand intérêt de ce que nous pouvons juger des bains découverts jusqu'aujourd'hui. On donnait un intérêt pour leur fonctionnement seulement; comme résultat la forme et le volume ainsi que la vue extérieure étaient sujet à l'alignement et à la construction des chambres. Ainsi dans le bain de la station routière de «Ad-Quintum», dans celui près du canal à Buthrot et dans celui près du baptistère auprès du gymanse leur vue extérieure trahit les dentelures que forment les piscines, les vasques et les chambres annexes sans se préoccuper pour une forme régulière extérieure de ces bâtiments. Une autre caractéristique de ces bains est qu'ils n'ont pas un axe de symétrie ce qui était une règle pour les constructions de ce genre de la même époque.

D'autre part cette symétrie plus ou moins comme planimétrie ne se faisait pas sentir pendant la circulation dans le bain parce que les murs qui empêchent la vue sont construits d'une manière presque symétrique. Ce soin se voit clairement dans la chambre (salle) centrale dans le bain près du canal à Buthrot.

Par conséquent on peut parler d'une symétrie interne, dynamique, qui est basée sur la circulation et le stationnement dans les diverses chambres du bain. A l'encontre du soin qu'on a pris pour l'aménagement intérieur, l'extérieur des bains fut négligé. Quoiqu'il est divers selon l'importance des bains ce soin ne manque pas aussi dans les bains simples

DO NOT COPY

comme ceux des stations routières. Ainsi dans les bains de la station routière de «Ad-Quintum» quoique le plancher est simple et fait avec un mortier avec de la poudre de briques, les murs sont garnis de panneaux en plusieurs couleurs avec des motifs géométriques et floréaux. A Dyrrah le plancher et les murs des côtés sont revêtus avec des carreaux en marbre. Le même aménagement ont aussi les bains de Buthrot. Pour le plancher de ces bains on a employé largement la mosaïque celle géométrique ainsi que celle avec des motifs différents. Un soin très attentif se voit dans la chambre (salle) centrale des bains près du canal où on a imité les grandes salles des établissements thermaux romains. Ce mode de construction se voit dans la solution architectonique des chambres des bains ainsi que dans l'emploi des matériaux.

Comme il résulte de notre article les bains de notre pays datent du commencement du second siècle et la période entre le premier et le second siècle. Plus tard on remarque dans leur construction une seconde phase qui s'étend à tous les bains qui datent du troisième siècle. Les bains ont subsisté jusqu'au quatrième et cinquième siècle. Mais l'adoption du christianisme comme religion officielle avec ses restrictions et ses exigences font perdre petit à petit leur importance aux bains ainsi qu'à la fin du cinquième siècle ils n'existaient plus.

En dehors de la perte de leur fonction comme bains à Ad Quintum on le voit aussi à Dyrrah où les bains furent transformés en cimetière et ceux du gymnase à Buthrot en église.

Quant à leurs particularités il est difficile aujourd'hui de dire quelque chose du moment que les bains ne sont pas découverts complètement et la littérature qui traite de ce sujet est incomplète, elle ne s'occupe que de la technique du chauffage. Quand même nous pouvons dire que les bains qui furent édifiés dans notre pays sont construits selon une technique approfondie et suivant les données de leur fonctionnement. On remarque aussi dans ces bains la recherche du beau et leur ressemblance directe aux types du centre.

En terminant nous désirons mettre en évidence que notre article est une preuve que nous avons cherché de donner un aperçu général sur ce sujet à l'échelle de nos connaissances. Il est évident qu'à l'avenir avec la découverte complète des bains susmentionnés et la découverte de nouveaux bains ce problème sera de nouveau étudié et les résultats seront plus détaillés et plus exacts.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Aleksandër MEKSI, Pirro THOMO

DO NOT COPY

ARKITEKTURA PASBIZANTINE NË SHQIPËRI KISHAT NJË NEFSHE

Studimi i ndërtimeve të kultit të krishterë të periudhës së pushtimit turk, paraqet interes të veçantë për njohjen më të plotë e të gjithanëshme të arkitekturës të kësaj periudhe, për nivelin e ndërtimeve dhe mjeshtrave dhe njëkohësisht kontribuon për të ndriçuar edhe mjaft aspekte të historisë së popullit tonë. Deri më sot kjo kategori ndërtimesh është studjuar pak. Kemi botime për disa kisha të Voskopojës nga S. Adhami[1] dhe një kumtesë të autorëve, rezultat i një pune të gjatë në terren për gjurmimin, studimin dhe restaurimin e kësaj pasurie mjaft të madhe[2]. Qëllimi i këtij artikulli, që do të vijohet nga të tjerë, është publikimi i monumenteve të studjuar, duke lënë për në fund studimin përgjithësues dhe përfundimet.

Emërtimi i kësaj arkitekture si pasbizantine do të dëshmojë për vazhdimësinë në të, të mjaft principeve figurative e konstruktive të arkitekturës bizantine gjithnjë në përshtatje me kushtet e reja ekonomiko-shoqërore. Në një kënd të tillë vështrimi dhe shtrirja e saj në territorin e vendit tonë është rezultat i shtrirjes së deriatëhershme të arkitekturës së periudhës bizantine, Shqipëria e Jugut dhe pjesërisht ajo e Mesme.

Kishat e para që ndërtohen në këtë periudhë i takojnë gjysmës parë të shekullit XVI. Duke filluar me to e deri në shekullin e XIX ngrihen një numur i madh kishash nga të cilat kemi zgjedhur ato që dokumentojnë në aspekte të ndryshme këtë arkitekturë dhe janë të domosdoshme për njohjen dhe studimin e saj.

Megjithë larminë e tipave të përdorur, shtrirjen e madhe territoriale e kohore, mendojmë se në bazë të kompozimit planimetrik e vëllimor dhe ndërtimit struktural, ndërtimet e kësaj periudhe mund të grupohen në tre grupe të mëdha. Kemi zgjedhur këtë kriter, ndër mjaft të tjerë që mund të përdoren, sepse këto në veçanti kanë luajtur rolin themelor në formulimin e brendshëm dhe të jashtëm të ndërtesave. Krahas këtij grupimi, shqyrtimi i monumenteve të ruajtur duke patur parasysh rrugën e zhvillimit arkitektural të monumenteve duke konsideruar këtu vendosjen në kohë të tyre, do të ndihmojë për të nxjerë në dukje si rrugën që ndoqën ndërtimet në këtë kohë, ashtu edhe kushtet që lejuan ndërtimin e tipave të caktuar në krahina të veçanta. Sipas kriterit të mësipërm kishat pasbizantine të vendit tonë mund të ndahen në:

I. – Kishat njënefshe,
II. – Kishat me strukturë në formë kryqi me kupolë
III. – Bazilikat.

---

1) S. Adhami **Një monument me vlerë i sh. XVII në Voskopojë,** Monumentet 10, 1975, 63-74.

Po ai, **Tri bazilikat të mëdha të ndërtuara në Voskopojë,** Monumentet 14, 1977, 145-168.

Po ai, **Katedralja Fjetja e shën Mërisë në Voskopojë,** Monumentet 15-16, 1978, 89-100.

2) A. Meksi; P. Thomo, **Arkitektura pasbizantine në Shqipëri** Monumentet 11, 1976, 127-145.

DOKTORATURË

I. – KISHAT NJËNEFSHE

Përbëjnë tipin më të thjeshtë, të cilat për përmasat pak a shumë të vogla u ndërtuan që në periudhën e parë të pushtimit osman. Si të tilla duke paraqitur lehtësi ndërtimi, ato u ndërtuan kudo dhe gjatë gjithë periudhës në shqyrtim. Ndërtimi planimetrik e vëllimor i tyre mund të paraqesë veçanti në mvartësi të strukturës së mbulimit të sallës të kishës. Kështu kemi kisha të mbuluara me çati druri, kisha të mbuluara me sistem qemeresh cilindrike dhe kisha të tipit sullë me kupol.

1. – **Kishat me mbulesë druri.** Këto kisha u ndërtuan kudo dhe kurdoherë si rezultat i lehtësisë së ndërtuarit të tyre. Veçanti e tyre është mbulesa me çati mbi struktura të drunjta, me dy kullime dhe mbuluar sipas rastit me tjegulla apo rrasa guri. Siç do të shohim ato janë përgjithësisht të zhveshura nga përpunimi dekorativ në muret e jashtme. Në të kundërt mjaft prej tyre ruajnë vlera të mëdha të pikturës që vesh faqet e brendshme të mureve.

Kisha e shën Gjergjit në Leshnicë të Sipërme (Sarandë), datohet nga mbishkrimi i pikturës murale në vitin 1525[3]. Kisha përbëhet nga naosi dhe hajati i hapur i shtuar më vonë. Naosi është drejtkëndësh në plan dhe përfundon në anën lindore me një absidë gjysëm rrethore, e cila për shkak të vendosjes së kishës në teren të pjerrët nuk ka si zakonisht dritare. Kisha është pa tavan dhe e mbuluar me çati druri e rrasa guri. Muratura e saj është me gurë të çregullt e llaç gëlqereje me rërë të ashpër. Hajati i vonë përbëhet nga muri jugor i plotë, një pilastër me prerje katrore në qoshen veriperëndimore dhe dy shtylla druri ndërmjet saj dhe mureve të tjerë. Një mur i ulët e kufizon hajatin duke lejuar hyrjen në anën veriore pranë murit të kishës.

Kisha e shën Mitrit në Poliçan (Gjirokastër) është një kishë e vogël me planimetri drejtkëndëshe që ka patur dhe narteks por që sot ndodhet i rrënuar. Në murin lindor del një absidë gjysëm rethore. Hyrja në kishë është bërë në anën perëndimore ku ndodhet porta mbuluar me arkitrarë druri mbi të cilën ka një nike me hark rrethor. Çatia e kishës është dyujse duke përfunduar në lindje e perëndim me frontone. Një dritare ndodhet në pjesën e sipërme të murit jugor, karakteristikë kjo për mjaft kisha. Kisha është ndërtuar me gurë të çrregullt dhe llaç gëlqereje. Dyshemeja e kishës është shtruar me pllaka guri të çrregullta. Nga mbishkrimi kisha datohet në vitin 1526.

Kisha e Shën Thanasit në Pecë (Sarandë) është ndërtuar dhe pikturuar në vitin 1525. Është një kishë e vogël me narteks të mbyllur me sa duket të shtuar më vonë si në anën perëndimore ashtu edhe në anën jugore me fuga të qarta të kontaktit të mureve të reja me muret e vjetra. Në kishë hyet nga porta në anën perëndimore dhe prej asaj kalohet në naosin e ndarë me ikonostas druri nga ambjenti i altarit me absidën gjysëm rrethore. Muret e kishës janë ndërtuar me gurë gëlqerorë dhe llaç gëlqere. Mbi to ka një kornizë të thjeshtë ku përfundon çatia mbuluar me rrasa guri.

Kisha e shën Sotirit në Tremisht (Përmet) ndërtuar në vitin 1560, paraqet një kapelë të vogël në planimetri drejtkëndëshe, të cilës në një kohë të dytë i është shtuar narteksi i mbyllur në anën perëndimore dhe në anën jugore i hapur në tërë gjatësinë e naosit dhe narteksit. Hyrja për në narteks bëhet nga ana jugore nëpërmjet një porte të ulët. Narteksi ndriçohet nga një dritare e vogël në anën perëndimore. Prej tij hyet në kishë, e cila ka dhe një portë tjetër nga veriu. Kisha ndriçohet mjaft dobët nga një dritare e vogël në absidën tre faqshe që del fare pak ndaj murit lindor. Muratura e kishës është me gurë shtufi lidhur me llaç gëlqereje me tendencë horizontale të rradhëve.

Kisha e shën e Premtes në Valësh (Elbasan) datohet nga mbishkrimi i pikturave të Onufrit në vitin 1554. Kisha është ndërtuar kryesisht me gurë gëlqerorë duke patur dhe gurë çmërsi, lidhur me llaç gëlqereje me mbushës të trashë. Mjaft rrallë, gjen tek-tuk dhe copëra tjegullash e tullash të vendosura ndërmjet gurëve. Në kishë hyet vetëm nga perëndimi nëpërmjet një porte të ulët me arkitrarë guri të gdhendur në pjesën e poshtëme për ti dhënë formën e harkut. Në anën lindore del absida e vogël gjysëm rrethore, me një dritare të vogël si frengji. Absida zbukurohet nga një friz tullash zigzag dhe korniza mbi të. Në brendësi, naosi ndahet nga ambjenti altarit nga ikonostasi prej muri. Ndriçimi bëhet nga një dritare mbuluar me hark në anën jugore.

Çatia mbulohet me çati druri e tjegulla. Me vlerë të veçantë është struktura e drunjtë me kapriata e çatisë që ruhet që nga koha e ndërtimit të kishës. Një hajat me sa duket i vonë është në anën perëndimore. Ai ka dy pilastra katrore në qoshet dhe dy shtylla druri mes tyre, të cilat mbajnë strukturat e çatisë.

Qyteti i Beratit është një nga qendrat më të rëndësishme mesjetare në të cilën ruhen mjaft ndërti-

3) Të gjitha mbishkrimet janë marë nga **Mbishkrimet e kishave të Shqipërisë** (Arkivi i Institutit të Historisë).

me të kësaj periudhe. Më të vjetrat ndër to janë rindërtimet që bëhen në gjysmën e dytë të shek. XVI në Kishën e Shën Todrit kur pikturohet nga Onufri dhe në vitin 1578 në kishën e Shën Mëri Vllahernës kur pikturohet nga Nikolla i Onufrit, të dyja këto kisha janë brenda mureve të kalasë.

Kisha e Shën Todrit ndodhet pranë hyrjes për në kala dhe ruan gjurmë të shumë rindërtimeve. Ajo përbëhet prej ambjentit kryesor ku ruhen dhe afreskat e sipërpërmendura dhe dy ambienteve anësorë të cilat ose kanë qenë paraklise (ai nga veriu ka absidë) ose hajate, por që sot janë mjaft të transformuara. Salla ndahet nga një ikonostas druri nga ambienti i altarit. Në të kemi absidën qendrore që nuk shkoi deri në fund si dhe dy absida të vogla për protezisin dhe diakonikun, si dhe dy kamare të vogla katrore në muret veriorë dhe jugorë.

Gjurmët e ndërtimeve më të vjetra ruhen në anën lindore dhe pjesën e jashtëme të qoshes verilindore, të ndërtuara me gurë e copra tjegullash ndërmjet tyre. Në gjendjen e sotme kisha me sa duket përsërit format dhe volumet e fazës ndërtimore të sh. XII.

Me interes janë dy fragmente paleokristiane të ripërdorura në dritaren dyshe të absidës 3 faqshe të sallës qëndrore. Në aspektin planimetrik salla e kishës ndodhet e rrethuar nga tetë anët me hajate të mbyllur, skemë e cila takohet dhe në kisha të kësaj periudhe të pellgut të Myzeqesë.

Kisha e Shën Mitrit: e pikturuar në vitin 1607 përbëhet nga vetë kisha dhe një hajat më i ulët që e rrethon nga tre anët, i shtuar në një kohë të dytë dhe me gjurmë të shumë rindërtimeve. Çatia e pjesës perëndimore të hajatit është më e lartë se çatia e pjesëve të tjera që janë dy ujse dhe të njejta për kishën dhe hajatet. Kisha përbëhet nga naosi dhe ambienti i altarit të ndarë nga një ikonostas i rafshtë prej druri. Ambienti i altarit përbëhet nga absida e vogël gjysëm rrethore që nuk shkon deri në tokë dhe dy nike të vogla katrore anash saj. Kisha ndriçohet nga dritarja e ngushtë si frengji e absidës dhe nga një baxhë në çati. Në sallë hyet nga anët perëndimore dhe jugore. Muret e kishës janë ndërtuar me gurë gëlqerorë dhe llaç balte. Dyshemeja e kishës është shtruar me pllaka gëlqerori e shtufi të vendosura në mënyrë të çrregullt. Duke qenë se kisha është e vendosur në terren të pjerrët, muri lindor shkon mjaft thellë ndaj dyshemesë duke lojtur rolin e një muri mbajtës për taracën ku ngrihet kisha. Po kështu muri perëndimor i hajatit lot rolin e murit mbajtës, duke u ngritur fare pak ndaj rrugës që i kalon pranë. Në këtë mënyrë në hajat hyet nga ana jugore dhe ajo veriore.

Në brendësi të krahut jugor të hajatit është një kontraforcë që mban murin jugor të kishës dhe që ka në një gur datën 1774.

Kisha e shën Kostandinit dhe Elenës është një kapelë që ndodhet në veri perëndim të shën Mëri Vllahernës. Përbëhet nga vetë kisha afërsisht katrore në plan dhe një oborr i vogël rrethor me mure të ulta. Vetë kisha është përbërë nga naosi dhe ambienti i altarit të ndarë në një ikonostas të vonë druri, ambienti altarit ka absidën gjysëm rrethore dhe dy nike për protezis dhe diakonikonin. Dyshemeja e naosit është shtruar me pllaka guri, duke patur në mes një katror me vizatime të ndryshme të shtruar me gurë dhe tulla katrore. Muret janë mbuluar me gurë dhe llaç balte, breza druri në dukje. Muri jugor, që në brendësi nuk ka afreska, ka dhe copra tjegullash, ç'ka të shtyn të mendosh se kemi të bëjmë me një mur të rindërtuar më vonë.

Në kishë hyet nga perëndimi dhe jugu. Një portë e murosur ndodhet dhe në anën veriore. Kisha ndriçohet nga një dritare e vetme e vendosur nën çatinë e murit perëndimor.

Kisha e shën Kollit pranë Vllahernës është një kishë e vogël, mbështetur mureve të teracimit, pjesë e pandarë e strukturës urbanistike të lagjes kala. Për këtë arsye absida e kishës është e mbuluar nën terenin në lindje të kishës.

Dikur pranë kishës në anën veriore ka patur një paraklis, nga i cili ruhet vetëm muri lindor me absidën. Kisha është ndërtuar me gurë të lidhura me llaç balte e breza druri krye çdo 1 m lartësi.

Një ikonostas druri ndan naosin nga ambienti altarit. Ky i fundit ka bemien dhe protezisin që nuk shkojnë deri në fund. Me interes është tryeza e altarit e përbërë nga një kapitel paleokristian dhe një shtyllë dritareje të datueshme rreth fillimit të sh. VI, dëshmi edhe kjo e qënies së një bazilike paleokristiane në Berat.

Kisha ka tre porta, mbuluar me arkitrarë druri në anën veriore, jugore e perëndimore. Nga to, dy të parat janë të murosura dhe funksionon vetëm e fundit. Kisha ndriçohet nga një dritare në murin perëndihmor menjëherë nën çati. Një nike-kamare është mbi portën perëndimore. Nga teknika e ndërtimit e ngjashme me kishat e tjera të Beratit kjo godinë duhet të jetë ndërtuar në shekullin e XVII.

Kisha e Shën Janit është një kishë e vonë (1862) ndërtuar në anën lindore të lagjes Kala. Në planimetri paraqitet e deformuar, me një lidhje në qoshen verilindore. Përbëhet nga naosi dhe ambjenti altarit, më i ngushtë sa në kishat e tjera, të ndarë nga një ikonostas druri i rafshtë. Në murin jugor ndodhet hyrja e vetëm për në kishë mbuluar me hark dhe 3 dritare, që janë kuadratike në anën e jashtëme dhe me hark të ulët në anën e brendëshme të ven-

BOTIMET

dosura si gjithnjë në pjesën e sipërme të mureve. Një dritare e tillë ndodhet dhe në murin lindor mbi absidën thuajse rrethore. Kjo e fundit ka vetëm një dritare të ngushtë. Në brendësi në këtë mur ndodhet bema që arrin deri në dysheme dhe protezisi e diakonikoni më të ulta. Dyshemeja është shtruar me gurë kuadratik dhe ka në qendër një rozetë të thjeshtë. Muret e kishës janë ndërtuar me gurë gëlqerorë me tendenca horizontale dhe mjaft rrallë copra tiegullash ndër to, lidhur me llaç gëlqereje. Muret përfundojnë me një kornizë të thjeshtë gurësh të nxjerra pak nga muri. Muri verior shërben dhe për mbajtjen e dheravе që në këtë anë arrijnë deri në mes të lartësisë së tij. Po kështu muri perëndimor është gati i tëri i mbuluar me dherat.

Kisha e Vangjelizmoit është një kishë pak më e madhe se kapelat e mësipërme, nga të cilat shquhet si nga forma arkitekturale ashtu dhe për nivelin e punimit të mureve. Vetë kishës me planimetri drejtkëndëshe i është shtuar një narteks me dy kate në anën perëndimore më i gjatë se gjerësia e kishës dhe një hajat pjesërisht i hapur në anën veriore. Kisha përbëhet nga naosi dhe ambienti i altarit prapa një ikonostasi të drunjtë. Muret e kishës janë ndërtuar me gurë gëlqerorë dhe lidhen me llaç gëlqere. Gurët e vendosura nëpër qoshet janë të skuadruara, po kështu tregojnë një përkujdesje dhe gurët e përdorur në absidën shtatë faqshe. Në anën e brendëshme absida është gjysëm rrethore dhe arrin deri në dysheme duke patur dy nike të harkuara në të dy anët dhe një të tretë në murin verior. Në kishë hyet nga dy anë, nga perëndimi nëpër narteks dhe nga veriu nëpër hajat. Gjithashtu dy dritare e lidhin me pjesën e poshtëme të narteksit kisha ndriçohet nga dritare në pjesën e sipërme të naosit në muret veriorë dhe jugorë dhe një dritare mbi absidë.

Hajati në anën veriore përbëhet prej një paraklis në pjesën nga lindja, me një absidë-nike të vogël brënda murit, dhe prej pjesës së hapur një harkadë treshe mbi kolona. Duke qenë e vendosur në teren të pjerrët, muret lindore të hajatit dhe të kishës janë më të larta.

Duke u nisur nga përmasat, teknika dhe niveli arkitektural; mendojmë se kisha duhet ti takojë shekujve XVII-XVIII.

Kisha e Shën Mëri Mesodhisë në Vuno (Vlorë) është një kapelë në planimetri drejtkëndëshe ndërtuar në një breg në jug-lindje të fshatit. Piktura e saj murale siç rezulton nga mbishkrimi është kryer në vitin 1783. Në plan kisha përbëhet nga naosi dhe ambjenti i altarit, të ndarë nga një ikonostas prej muri guri. Kisha është e ndërtuar me gurë e llaç gëlqereje, duke patur të gdhendur gurët e qosheve. Muret përfundojnë me një kornizë të lehtë prej dy rradhësh gurësh të hollë.

Në kishë hyet nga porta në anën perëndimore. Ajo është mbuluar me hark të plotë. Shpatullat dhe harku janë të ndërtuara me gurë të gdhendur. Mbi frontonin e murit perëndimor ka qenë një këmbanore me mur guri, nga e cila kanë mbetur vetëm shtyllat vertikale.

Kisha e Shën Mëhillit në Vuno (Vlorë) e pikturuar dhe kjo në vitin 1783, është ndërtuar në një tarracë brenda fshatit. Është pak më e madhe se kisha e mësipërme, duke patur të njejtën ndërtim vëllimor. Përbëhet nga naosi dhe ambienti i altarit mbrapa një ikonostasi prej muri prej gurësh. Në murin lindor del absida gjysëm rrethore e vendosur këtu jo saktësisht në qendër, por më në jug se zakonisht.

Kisha është ndërtuar prej gurësh të lidhur me llaç gëlqeror, duke patur qoshet me gurë të gdhendur. Mbi muret kalon një kornizë e thjeshtë prej gurësh të hollë, ndërsa korniza e absidës është kornizë një fishe dhëmbë sharre ndërtuar prej guri.

Në kishë hyet nga ana veriore nëpërmjet një porte mbuluar me hark. Kisha ndriçohet nga një dritare drejtkëndëshe në anën veriore, një dritare e vogël në formë drejtkëndëshi në anën jugore dhe një dritare si frëngji në absidë. Pranë kishës në qoshen veriperëndimore ngrihet një këmbanore.

Në fshatin Vuno, ruhen mjaft kapela të fundit sh. XVIII dhe fillimit të sh. XIX. Ndër to është dhe kisha e Sh. Janit me forma të njejta me të sipërmet, me çati dy ujse, absidë gjysëm rrethi që ndriçohet nga dritare të vogla në anën jugore.

Si në të gjithë fshatrat e bregut të detit dhe në Vuno e rreth tij ruhen dhe të tjera kisha njënefshe. Me interes janë gjithashtu dy ndërtime të kësaj periudhe në fshatin Dhërmi. **Kisha e Ipapandisë** vazhdon traditën e kishave njënefshe në përmasa mesatare, që me sa duken frymëzohen nga selia e vjetër e peshkopatës së Himarës sh. Sergji dhe Baku. Ajo është me planimetri drejtkëndëshe të stërgjatur duke patur në anën lindore një absidë të madhe gjysëm rrethore, është e ndërtuar me gurë gëlqerorë lidhur me llaç gëlqereje të skuadruar vetëm në qoshet e godinës.

Kisha përbëhet nga naosi dhe ambienti i altarit të ndara nga një ikonostas i gurtë. Bema gjysëm rrethore është e murosur në pjesën e poshtëme për të krijuar tryezën e altarit.

Në kishë hyet nga porta jugore duke qenë e mbuluar apo nga perëndimi. Kisha ndriçohet nga dy dritare kuadratike në anën jugore, dy në atë veriore, një nga perëndimi dhe një dritare e vogël në absidë.

Me interes të veçantë është trajtimi i murit pe-

PROTOTIPI

rëndimor të kishës, dëshmi e lidhjeve të njohura të fshatrave të Bregut të Detit me Italinë. Muri perëndimor ngrihet më lart se çatia dy ujse. Më lart akoma ai vijon anash me dy pjesë të harkuara të mbuluara me tjegulla dhe ka në qendër këmbanoren që ngrihet lart, në të cilën mbizotërojnë gjithashtu vijat e kurbuara. Këmbanorja është me dy hapsira mbuluara me harqe e një kolonë në mes. Për të gjithë atë është treguar një përkujdesje e veçantë, duke marrë kisha në këtë mënyrë një siluhetë mjaft të bukur.

Me më pak vlerë është **Kisha e Shën Thanasit** ndërtuar me muraturë të çrregullt. Përbëhet nga naosi dhe ambienti i altarit të ndara si në gjithë kishat e Bregut të Detit nga ikonostasi prej muri. Në anën perëndimore ësnte porta kryesore mbuluar me hark mbi të cilën ka një nike të harkuar. Mbi frotonin edhe këtu kemi këmbanoren, të ulët dhe pa vlerë.

Kisha e Shën Kollit në Sopik (Gjirokastër) është një kapele e vogël e vendosur në terren të pjerrët e ngritur mbi një mbushje duke patur si mur terracimi murin perëndimor. Në këtë mënyrë hyrjet për në kishë janë në anët veriore dhe jugore. Në planimetri kisha përbëhet nga naosi dhe ambienti altarit të ndarë nga ikonostasi prej muri. Bema gjysëm rrethore shkon deri në dysheme ndërsa ka vetëm protezisin të harkuar në veri të saj dhe një nike të vogël në murin verior. Kisha ndriçohet nga dy dritare në murin jugor mbuluar me arkitrarë të rratshtë dhe shpatullat ndërtuar prej gurësh shtufi të skuadruar. Po prej guri shtufi janë ndërtuar dhe muret e kishës që janë të lidhur me llaç gëlqereje.

Për nga teknika e ndërtimit, forma planimetrike duhet të jetë ndërtim i shekullit XVIII.

Kisha e Shën Kollit në Valsh (Elbasan) ndërtuar në vitin 1604 është një kishë me planimetri drejtkëndëshe e përbërë nga kisha dhe hajati i hapur mbi shtylla druri të vendosura mbi një mur bazament në të tre anët veriore, jugore dhe perëndimore. Në kishë hyet nga ana perëndimore. Naosi është i shtruar me pllaka guri në mënyrë të çrregullt dhe ndahet me një ikonostas muri nga ambienti i altarit. Kisha është e ndërtuar me gurë të përpunuar shtufi me tendencë horizontale të rreshtave, duke pasur gurë të punuar në qoshet. Me të njëjtën muraturë është edhe absida gjysëm rrethore pa asnjë dekor.

Kisha e Shën Kozmait dhe Damianoit në Sterstan (Elbasan) është me planimetri drejtkëndëshe dhe e rrethuar nga jugu e perëndimi me hajat të përhapur mbi pilastra guri e shtylla druri. Në kishë hyet nga ana perëndimore nëpërmjet një paté shkallësn. Nga naosi kalohet në ambientin e altarit të ndarë nga ikonostasi prej muri me dy hyrje, qendroren dhe verioren. Në këtë ambient kemi bemën që nuk shkon deri në tokë dhe protezisin si kamare drejtkëndëshe. Ambienti i altarit ndriçohet nga një dritare e ngushtë në absidën gjysëm rrethore që del nga muri lindor. Muret e kishës janë ndërtuar me gurë shtufi lidhur me llaç gëlqereje. Duke u nisur nga gjasimet e teknikës së ndërtimit dhe kishat e tjera të kësaj zone mendojmë se kisha duhet të jetë ndërtuar gjatë gjysmës dytë të sh. XVII.

Kisha e Shën Mërisë në Dragot të Dumres (Elbasan) paraqet një kishë drejtkëndëshe në plan, të rrethuar nga hajati i mbyllur në anët jugore dhe perëndimore. Në hajat hyet nga ana perëndimore nëpërmjet dy portave, mbuluar me hark. Hajati është si zakonisht me shtresë dheu. Prej tij po me dy porta në muret perëndimore dhe jugore kalohet ne kishe. Në të dy anët e portës perendimore janë dy dritare per të ndriçuar këtë anë të hajatit që duket se mund të shërbente si narteks.

Në murin lindor kemi bemën që shkon deri në tokë dhe dy nike rrethore si protezis dhe diakonikon. Një nike tjetër është dhe në murin verior. Kisha ndriçonet nga dy dritare të vogla në murin verior dhe një baxhë ne çati. Muret e kishës janë ndërtuar me gurë shtufi e llaç gëlqereje. Një përkujdesje e veçantë është treguar për absidën. Ajo është rrethore në pjesën e jashtme, ndërtuar me gurë të skuadruar, mbi të kalon një kornizë e rrumbullakët, mbi të cilën kemi nëndë nike harqesh të verbëra, fusha e të cilave përfundon dhe ajo me kornizë. Mbi të kalon një brez i ulët me harqe të verbër të njejtë dhe kornizë e lehtë mbi to për mbulesën me tjegulla të çatisë.

Duke u nisur nga ndërtimi planimetrik me hajat të mbyllur, dhe dekori i absidës mendojmë se kisha duhet ti takojë si ndërtim sh. XVIII.

Kisha e Shën Kollit në Melan (Përmet) është një kapele që përbëhet nga kisha, narteksi i shtuar më vonë dhe një hajat i hapur në anën jugore për ç'ka gjykohet nga fugat e kontaktit dhe ndryshimet në lartësi të tyre.

Kisha, që përbën vëllimin më të lartë, përfundon në murin lindor me një absidë rrethore dhe ka në brendësi bemën, protezisin dhe një kamare tjetër në murin verior, të cilat nuk shkojnë deri në tokë. Kisha është e shtruar me pllaka guri të vendosura në mënyrë të çrregullt. Muratura e saj është me gurë shtufi dhe llaç gëlqereje. Kisha mbulohet me rrasa guri. Ndriçimi i kishës bëhet nga dritare të vogla në pjesën e sipërme të mureve dhe dritarja e ngushtë e absidës. Narteksi është në anën perëndimore të kishës me hyrje nga jugu, nga hajati me pilastra guri dhe mure anësore nga lindja dhe perëndimi. Nga

DO NOT COPY

teknika e ndërtimit, formulimi planimetrik kisha duhet ti takojë shekujve XVII-XVIII.

Kisha e shën Mëhillit në Delvinë të Shqerisë (Përmet) përbëhet nga vetë kisha, që ze pjesën më të lartë të një bregoreje dhe hajatet e mbyllura në një çati me të, me muret pak më të ulët dhe të shtuara më vonë. Në kishë hyet nga porta në anën perëndimore. Kisha përbëhet nga naosi dhe ambienti i altarit të ndarë nga një ikonostas. Ambienti altarit ka bemën e ulët dhe një protezis të vogël me një kamare në anën veriore. Muret e kishës janë të ulëta dhe një protezis të vogël me një kamare në anën veriore. Muret e kishës janë ndërtuar me gurë shtufi e llaç gëlqereje. Absida, pjesërisht brenda një teracimi është punuar më mirë me gurë të rregullt në rreshta horizontalë. Hajatet që rrethojnë nga tre anët kishën, janë ndërtuar me muraturë, të çrregullt. Edhe ky monument duhet t'ju takojë si ndërtim sh. XVII--XVIII.

Kisha e Shën Mitrit në Potkozhan (Pogradec) është një kapelë e vogël ndërtuar me gurë shtufi të lidhur gati në të thatë me llaç balte të pakët. Për këtë arsye dhe qoshet janë ndërtuar me gurë të mëdhenj po prej shtufi. Në planimetri është gati katrore, me një hyrje të vetme të mbuluar me hark në anën perëndimore, mbi të cilën në një kohë të dytë është hapur një dritare e madhe, sepse ndriçimi fillestar ka qenë fare i pakët (dy dritare tek absidat dhe një tjetër në anën jugore). Veçanti interesante e kishës është se ka në anën lindore të dala vetëm dy absida. Ato janë drejtkëndëshe në plan dhe të dala pak nga muri. Në brendësi ato i takojnë protezisit dhe diakonikonit, ndërsa bema, një nike e vogël e njejtë për nga madhësia me dy të më sipërmet nuk del me absidë në faqen lindore. Në qoshen veri lindore kemi dy nike, një rrethore e një kuadratike në plan. Interesante është dhe mbulimi i frontoneve në lindje dhe në perëndim me kapriata të mbështetura në trarët e brezave të sipërm që dalin konsol. Datimi i kishës është i vështirë, por duke u nisur nga teknika e ndërtimit dhe struktura e çatisë mund të jetë ndërtuar rreth shek. XVII.

Kisha e Shën Minait në Vithkuq (Korçë) është një kishë njënefshe mbuluar me kapriata druri e rrasa guri. Në plan përbëhet nga kisha, narteksi dhe hajati mbi shtylla druri në anën jugore. Kisha është drejtkëndëshe në plan, me hyrje nga perëndimi, nëpër narteks dhe jugu nëpër hajat. Në anën lindore kemi bemën gjysëm rrethore me dy nike anash e një në murin verior. Në anën e jashtme absida është trefaqëshe me një nike e hark të shkallëzuar të verbër në secilën faqe. Mbi absidë është një nike e pikturuar. Si pjesa më e madhe e ndërtimeve të fshatit, kisha është ndërtuar me gurë çmërsi të skuadruar e breza druri në dukje. Narteksi është më i gjerë se sa kisha duke përfshirë dhe hajatin e hapur. Në narteks hyet nga porta e vendosur në anën jugore e mbuluar me hark të shkallëzuar. Kisha është mbuluar me rrasa guri.

Nga teknika e ndërtimit dhe dekori i absidës duket se kisha i takon fundit sh. XVII – fillimit sh. XVIII.

Kisha e Ungjillizimit në Vithkuq (Korçë) është një kapelë me narteks dhe që dikur ka patur dhe hajat në anët perëndimore dhe jugore. Muret e saj janë ndërtuar me gurë gëlqerorë dhe gurë çmërsi me breza në dukje. Në anën lindore del absida rrethore me pesë nike e harqe të verbër. Në kishë hyet nga perëndimi dhe jugu, nga porta mbuluar me hark të shkallëzuar. Nga teknika e ndërtimit kisha duhet ti takojë sh. XVIII.

Kisha e Shën Kollit në Vanaj (Lushnjë) ndërtuar në vitin 1777 është një kishë e madhe njënefshe që si gjithë kishat e pellgut të Myzeqesë në një kohë të dytë rrethohet me hajat të mbyllur nga tre anët, jugore, veriore e perëndimore, duke lënë në nivel më të lartë kishën dhe duke mos zenë në këtë mënyrë dritaret kuadratike që ndriçojnë brendësinë. Dy dritare të tjera të njejta me to, me shpatullat e arkitraun me gurë të gdhendur janë dhe në anën lindore anash absidës. Në kishë hyet me disa këmbë shkallë nga porta jugore dhe ajo perëndimore, të dyja mbuluar me hark. Naosi ndodhet nga ambjenti altarit me një ikonostas druri të gdhendur bukur. Ambienti altarit ka bemën rrethore që shkon deri në dysheme dhe niket e protezisit dhe diakonikonit që nuk shkojnë deri në tokë. Dyshemeja është me pllaka drejtkëndëshe, ndërsa nën çati ka tavan druri të ngjyrosur.

Muret e kishës janë me gurë ranor duke patur të skuadruara gurët e qosheve që janë dhe më të mëdhenj. Me gurë të punuar është ndërtuar absida rrethore e zbukuruar me shtatë harqe të verbër dekorativ, të shkallëzuar dhe me zbukurim tullash. Me sa duket për kishën është përdorur dhe material i marë nga Pojani kështu veç gurëve janë murosur dhe kapitele e fragmente arkitekturale.

Hajatet janë ndërtuar me gurë të çrregullt dhe llaç balte e pa tavane. Çatia e pjesës perëndimore të hajatit duke qenë në shtrirje të madhe mbahet mbi katër rradhë kolonash.

Kisha me format e qarta arkitekturale, teknikën e rregullt dhe përmasat e saj flet për kërkesa arkitekturale të porositësve dhe mjeshtëri të ndërtuesve.

Kisha e Shën Kollit në Toshkëz (Lushnje) ndërtuar në vitin 1811 është një kishë njënefshe me përmasa të mëdhe, që dëshmon për një fazë të re në ndërtimin e kishave të vendit tonë. Përbëhet nga ki-

DO NOT COPY

sha dhe hajati që e qarkon nga tre anët. Kisha është e ndërtuar me gurë dhe llaç gëlqere në pjesën e poshtëme dhe kulla në pjesën e sipërme, me një trashësi të murit më të vogël duke krijuar një dhëmbë ku mbështetet më vonë struktura e çatisë së hajateve nga jugu dhe veriu. Ndërsa çatia e pjesës perëndimore mbahet në kolona druri.

Me anën e një ikonostasi prej druri të gdhendur naosi ndahet nga ambienti i altarit, i cili përbëhet nga bema që del me absidë jashtë murit lindor, protezisi dhe diakonikoni. Absida është shtatë faqesh, relativisht e ulët dhe ndërtuar me gurë të gdhëndur.

Krahas kishave të mësipërme ruhen dhe një numur i madh kishash të tjera, vlera e të cilave për studimin e historisë së arkitekturës dhe kulturës materiale të vendit tonë është e pakët. Një përmendje të veçantë këtu duhet t'ju bëjmë kishave që janë rindërtuar dhe që ruajnë pjesë të vjetra të periudhës së para pushtimit turk. Të tilla janë kisha e Shën Mëri Vllahernës në Berat rindërtuar në 1578, shek. Kolli Kurjan (Fier) e sh. XVI, Shën Mëria Dhërmi (Vlorë) 1781, Shën Ilia Buhal (Përmet) që ruan gjurmë të dy rindërtimeve, më i voni i sh. XIX, Shën Stefani në Dhërmi (Vlorë) si dhe shtesat e shumta të bëra kishave të tjera të periudhës bizantine.

2. KISHAT ME MBULESË ME QEMER CILINDRIK

Në këtë nëngrup bëjnë pjesë ato kisha të cilat mbulohen me qemere cilindrike. Mjaft prej këtyre kishave kanë pilastra në muret gjatësorë të lidhura me harqe që lozin rolin e brinjëve të qëndrueshmërisë të këtij qemeri.

Kisha e Shën Anës Dervican (Gjirokastër) është ndërtuar mbi një terren të pjerrët shkëmbor. Ajo ka hyrje në anën perëndimore. Në plan një ikonostas prej muri ndan naosin nga ambienti i altarit, i cili ka vetëm bemën, absida e vogël e së cilës del jashtë murit lindor në formë gjysëm rrethi. Në muret gjatësorë ka nga dy çifte pilastrash me harqe mbajtës mbi ta përgjatë mureve. Mbi këto pilastra tërthor të parëve kemi harqe të tjerë mbajtës, ndërsa tërë mbulesa është me qemer cilindrik me formuese lindje-perëndim. Në këtë mënyrë formohet një strukturë mjaft e qëndrueshme dhe që përballon me lehtësi shtytjet e qemereve dhe harqeve.

Poshtë naosit ka një qimiter, i cili si rezultat i terrenit të pjerrët është ndërtuar vetëm në 2/3 e gjatësisë së kishës. Qimiteri është thuajse katror në plan me një pilastër në mes duke krijuar katër bërthama. Nga to ato nga lindja mbulohen me kalota sferike, perëndimoret me qemer cilindrik.

Në trajtimin e jashtëm kisha është e varfër në përpunimin dekorativ, i është kushtuar rëndësi vetëm proporcioneve duke nënvizuar ngritjen në lartësi, për këtë ndihmon ngritja e kishës nëpërmjet një shkallëzimi mbi platformën e krijuar nga qimiteri i cili përsëritet dy herë në lartësi. Muret e kishës janë ndërtuar me gurë gëlqerorë lidhur me llaç gëlqereje. Duke u nisur nga ndërtimi konstruktiv afër skemave të vjetra të periudhës bizantine, kisha duhet të jetë ndërrtuar në sh. XVI.

Naosi i Kishës së Shpërfytyrimit në Çatishtë (Gjirokastër) ndërtuar në vitin 1584 paraqitet më e zhvilluar në aspektin e ndërtimit vëllimor e struktural. Ajo është një kishë njënefshe, drejtkëndëshe në plan dhe e stërgjatur. Përbëhet prej tre pjesësh në aspektin struktural. Pjesët nga lindja dhe perëndimi janë mbuluar me qemere cilindrike me formuese lindje-perëndim, ndërsa pjesa qendrore që ngrihet dhe më lart ndaj mbulesës të pjesëve të tjera, është mbuluar me qemer cilindrik tërthor kishës, pra me formuese veri-jug. Në plan kjo ka edhe dy absida në jug e veri dmth kisha është e tipit trekonkësh.

Në kishë hyet nga porta e vetme në anën perëndimore mbuluar me arkitra të rrafshët. Në murin lindor është bema gjysëm rrethore që shkon deri në tokë dhe një nike e vogël si protezis. Një dritare në absidën lindore me një në atë jugore ndriçojnë dobët kishën. Muret e kishës janë ndërtuar me gurë dhe llaç gëlqereje, ndërsa dyshemeja është shtruar me pllaka të rregullta guri.

Kisha e Shën Dëlliut në Jorgucat (Gjirokastër) është pikturuar në vitin 1586 dhe përbëhet nga naosi, narteksi dhe një ekzonarteksi më i gjerë se kisha në anën perëndimore të mbuluara me një çati dy ujse. Hyrja për në ekzonarteks është në anën veriore. Prej këtij kalohet në narteks, nëpërmjet një porte në murin perëndimor të tij. Narteksi është i mbuluar me qemer cilindrik me formuese lindje-perëndim dhe ndriçohet nga dritare të vogla në faqet veriore dhe jugore. Hyrja për në naosin e kishës bëhet nga narteksi. Naosi është drejtkëndësh i stërgjatur dhe i tipit trekonkësh. Në murin lindor është bema që shkon deri në tokë dhe anash saj dy nike të vogla si protezis dhe diakonikon. Edhe naosi mbulohet me qemer cilindrik me formuese lindje-perëndim.

Nga të tre absidat trefaqshe ajo nga lindja që është dhe më e vogël zbukurohet nga tre nike me harqe të verbër. Në secilën absidë ka dritare për ndriçim; po kështu dritare kemi dhe në muret anësorë. Në murin verior kemi një arkadë të përngjitur murit që shkon në tërë lartësinë e mbaron me kornizë dhëmbë sharre. Arkada mbështetet mbi pilastër katrore, me përjashtim të dy shtyllave në harkun mbi portën e hyrjes për në ekzonarteks.

DOKUMENT

Muratura e kishës është prej gurësh gëlqerorë të rregullt lidhur me llaç gëlqereje.

Shën Kolli në Dhrovjan (Sarandë) është një kishë trekonkëshe e përbërë nga naosi dhe narteksi i shtuar më vonë në anën perëndimore dhe mbuluar me çati druri, si dhe një hajat të hapur me shtylla druri në anën perëndimore. Në kishë hyet nga porta perëndimore. Naosi përbëhet nga tre pjesë të ndara nga pilastra në muret mbi të cilët ngrihen harqe mbajtës të qemereve që mbulojnë të tre pjesët dhe që janë me formuese lindje-perëndim. Absidat veriore dhe jugore janë në pjesën e tretë menjëherë mbas pilastrave ato shkojnë deri në tokë dhe kanë nga një dritare të ngushtë për ndriçim. Në murin lindor është bema me protezisin dhe diakonikonin. Të tre absidat janë trefaqshe në anën e jashtme. Naosi ndriçohet ngo dritaret e absidave dhe tre dritare në anën jugore.

Kisha është ndërtuar me gurë gëlqerorë dhe llaç gëlqereje dhe nuk ka ndonjë dekoracion. Muret përfundojnë me kornizë të rrafshtë mbi të cilat është çatia me rrasa guri. Me kohë për të përballuar shtytjen e qemereve që rrezikoheshin të rrëzoheshin janë ndërtuar kontraforte.

Duke u nisur nga ndërtimi planimetrik i ngjajshëm me kishën e Jorgucatit e atë të Derviçanit mendojmë se ndërtesa duhet ti takojë fundit të sh. XVI.

Kisha shën Thanasit në Goranxi (Gjirokastër) ndërtuar në vitin 1732 përbëhet nga kisha, që i takon ndërtimit të vjetër dhe një sërë aneksesh nga të tre anët. Në kishë hyet nga porta në anën perëndimore. Vetë kisha është me planimetri drejtkëndëshe, me absidën gjysëm rrethore në anën lindore. Kisha mbulohet me qemer cilindrik me formuese lindje-perëndim, por që ka një veçanti që duket qartë se është e kërkuar. Ndërsa në anët lindore e perëndimore qemeri është i rregullt, në pjesën qendrore ai formon afërsisht një kësulë sferike. Dyshemeja e kishës është e shtruar me pllaka, muratura është me gurë gëlqerorë e llaç gëlqereje, ndërsa ajo e shtesave me gurë të vendosur në të thatë. Tullat janë përdorur vetëm në dekorin e frontonit lindor, të formuar nga breza prej tullash të vendosur në zig-zag e vertikalisht.

Kisha e shën Kozmait e Damianoiut në Vithkuq (Korçë) është qimiteri i manastirit të shën Pjetrit ndërtuar në mezin e sh. XVIII në një kodër shkëmbore në lindje të fshatit. Për vetë funksionin e ndërtimin me dy kate është zgjedhur një terren i pjerrët e i tarracuar. Në katin e sipërm ndodhet kapela me narteksin, në katin e poshtëm qimiteri. Në kishë hyet me një portë në anën perëndimore të narteksit mbuluar me hark të ulët e një nike mbi të. Narteksi mbulohet me qemer cilindrik me formuese lindje-perëndim. Në anë veriore të narteksit janë shkallët mjaft të pjerrta për në qimiter. Me një portë me hark të ulët hyet në kapelën drejtkëndëshe shtruar me pllaka guri e mbuluar me qemer cilindrik me tirande druri. Në murin lindor janë tre nike rrethore, nga të cilat bema që është dhe më e madhe ka një dritare të vogël. Një dritare tjetër e vogël është në qemer, e një tjetër në frontonin perëndimor. Veçanti e kapelës është se nuk ka absidë në dukje në anën e jashtëme.

Qimiteri ndriçohet nga dritare të vogla, dy në anën veriore e një në anën lindore, që janë të lira, pra jo në kontakt me terrenin. Kisha është ndërtuar me gurë gëlqerorë e llaç gëlqereje të vendosur në rreshta horizontale nëpërmjet një punimi të lehtë. Në kompaktësinë e ndërtimit dhe muret e rafshtë, duke qëndruar mënjanë manastirit kisha tregon qartë funksionin e saj.

Kisha e shën Mërisë në Seranj-Perat (Përmet) përbëhet prej naosit, narteksit dhe ambienteve shtesë mjaft të vona në anën perëndimore dhe atë jugore. Si naosi edhe narteksi mbulohen me qemere cilindrike me formuese lindje-perëndim, të cilët janë në nivele të ndryshme, ç'ka përbën një veçanti e cila pasqyrohet edhe në vëllimin e jashtëm të ndërtesës. Veç kësaj edhe vetë mbulesa e naosit përbëhet prej qemeresh në nivele të ndryshme, kemi një qemer pak më të lartë në pjesën qëndrore.

Në kishë hyet nga porta perëndimore e narteksit, i cili lidhet dhe me naosin, ashtu edhe drejtpërdrejtë në naos nga një portë në anën jugore. Narteksi ndriçohet nga tre dritare dy në anën jugore dhe një në anën veriore. Mbulesa me qemer e narteksit është në lartësi të madhe, që mund të shpjegohej me dëshirën për të ndërtuar në të një kat të dytë mbi struktura druri.

Muret e kishës janë të ndërtuar me gurë shtufi me tendencë horizontale lidhur me llaç gëlqereje. Ato përfundojnë me korniza prej gurësh mbi të cilat fillon mbulesa me rrasa guri e çatisë. Kisha, për sa mund të gjykohet nga ndërtimi vëllimor dhe teknika e mureve duhet të jetë ndërtuar në shekullin e XVIII.

Kisha e shën Triadhës Kardhikaq (Sarandë) është pikturuar në vitin 1827. Ajo përbëhet nga kisha dhe narteksi i rënuar në anën perëndimore. Në kishë hyet nga dera në anën perëndimore. Brenda ndahet në 4 pjesë nëpërmjet 3 çifte pilastrash në muret gjatësorë mbi të cilat kalojnë harqe mbajtës. Hapsira e tretë nga hyrja është e mbuluar me qemer cilindrik me formuese veri-jug dhe ngrihet më lart se pjesa tjetër e mbulesës, duke formuar në këtë mënyrë një transept me frontonë në veri dhe jug dhe me çati të veçantë dy ujse nga çatia tjetër e kishës dhe tërthor saj duke formuar në çati kryqin. Në anën lindore del

Do not copy

absida gjysëm rrethore e zbukuruar me harqe tullash dhe me kornizë të rregullt gurësh.

Kisha ndriçohet nga dritaret e transeptit, absidës dhe një dritare në murin jugor. Dyshemeja e kishës është shtruar me pllaka guri. Muratura është me gurë e llaç gëlqereje, duke patur gurë të skuadruar në qoshet, dhe dritare.

3. KISHAT E TIPIT SALLË ME KUPOLË

Kishat e këtij tipi kanë të përbashkët ekzistencën e një bërthame qendrore, zakonisht katrore, të mbuluar me kupolë. Për këtë në muret gjatësore dalin pilastra, të cilat lidhen me harqet mbajtëse në të dy drejtimet, duke formuar kështu katrorin për kupolën. Këto mund të përbëhen prej një elementi të tillë, prej disave rrjesht apo të bashkuar me pjesë të mbuluara me qemere dhe në këtë rast kupola mund të ngrihet me tambur mbi çatinë e pjesëve të tjera të kishës.

Kisha e shën Mërisë në Barmash (Ersekë) pikturuar në vitin 1616, përbëhet nga naosi ambienti i altarit narteksi dhe hajati i vonë në anën jugore. Naosi, tek i cili hyet nga ana jugore, përbëhet nga dy bërthama katrore dhe një drejtkëndëshe. Bërthamat anësore mbulohen me kësula sferike direkt mbi harqet mbajtës, sepse pilastrat në mure formojnë pjesë katrore. Bërthama qendrore pranë harqeve mbajtëse ka në anët veriore dhe jugore nga një hark të dytë që zvogëlon hapësirën dhe krijon katrorin mbi të cilën ngrihet kësula sferike. Naosi ndriçohet nga dy dritare në murin jugor dhe një baxhë që hapet në çati. Ambienti i altarit relativisht i ngushtë mbulohet me qemer cilindrik me formuese lindje-perëndim dhe përbëhet nga bema që shkon deri në tokë në brendësi dhe del në faqen lindore me absidë trefaqshe dhe protezisin e diakonikonin me të vogla se bema si dhe dy nike të tjera në muret veriorë dhe jugorë.

Narteksi përbëhet prej dy bërthamash të formuara si më lart me pilastra e harqe mbajtës e të mbuluara me kësula sferike. Narteksi ndahet nga naosi me një mbushje të harkut mbajtës që i ndan, duke patur për lidhje një portë të ulët. Ai ndriçohet nga tre dritare të vogla në murin perëndimor. Hajati i shtruar më vonë është i hapur në anën jugore mbi shtylla druri.

Muratura e kishës është e çrregullt me gurë e llaç gëlqereje, ndërsa muratura e hajatit me gurë e llaç balte.

Narteksi i kishës Shpërfytyrimit në Çatistë (Gjirokastër), që i shtohet në vitin 1627 kishës që pamë më lart, përbëhet prej një ambienti mbuluar me kupol dhe një hajat të vogël me këmbanoren. Në planimetri narteksi rezulton i njejtë me kishat bizantine në formë kryqi pa mbështetje të lira dmth me katër pilastra në qoshet, mbi të cilat ngrihen harqet për kupolën për tamburin e lartë. Tamburi është tetëfaqësh me koloneta guri në qoshet mbi të cilat kalojnë harqe të shkallëzuar.

Në katër anët kryesore ka dritare të ngushta e të larta mbuluar me harqe tullash. Ndriçimi bëhet dhe nga dy dritare në muret veriorë dhe jugorë. Muratura është me gurë e llaç gëlqereje. Në aspektin e ndërtimit, ashtu dhe atë arkitektural kisha i takon një fazë më të përparuar, për vetë proporcionet e hedhura të tamburit me kupolë dhe trajtimin dekorativ të tij.

Kisha e shën Gjergjit në Demë (Sarandë) shquhet për zgjidhjen unikale të kupolës. Kisha përbëhet nga naosi dhe ambienti i altarit. Në kishë hyet nga ana perëndimore. Në muret veriore dhe jugore janë dy palë pilastra të cilët e ndajnë në 3 pjesë kishën dhe mbi ta ngrihen harqe mbajtës. Dy pjesët anësore që janë më të vogla mbulohen me qemerë cilindrik me formuese lindje-perëndim. Pjesa qëndrore mbulohet me kupolë. Mbi kyçet e harqeve të bërthamës bazë mbështeten harqe të cilët ngushtojnë bazën duke i takuar bazamentit të tamburit. Një grup tjetër harqesh, edhe këta mbi kyçet e harqeve të mësipërme, ngushtojnë akoma më tepër bazën e kupolës, duke qenë brënda tamburit. Mbi këtë bazë të vogël ngrihet kësula sferike e mbulesës, në muret e së cilës janë katër dritare të ngushta për ndriçim. Në këtë mënyrë hapsirës së brendshme i jepet një sens me të vërtetë dinamik që dëshmon njëkohësisht edhe për njohuritë konstruktive të ndërtuesve, për deri sa dalin jashtë skemave tradicionale.

Ambjenti i altarit ndahet nga naosi nga një ikonostas muri në vendin e pilastrave të dyta. Ai përbëhet nga bema që shkon deri në tokë dhe del poshtë murit lindor me absidë trefaqshe. Anash saj janë dy nefe të vogla. Ndriçimi i kishës bëhet dhe nga dy dritare në muret e naosit dhe një tjetër në ambientin e altarit.

Muret e kishës janë ndërtuar me gurë e llaç gëlqereje. Nga format e zhvilluara si në aspektin struktural ashtu dhe në atë arkitektural kisha duhet të jetë ndërtuar në fundin e sh. XVII fillimin e sh. XVIII.

Kisha e shën Mërisë në Vithkuq (Korçë) është ndër përfaqësuesit më tipik të këtij tipi. Ajo përbëhet nga naosi, narteksi i vonë dhe hajati në anën jugore në tërë gjatësinë e kishës. Në naos hyet si nga porta në anën jugore ashtu edhe nëpërmjet narteksit nëpërmjet një porte në murin perëndimor. Në plan naosi ka një formë paksa të zgjatur. Dy

DO NOT COPY

çifte pilastrash në muret gjatësore, të lidhur me dy drejtimet me harqe mbajtës, krijojnë tre hapsira, ndër të cilat ajo qëndrorja e mbuluar me kësulë sferike mbizotëron mbi dy të tjerat. Hapësira perëndimore mbulohet me qemer të kryqëzuar ndërsa ajo lindore, që është mjaft e ngushtë ka për mbulesë një qemer me prerje çerek rrethi. Hapësira e vogël e ambientit altarit, rritet deri diku nga dalja e absidës rrethore në murin lindor.

Në brendësi kisha është mjaft e errët dhe ndriçohet nga një dritare e ngushtë në murin jugor dhe dritaret e absidës shumë faqshe. Absida ka 7 faqe – nike të mbuluara me hark në formë fund lundre. Absida si dhe në përgjithësi muret e kishës janë ndërtuar me gurë çmërsi të skuadruar.

Në një kohë të dytë i është shtuar kishës në anën perëndimore narteksi ndërsa në anën jugore hajati mbi shtylla druri. Në këtë mënyrë nga jashtë kisha ka marë një formë të zgjatur, të mbuluar me çati dhe rrasa guri e cila ka një prerje në anën lindore, duke u kthyer me tre kullime uji. Për datimin e kishës element me rëndësi është dekori i absidës me harqe në formë fund lundre, i cili e shpie atë në fundin e shekullit XVII deri në fillimin e sh. XVIII.

Kisha e Manastirit të Shën Kollit Dhivrit (Sarandë) ndërtuar në vitin 1736 përbëhet nga naosi dhe narteksi në anën perëndimore i shtuar më vonë. Naosi është i tipit trekonkësh. Në planimetri, dy çiftet e pilastrave e ndajnë naosin në tre pjesë, nga të cilat anësorët mbulohen me qemere cilindrik, ndërsa qendrorja, që ka dhe dy absidat veriore dhe jugore mbulohet me kupol mbi tambur. Të tre absidat janë trefaqshe dhe kanë nga një dritare të lartë të mbuluar me hark prej gurësh, rrethor me një rresht tullash të vendosura për së gjati që zbret në tërë lartësinë e dritareve. Tamburi tetëfaqësh ka në secilën faqe edhe ai nga një dritare mbuluar me hark tullash të vendosura sipas rezeve.

Kisha është e ndërtuar me gurë gëlqerorë e llaç gëlqereje. Muret e saj si dhe absidat përfundojnë me një kornizë prej guri të profiluar lehtë. Prej murature guri dhe mbuluar me çati me kapriata është dhe narteksi i vonë ai ka dy dyer në anën veriore dhe dy dritare në anën jugore. Një portë e murosur ndodhet në anën veriore të kishës.

Nga pikpamja e ndërtimit arkitektural kisha paraqitet e zhvilluar, me një siluhetë mjaft të hijshme e hapësirë të brendshme të goditur.

Kisha e Shën Mëhillit në Shalës (Ersekë) është e ndërtuar sipas skemës që takojmë dhe në Barmash, d.m.th me bërthama katrore mbuluar me kupola. Kisha ka vazhduar dhe në anën perëndimore, ku ka patur narteksin i cili sot është i rënuar. Ambienti altarit është i ngushtë dhe mbuluar me qemer cilindrik. Në faqen lindore bema del me absidë pesëfaqe she me një dritare të vogël katrore. Ndriçimi i kishës bëhet nga tre dritare drejtkëndëshe me arkitrarë gur e një nike lehtësuese me hark mbi të. Kisha është ë ndërtuar me gurë shtufi të lidhur me llaç gëlqere duke patur gurë të mëdhenj të gdhendur në qoshet Një mbishkrim flet për rindërtimin më 1810 të kishës në të cilin është e vështirë të përcaktohet çfarë është ruajtur nga ndërtimi i vjetër.

Kisha e Shën Thanasit në Selenicë (Vlorë) para qet tipin sallë me kupol në dukje mbi tambur, me sa duket të ndërtuar nën influencën e kishës së Shën Kollit në fshatin Armen që ndodhet pranë. Është ë ndërtuar me gurë e llaç gëlqereje. Kisha ka plani metri drejtkëndëshe të ndarë në tre pjesë nëpërmje dy çifte pilastrash, në muret veriorë dhe jugorë dhe përfundon në anën lindore me një absidë gjysëm rrethore të vogël.

Në pilastrat kalojnë harqe mbajtës, po kështu edhe në muret gjatësorë të pjesës qëndrore. Dy pjesët anësore mbulohen me qemere cilindrike me formuese lindje-perëndim, ndërsa pjesa qëndrore mbulohet me kupol. Si dhe në Armen, kjo pjesë është drejtkëndëshe, por, kupola është e rregullt, duke ardhur e ngushtuar në anët veri e jugë në formë konsolash për të formuar kuadratin për kupolën.

Dyshemeja e kishës është me pllaka të rregullta drejtkëndëshe prej guri shtufi. Mbi çatinë dy ujse të kishës ngrihet kupola me tamburin cilindrik.

Kisha duhet të jetë ndërtuar në fund të shek XVIII – fillim të sh. XIX duke u nisur për këtë nga rregullshmëria e formave dhe teknika e rregullt ë përdorur.

Në një kohë të vonë kishës i shtohet një hajat hapur, i cili në anën perëndimore kthehet më vonë në një narteks dy katësh, gjë që shkakton transformime në murin perëndimor dhe në naos.

* * *

Në këtë parashtrim të kishave njënefshe të vendi tonë ju përmbajtëm ndarjes tipologjike dhe përgji thësisht renditjes kronologjike. Duke qenë se këto kisha ndërtohen edhe njëkohësisht me kisha të ti pave të tjerë më të zhvilluar në aspektin e ndërti mit planimetrik e vëllimor dhe trajtimit arkitektural shqyrtimi i veçantive dhe përfundimet do të nxirren njëherësh mbas shqyrtimit të të gjithë monumenteve

DO NOT COPY

KISHAT ME MBULESE DRURI

DO NOT COPY





SHEN GJERGJI - *Leshnicë e Sipërme*



SHEN MITRI - *Polican*
GJIROKASTER





SHEN THANASI - *Pecë*



DO NOT COPY









SHEN SOTIRI - Tremisht PERMET

SHEN TODRI - Berat





SHEN JANI - Berat



0 1 2 3 4 5m

DO NOT COPY







SHEN KOSTANDINI DHE ELENA
KALA - *Berat*



SHEN MITRI - *Kala - Berat*

SHEN KOLLI - *Berat*











SHEN VANGJELIZMO
Vithkuq





SHEN MEHILLI - *Vuno*











SHEN MERI - *Mesodhi*

SHEN KOLLI - SOPIK - *Gj*

DO NOT COPY

KISHAT ME MBULESE DRURI

DO NOT COPY





SHEN GJERGJI - *Leshnicë e Sipërme*



SHEN MITRI - *Bolçan*
GJIROKASTER





SHEN THANASI - *Pecë*



DO NOT COPY







SHEN TODRI - *Berat*



SHEN SOTIRI - *Tremisht* PERMET





SHEN JANI - *Berat*





DO NOT COPY







SHEN KOSTANDINI DHE ELENA
KALA - *Berat*



SHEN MITRI - *Kala - Berat*

SHEN KOLLI - *Berat*







DO NOT COPY



SHEN
VANGJELIZMO
Vithkuq





SHEN MEHILLI - *Vuno*









0 1 2 3 4 5

SHEN MERI - *Mesodhi*



SHEN KOLLI - SOPIK - *Gjirokastër*

DO NOT COPY









SHEN IPAPANDIA - *Dhërmi*

SHEN KOLLI *Valsh - Elbasan*





SHEN KOZMAI E DAMIANOI - *Sterstan*

0 1 2 3 4 5 m

DO NOT COPY







SHEN THANASI - *Dhërmi*



SHEN MERIA *Dragot* - DUMRE



SHEN KOLLI - *Melan*

0 1 2 3 4 5m



DO NOT COPY









SHEN MEHILLI - *Delvinë* - SHQERI

SHEN MINAJ - *Vithkuq*





SHEN VANGJELIZMOJA - *Berat*

DO NOT COPY





SHEN KOLLI - Potkozhan





SHEN THANASI - Joshkez

SHEN KOLLI - Vanaj







KISHAT E MBULUARA ME QEMER CILINDRIK







SHEN KOLLI · *Dhrovjan*







PANAJOTOPULLA *Dervican*



SHPERFYTYRIMI *Çatistë*

0 1 2 3 4 5 m

DO NOT COPY

DO NOT COPY









SHEN KOZMAI - Vithkuq





SHEN TRIADHA Kardhikaq



DO NOT COPY



SHEN MERIA · *Seran - Perat* PERMET



SHEN THANASI · *Goranxi*









0 1 2 3 4 5m

DO NOT COPY







SHEN DELLIU
Jolqucat

DO NOT COPY

KISHAT E TIPIT SALLE ME KUPOLE







SHEN MERIA *Barmash* - ERSEKE







SHEN GJERGJI - *Demë*



DO NOT COPY









SHEN MERIA · Vithkuq



SHEN KOLLI · Dhivër





DO NOT COPY







SHEN THANASI - *Selenicë - Vlorë*





SHEN MEHILLI - *Shalës*



Aleksandër MEKSI, Piro THOMA

DO NOT COPY

L'ARCHITECTURE POSTBYZANTINE EN ALBANIE LES EGLISES A NEF UNIQUE

RESUME

L'étude des temples chrétiens de la période de l'occupation turque présente un grand intérêt du fait qu'elle nous permet de connaître à fond non seulement l'arcihtecture de cette période, le niveau technique des constructions et l'aptitude des maîtres bâtisseurs, mais encore d'éclaircir plusieurs aspects de l'histoire du peuple albanais. Cette catégorie de monuments a été très peu étudiée jusqu'à ce jour. Nous avons dans ce domaine une esquisse de S. Adhami sur les églises de Voskopoja et une communication des auteurs du présent article, qui est le résultat d'un travail de longue haleine effectué sur le terrain afin de dépister, d'étudier et de restaurer cette grande richesse que sont les temples chrétiens. Le but de cet article et d'autres qui paraîtront par la suite est celui de publier les monuments étudiés et de procéder à des synthèses et de tirer des conclusions dans une deuxième période.

Dans ce type de construction nous relevons la continuité de plusieurs principe figuratifs et de construction de l'architecture byzantine adaptés aux nouvelles conditions socio-économiques. Sous cet aspect la fusion de ce type d'architecture dans le territoire de notre pays est un résultat de la fusion de l'architecture de la période byzantine dans l'Albanie méridionale et en partie dans celle centrale.

Les premières églises construites au cours de cette période appartiennent à la première moitié du XVIe siècle. Parmi ces monuments et ceux construits en grand nombre jusqu'au XXe siècle, nous avons choisi précisément les temples qui fournissent des informations sous différents aspects sur cette architecture et sont indispensable pour la connaître et l'étudier.

Malgré la grande variété des types employés, la grande extension territoriale et dans le temps de ces monuments, compte tenu de leur composition planimétrique et volumétrique et de leur construction structurale, les édifices de cette période peuvent être classifiés en trois grands regroupements. Nous avons choisi ce critère parmi tant d'autres du fait que ces particularités ont joué un rôle primordial dans la formulation de l'intérieur et de l'extérieur de l'édifice. Outre ce groupement, l'examen des monuments conservés, en tenant compte de leur évolution architecturale et leur disposition dans le temps, nous permettra de mettre en relief la voie que ces édifices ont suivi dans le temps et les conditions qui ont apporté à la construction des divers types d'entre eux dans les différentes régions du pays. Selon ce critère les églises postbyzantines de notre pays peuvent être divisées en:

I. Eglises à nef unique;

II. Eglises dont la structure est en forme de croix à coupole;

III. Basiliques.

Les églises à nef unique, qui font l'objet de ce premier article, représentent le type le plus simple. De dimensions plus ou moins petites, elles ont été construites presque partout et pendant toute la période en question. Leur construction planimétrique et volumétrique présente des traits particuliers en fonction de la structure de la couverture de la salle de l'église. Ainsi, nous avons des églises couvertes d'un toit de bois, des églises couvertes de voûtes cylindriques et des églises de type salle à coupole.

1. — Les églises à couverture de bois. Ces églises ont été édifiées partout et en tout temps du fait qu'elles étaient faciles à construire. Elles se caractérisent par le fait qu'elles ont un toit reposant sur des structures de bois à deux pendages et couvertes de tuiles ou d'ardoise. Les murs extérieurs de ces monuments ne comportent pas des décorations. De planimétrie angulaire avec des murs plats, ces églises sont peu illuminées par des fenêtres aménagées dans la partie supérieure des murs. L'autel est séparé du naos par une iconostase de bois ou de mur. La plupart de ces églises ont été successivement pourvues d'un narthex ou d'un hayat. *Les exemplaires les plus anciens sont l'église de Shen Gjergj à Leshnice e sipërme (district de Sarande) construite en 1525, l'église de Shën Thoma a Pece (Saranda) construite en 1525 et d'autres temples des XVIe.-XVIIe s. qui se distinguent par leurs dimensions petites et la pauvreté de leur construction. Plus tard, aux XVIIIe-XIXe s., les dimensions deviennent plus grandes et le niveau de construction est plus élevé. Mentionnons en l'occurrence les églises de Vuno, de Dhërmi et surtout de la Myzeqe, où le temple dédié à Shen Koll dans le village de Vanaj (Lushnje) a été construit en 1777 et celui de Shen Koll dans le village de Toshkez (Lushnje) en 1811; les dimensions de ces deux églises indiquent une phase nouvelle dans la construction des monuments de culte dans notre pays.*

2. — Les églises ayant une couverture à voûte cylindrique. Ce sous-groupement comporte les églises couvertes d'une voûte cylindrique. Plusieurs d'entre elles sont dotées de pilastres dans leurs murs longitudinaux qui jouent le rôle des côtés de la stabilité. Des exemples illustrés il ressort que l'édifice du temple est conservé et que son naos est couvert d'une voûte cylindrique avec des formants est-ouest (l'église de Shen Kozma de Damianoj à Vithkuq, l'église de Shen Ilia à Yorgucat); ailleurs (dans l'église de Shen Ana à Deniçan et dans celle de Shen Koll à Dhrovjan), l'édifice comporte des voûtes cylindriques dotées de côtés de la stabilité et d'arc d'appui qui les surmontent; et enfin des églises, dont une partie de la couverture à voûte fait saillie dans le toit du naos. Ces parties sont couvertes d'une voûte avec des formants est-ouest (l'église de Shën Meri à Seran de Berat) ou d'une voûte avec des formants nord-sud, qui en l'occurence fait saillie dans le toit sous forme d'un transept l'église du monastère de la Transfiguration à Çatiste (Gjirokastër), l'église de Shen triadh à Kardhiq (Saranda), ce qui influe davantage sur la formulation architectonique des églises. La plupart de ces églises sont des églises de monastères et elles se distinguent par la présence de deux autres absides sur les côtés nord et sud de la planimétrie.

3. — Les églises du type salle à coupole. Elles sont une continuation d'un type assez ancien, qui a connu une diffusion relativement grande au cours de cette période. Les églises de ce type ont en commun la présence d'un noyau central, en général de forme carrée, qui est couvert d'une coupole. C'est à cette fin que le long des murs longitudinaux font saillie des pilastres, qui se relient aux arcs de protection dans les deux directions et forment ainsi le quadrilatère de la coupole. Les églises de ce type comportent un seul élément semblable ou plusieurs disposés successivement ou réunis avec la partie couverte de voûtes; dans ce dernier cas la coupole peut être édifiée à tambour sur la toiture des autres parties de l'église.

Parmi les monuments plus anciens citons l'église de Shen Meri à Barmash (district d'Erseka), qui comporte cinq éléments à coupole couverte d'un toit à deux pentes; la peinture murale, qui s'y trouve, indique que cette église a été construite en 1616. L'église de Shen Mehill à Shales (district d'Erseke) est identique à la précédente. Quant au type à coupole sur tambour agencé dans le toit, il est représenté par les autres constructions comme le toit de l'église de la Transfiguration à Çatiste (Gjirokaster), l'église de Shen Gjergj à Deme (Sarande), l'église de Shen Meri à Vithkuq (Gjirokaster), l'église de Shen Koll à Dhiver (Sarande) et celle de Shen Thanas à Selenice (Vlore).

Dans cet exposé les auteurs s'en sont tenus à la division typologique et en général à l'ordre chronologique. Etant donné que ces églises ont été édifiées en même temps que d'autres types plus avancés sous l'aspect planimétrique et volumétrique et du traitement architectural, l'examen de leurs traits caractéristiques et les conclusions seront tirées simultanément après l'étude de tous les monuments de l'architecture postbyzantine.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Leonard SULI

RESTAURIMI DHE ARKITEKTURA E DY BANESAVE NË FSHATIN SOPOT*

DO NOT COPY

Qëllimi i këtij artikulli, që ka për objekt dy banesa me interes të veçantë arkitektonik, është të paraqesë vlerat e tyre si dhe punimet e restaurimit të kryera në to. Megjithëse nga ana tipologjike ato janë larg njera tjetrës, prapëseprapë i bashkojnë mjaft koncepte dhe shumë elemente, e sidomos fryma e shëndoshë krijuese që përgjithësisht shquan krijimtarinë popullore.

Fshati Sopot i lokalitetit të Zerqanit (Rrethi i Dibrës) ruan me shumicë banesa të trashëguara nga e kaluara[1], të cilat paraqesin interes si nga ana tipologjike dhe në drejtim të formulimit arkitektonik të tyre. Sopoti ka një shtrirje relativisht të madhe, ai fillon me lagjen Zall-Sopot të ndërtuar në një terren të ulët dhe që është pothuajse krejtësisht e shkëputur dhe shumë më e re[2] se katër lagjet e tjera (lagja e Mustafajve, Kodrasi, Lazari dhe Priftakë) që përbëjnë pjesën e vjetër të fshatit. Vendosja e këtyre në një terren kodrinor, me përbërje argjilore dhe me ujë[3] kanë favorizuar banorët e fshatit të merreshin me bujqësi, duke mos lënë mënjanë blektorinë, për të cilën kanë shërbyer kryesisht kullotat në afërsi të fshatit. Ndër katër lagjet e mësipërme lagja Priftakë është nga më të hershmet dhe përbën qendrën e fshatit. Këtu gjenden dhe shumica e banesave të vjetra të ndërtuara përgjithësisht mbi truall të rrafshët dhe relativisht afër njera tjetrës. Secila prej tyre ka oborrin e saj në pjesën e përparme, (nga ana e rrugës), ndërsa mbrapa banesës ndodhet parcela e kopshtit. Oborri qarkohet me mure rrethues që ashtu si ato të banesës kanë breza druri dhe në pjesën e poshtme janë prej guri ndërsa lart vazhdojnë me qerpiç. Në këtë pjesë të fshatit banesat formojnë ansamble me vlerë të konsiderueshme arkitektonike. Rrugët e shtruara me kalldrëm ndjekin pjerësinë e

---

+) Rivelimet janë të autorit, F. Zarshatit, K. Qatipit, M. Babës. Vizatimet janë bërë nga S. Terezi dhe F. Zarshati, fotot të autorit, R. Veselit. Projektet e restaurimit u hartuan nga autori i artikullit, ndërsa punimet e restaurimit u zbatuan nga Ateljeja e Monumenteve të Kulturës Tiranë, në vitin 1979 nën drejtimin e autorit dhe F. Topullit.

1) Sipas tregimeve të banorëve të fshatit periudha e ndërtimit të këtyre banesave shkon rreth 60 deri 170 vjet më parë. Njera prej banesave është gjetur e datuar me numra arabe që sipas kalendarit Hixhri shënon datën 1228 (1812). Me ndërtimin e banesave janë marrë kryesisht mjeshtër nga fshati Okshtun.

2) Lagjia Zall-Sopot është formuar prej banorëve të ardhur nga lagjia Kodrasi si dhe prej familjeve të ardhura nga fshatrat Godvijë, Krajkë, Strikçan, Ternovë. Banesat janë ndërtuar në të dy anët e rrugës që të çon në fshatin Zerqan. Terreni i përshtatshëm pranë rrugës Burrel-Peshkopi, uji për vaditje (tokat për prodhimin e produkteve bujqësore janë afër një dege të lumit Drin) kanë favorizuar krijimin e kësaj lagjeje të re.

3) Në fshat përveç prroit me prurje të konsiderueshme, uji i të cilit shërben dhe për vënjen në funksionim të mullirit të vjetër (i ndërtuar thuajse në qendër të fshatit) ka dhe disa burime sipërfaqësore që favorizojnë vaditjen e tokave.

DO NOT COPY



Fig. 1



Fig. 2

terrenit dhe kur kjo është e ndieshme nuk mungojnë dhe shkallëzimet tërthore. Pjesët e vjetra të kalldrëmit që ruhen ende janë ndërtuar me gurë të sheshtë të vendosur në mënyrë jo shumë të rregullt. Vetë banesat kanë kryesisht zhvillim vertikal, lartësia e tyre arrin 2-3 kate (fig. 1). Në përgjithësi në kompozimin e katit të sipërm bën pjesë qoshku karakteristik. Këto ndërtime të mbyllura e me shumë frengji pothuaj në të katër pamjet, flasin qartë për karakterin mbrojtës të tyre. Interesant na paraqitet rasti kur dy banesa të ndërtuara afër njera tjetrës për dy vëllezër megjithëse kanë komunikim të veçantë, të dy katet e sipërme i kanë të lidhura me urë të mbuluar (fig. 2).

Në fshat janë ndërtuar një numër i madh banesash të reja. Kompozimi planimetriko-volumor i tyre ndryshon nga ai i banesave të vjetra sepse kushtet ekonomiko-shoqërore dhe mënyra e jetesës kanë ndryshuar rrënjësisht. Megjithatë dhe në ndërtimet e reja është trashëguar përgjithësisht teknika e ndërtimit dhe pasqyrimi në to i disa elementeve funksionalë e dekorativë nga banesat e vjetra, faktor këto që bëjnë të mundur të arrihet një lidhje harmonike midis ndërtimeve të reja dhe atyre të trashëguara.

Banesa e parë që kemi marrë për studim është një ekzemplar mjaft shprehës i arkitekturës së banesave me qoshk[4]. Banesa ndodhet pothuajse në qendër të lagjes Priftakë (fig. 3) e ndërtuar në terren të rrafshët. Ajo është tre katshe duke u dalluar kë-



Fig. 3

4) P. Thomo **Banesat me qoshk në Shqipërinë e Veriut,** Etnografia Shqiptare Nr. VIII Viti 1976 f. 197.

shtu në drejtim të zhvillimit vertikal nga disa banesa më të ulta të ndërtuara pranë saj (fig. 4). Banesa është e pa datuar, por nga të dhëna të tjera rezulton se ndërtimi i saj i përket mesit të shek. XIX[5]. Secili kat i banesës përbëhet nga një ambient i vetëm (Tab. I, 1,3,5,6). Katin përdhes e ze «burgu» për futjen e bagëtive ndërsa në të dy katet e sipërme zhvillohej jeta familjare. Pamja e përgjithëshme e banesës na paraqet një volum prizmatik prej guri dhe qerpiçi[6] me faqe të rrafshta të formuar kryesisht nga dy katet e poshtme. Në këtë volum spikat kati i sipërm i gjallëruar nga qoshqet e dalura tej rrafshit të mureve. Të bie në sy qoshku verilindor i cili është i shoqëruar nga një koridor i hapur që vazhdon pothuajse deri në fund të pamjes veriore. Së fundi ky volum kurorëzohet nga çatija katër ujshe me strehë të gjerë. Ndërlidhja me dy katet e sipërme realizohet nëpërmjet shkallëve prej druri të ndërtuara në pamjen jugore. Shkallët janë dy rampshe. Rampa e parë që është vendosur normal me pamjen e më sipërme të çon drejt tek shesh pushimi para derës së hyrjes së katit të parë. Rampa e dytë kthen dhe i



Fig. 4



Fig. 5

mbështetet faqes së murit duke të lidhur me katin e sipërm (fig. 5). Në këtë mënyrë çdo kat ka komunikim të pavarur, gjë që i dallon dhe më tepër funksionet e dy kateve të sipërme. Katin e parë e përbën shtëpia e zjarrit ku gatuhej ushqimi dhe flinin njerëzit e shtëpisë. Ajo është e shtruar me dhe përmbi shtresën e drrasave. Në faqen lindore ndodhet oxhaku me vatër të madhe, tamburi i të cilit ka seksion

5) Ky përcaktim është arritur duke pasur për bazë kryesisht të dhënat e njerëzve të shtëpisë, dhe një banesë të kësaj periudhe në Shupenzë e cila ka ngjashmëri përsa i përket kompozimit të skemës së qarkullimit dhe materialit të ndërtimit me banesën që po studjojmë.

6) Në pjesën e poshtme deri në gjysmën e lartësisë së katit përdhes, muratura është e ndërtuar me gurë të lidhur me llaç balte dhe e qarkuar me breza druri horizontal. Brezat janë vendosur në të dy faqet e murit dhe lidhen me «kushakë» tërthor. Pjesa tjetër e muraturës është prej blloqesh qerpiçi me trashësi 15 cm gjërësi 15-25 cm dhe gjatësi 30-40 cm. Blloqet e qerpiçit janë prej argjili të ngjeshur të përzier me fije kashte. Dhe në këtë lloj murature nuk mungojnë brezat e drurit.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 6



Fig. 7

rrethor. Shtëpia e zjarrit është e paisur me dritare dhe dollapë muri. Ajo është e suvatuar[7] dhe pa tavan. Ambienti më paraqitës i banesës i cili zë thuajse të gjithë katin e sipërm është oda e miqve (Tab. I, 5). Në kompozimin e saj një vend të rëndësishëm zenë dy qoshqet që rrisin në mënyrë të ndjeshme sipërfaqen e dobishme. (sipërfaqja e tyre qëndron në raportin 1 : 3,5 me atë që ze oda dhe përbën rastin maksimal). Qoshku i madh është ndërtuar në anën veri-lindore (Tab. II, 6) nga ku kontrollohet mirë rruga dhe hyrja për në banesë. Dyshemeja e qoshkut është e shtruar me drrasa dhe ngrihet rreth 25 cm nga niveli i shtresës prej dheu të odës. Ai është ndërtuar me mure të hollë me skelet druri të veshur nga të dy anët me drrasa. Në mure janë ndërtuar dritare të vogla[8] të cilat ndriçojnë ambientin dhe nga ku soditet lirshëm natyra përreth duke përbërë në këtë mënyrë një vend të rehatshëm për ndejtje.

Restaurimi

Meqë ishte e vjetër, banesa u dëmtua rëndë në disa elementë të veçantë nga tërmeti i rënë në këtë zonë. Gjithashtu u konstatuan ndryshime të bëra gjatë kohës, si pasojë e të cilave ana funksionale dhe forma fillestare e mjaft elementeve përbërës të banesës ishte tjetërsuar. Kjo gjendje bëri të domosdoshëm studimin për restaurimin e saj, i cili u krye duke u mbështetur kryesisht në gjurmët e elementeve origjinalë.

Kati përdhes «burgu». Nuk kishte pësuar ndonjë ndryshim me rëndësi me përjashtim të hapjes së një dritareje në faqen veriore, e cila u mbyll gjatë ndërhyrjeve restauruese. Gjithashtu frengjia që ndodhej në faqen jugore pak e zmadhuar u restaurua duke rimarrë përsëri formën fillestare.

7) Shtresa e vjetër e suvasë që është gjendur në pak vende është bërë me baltë të përzier me hi dhe fije kashte të prerë hollë.

8) Megjithëse teknika e ndërtimit e dyshemesë dhe suvasë, forma e dollapeve të murit, oxhakut është e njëjtë me atë të shtëpisë së zjarrit trajtimi i elementeve, prej druri i odës së miqve është bërë me një përkujdesje të veçantë. Kjo vihet re në punimin e veshjes së mbrendshme me drrasa të qoshkut si dhe në trajtimin e elementeve të dritareve të cilat janë paisur me kapakë drrase rrëshqitës që futen në brendësi të skeletit prej druri. Në pjesën e sipërme ato kanë sergjen të gdhendur, ndërsa nga jashtë ato mbrohen me kafaz druri që arrin deri në gjysmën e lartësisë së dritares. Gjithashtu korniza prej druri e oxhakut dhe fashaturat që qarkojnë dollapin e kafes janë të profiluara.

Kati i parë (shtëpia e zjarrit). Në murin perimetral verior dukeshin gjurmët e derës së ambientit sanitar, volumi i të cilit dilte tej rrafshit të murit në fjalë. Mbas prishjes së këtij ambienti dera ishte murosur. Për mungesë të dhënash ky ambient nuk u rindërtua por u lanë të paprekura gjurmët e qenies së tij. Hapsira në faqen jugore u kthye gjatë restaurimit në dollap muri sepse gjatë sondazheve të bëra dolën në pah gjurmët e dy ndarjeve horizontale prej drrasash. Gjatë restaurimit të dyshemesë ashtu si në odën e miqve u ruajt përsëri teknika e vjetër e ndërtimit të saj.

Kati i dytë (oda e miqve) zë vendin kryesor në kompozimin e këtij kati, dëmtimet dhe ndryshimet e bëra në brendësi e jashtë saj ishin të konsiderueshme. Si rrjedhim dhe punimet restauruese qenë më të thella. Së pari parahyrja e odës ishte dëmtuar rëndë, megjithatë gjurmët e mbetura (fig. 5) hodhën dritë mbi formulimin fillestar të saj. Në parahyrje pa penguar kalimin për në brendësi të odës ndodhej një platformë e ngritur rreth 0,7 m e shtruar me drrasa dhe që dilte pak tej rrafshit të murit të faqes lindore. Në këtë element në formë dollapi gratë linin ushqimin e përgatitur në shtëpinë e zjarrit. Një vrimë e bërë në dyshemenë e dollapit tregon se ky element ka shërbyer edhe si sqoll për larjen e duarve (këtë element e gjejmë dhe në divanhanen e banesës së dytë). Gjurmët tregonin se nga ana jugore parahyrja ka qenë e mbyllur (e veshur me drrasa vertikale (Tab. II, 4). Në odën e miqve në faqen perëndimore ka qenë ndërtuar dhe qoshku i dytë (i vogli) (Tab. II, 1, 3) i cili ishte shumë i dëmtuar (Tab. I, 2). Në rindërtimin e tij ndihmuan elementet origjinalë të mbetur dhe gjurmët e atyre që ishin degraduar thuajse plotësisht. Së pari trarët konsol të mbetur në të gjithë gjatësinë na bënë të qartë gjerësinë dhe gjatësinë e qoshkut. Gjithashtu gjurmët e kllapave në fundin e trarëve dhe në pjesën e sipërme tek bishtat e strehës tregonin se muret e qoshkut ishin me skelet druri. Ndërsa mbushja me blloqe qerpiçi u bë duke pasë parasysh teknikën e ndërtimit të qoshqeve në banesat e vjetra të fshatit. Në vazhdim të qoshkut kryesor është ndërtuar koridori në fundin e të cilit ndodhet ambienti sanitar. Në vrojtimin e parë menduam se ky koridor ishte i mbyllur por mbas daljes në dritë të dy kamareve që përmbanin secila nga tre frengji (Tab. I, 5,



Fig. 8

fig. 6) të cilat i përkisnin fazës së parë u mendua që koridori të lihej i hapur i kufizuar me parmak druri. Në këtë restaurim një kujdes i veçantë iu kushtua dhe mureve rrethues dhe portës së hyrjes si pjesë përbërëse të monumentit. Restaurimi i këtij monumenti me vlerë të veçantë në gjininë e tij, sidomos punimet restauruese që u kryen në katin e dytë, bënë që monumenti të rifitonte në maksimum vlerat e humbura (Tab. I, 4, Tab. II. 2, 4).

Banesa e dytë. Ngrihet thuajse në periferi të të lagjes «Priftakë» në anën lindore të saj (fig. 7), buzë rrugës së vjetër të shtruar me kalldrëm. Ajo është ndërtuar rreth 60 vjet më parë[9]. Shembulli në fjalë duke u nisur kryesisht nga zhvillimi planimetrik[10] përbën një rast të veçantë i cili nuk mund të futet në grupin e banesave me qoshk. Banesa është dy katshe dhe shquhet për siluetën e saj horizontale nga ndërtimet përreth (Tab. III, fig. 8). Sheshin kundrejt pamjes kryesore e orjentuar nga perëndimi, e zë oborri i banesës i qarkuar nga të tre anët me mure rrethues (kryesisht prej qerpiçi). Në murin jugor ndodhet porta dy flegërshe e oborrit e mbuluar me çati. Banesa ka vetëm një hyrje të ndërtuar në pamjen kryesore nga e cila kalohet në brendësi të katit përdhes i cili ashtu si në shembullin e parë ka ndriçim të pakët. Ndërtimi i dy mureve tërthor në brendësinë e këtij kati që mbajnë muret e gjerë të katit të si-

9) Banesa është ndërtuar rreth viteve 1920-1925, kryesisht nga pronari i saj Hazis Hasa, i cili ka punuar si kryemjeshtër jo vetëm në banesën e tij por dhe në ndërtimin e disa banesave të fshatit dhe të atyre që gjënden në fshatrat përreth.

10) Zhvillimi planimetrik i katit të parë të kujton atë të disa banesave qytetare me çardak të mbyllur. Shih. E. Riza **Banesa popullore në Shkodër gjatë shek. XVIII-XIX,** Monumentet Nr. 4 viti 1972, f. 154.

DO NOT COPY



Fig. 9



Fig. 10

përmë kanë bërë që sipërfaqja e katit përdhes të jetë dy kthinëshe. Kthina më e madhe shërbente për stallë lopësh, ndërsa tjetra për futjen e bagëtive të imta. Shkallët e brendshme dy rampshe janë vendosur afër derës së hyrjes. Rampa e parë duke përfshirë dhe shesh pushimin është ndërtuar me gurë ndërsa e dyta prej druri nga e cila kalohet në divanhanen (çardak i gjerë) e katit të parë (Tab. III, 1). Divanhanja ka kryesisht funksion ndërlidhës për ambientet e tjerë dhe i paraprin ato, ajo zë një sipërfaqe relativisht të madhe, e cila qëndron në raportin 2 : 2,5 me atë që zënë së bashku; shtëpia e zjarrit, oda e miqve dhe hamami (banjo). Ajo mer ndriçim të bollshëm nga 2 radhë dritaresh të harkuara të mbrojtura nga ana e brendshme me kapakë druri rëshqitës. Dritaret janë vendosur në murin kufizues perëndimor i ndërtuar me skelet druri dhe blloqe qerpiçi, ana e jashtme e tij është e veshur me drrasa të gjera vertikale. Në këtë faqe (në mezin e saj) ndodhet sqolli në formën e dollapit. Pjesa fundore afër odës së miqve ka shërbyer si qoshk, ndërsa në faqen lindore shohim të ndërtuar dy oxhakët e kafesë dhe kamaret e zakonshme pranë tyre (Tab. IV, 2). Ndonëse pa tavan dhe e shtruar me dhe të ngjeshur përmbi shtresën e drrasave por e suvatuar ashtu si ambientet e tjerë, divanhania duke pasur karakteristikat e mësipërme përbën një ambient të rehatshëm për çlodhje, nga ku soditet lirshëm natyra përreth, gjithashtu në muajt e nxehtë të verës ajo shërbente dhe për fjetje. Shtëpia e zjarrit është ambienti kryesor i banesës në të cilin zhvillohej jeta e gjallë e familjes. Në këtë ambient përgatitej ushqimi, hahej dhe flinin njerëzit e shtëpisë. Ajo zë një sipërfaqe që është thuajse sa dyfishi i odës së miqve. Ndriçimi i ambientit përfitohet nga dy dritare të ndërtuara në faqen jugore (madhësia dhe elementet përbërës së tyre janë të njëllojtë me ato të banesës së parë). Dera e vendosur në faqen lindore të lidh me ambientin sanitar i ndërtuar jashtë volumit të ndërtimit (Tab. II, 2, 4). Elementi më i rëndësishëm i shtëpisë së zjarrit është vatra e ndërtuar në mes të saj, sipër së cilës ka qenë ndërtuar «koshi« për mbledhjen e tymit, që dilte pastaj nga të çarat e mbulesës. Përmbi zjarrin varej «kamostra» (zinxhir hekuri) për vendosjen e enëve (Tab. III, 4). Ambienti është i paisur gjithashtu me orendi të ndryshme si dollapë muri, kamare për vendosjen e ushqimeve dhe enëve. Ndër orenditë më të rëndësishme është arka e bukës e cila vendosej në një qoshe të ambientit. Ushqimi shërbehej si zakonisht në sofër të rrumbullakët prej druri, ku për të ndejtur shtroheshin postiqe ose stola të vegjël. Në pjesën veri lindore në vazhdim të shtëpisë së zjarrit e ndarë prej saj nga një mur tërthor i gjerë prej qerpiçi gjëndet oda e miqve. Megjithëse me volum më të vogël ajo ka ndriçim më të shumtë se shtëpia e zjarrit. Më e trajtuara nga faqet kufizuese të saj është ajo veriore në të cilën janë ndërtuar dritaret dhe oxhaku me tambur me seksion katërkëndësh kënddrejtë i cili vazhdon me shkallëzime deri në pjesën e sipërme. Trajtimi i elementeve prej druri në këtë ambient është bërë me një përkujdesje të veçantë. (Fashaturat që qarkojnë dritaret dhe kamaret janë të profiluara).

Restaurimi

Dhe në këtë banesë ndërhyrjet restauruese qenë relativisht të mëdha sidomos në disa ambiente të veçantë, ku u vunë re dëmtime dhe ndryshime të

DO NOT COPY

bëra gjatë kohës, të shkaktuara këto nga të njëjtët faktorë që përmëndëm në shembullin e parë. Gjithashtu ndonëse me ndryshime të vogla dhe problematika restauruese qe e njëllojtë.

Kati përdhes. Ambientet e këtij kati nuk kishin pësuar ndonjë ndryshim dhe gjendja teknike e elementeve përbërës në përgjithësi ishte e mirë. Gjatë restaurimit u plotësuan elementet e degraduar të derës së hyrjes, asaj të stallës dhe dritaret e faqes jugore.

Kati i parë. (shtëpia e zjarrit). Ndryshimi i vetëm dhe më kryesori në këtë ambient ishte heqja e vatrës dhe i koshit nga vetë banorët. Duke qenë se gjurmët e saj egzistonin akoma u vendos që kjo të plotësohej, dhe koshi të rindërtohej[11] sepse në këtë mënyrë ambientit do ti rikthehej përsëri vlera që kishte ai fillimisht në drejtim të formulimit origjinal të brendësisë së tij (Tab. IV, 3, 4).

Oda e miqve. Megjithëse pjesa më e madhe e elementeve përbërës të brendësisë së saj ishin pjesërisht ose plotësisht të degraduara ato ruanin të pa cenuar formën origjinale, faktor ky që lehtësoi mjaft në restaurimin e tyre (Tab. IV, 5, 6).

Divanhania. Në këtë ambient përveç dëmtimeve të pësuara në elementë të ndryshëm, ishin bërë dhe disa ndryshime që kishin cënuar në shkallë të ndjeshme kompozimin fillestar. Prandaj e pamë me vend të ndalemi më gjatë në argumentimin e tyre. Së pari u konstatua se dy ndarjet e holla tërthore të ndërtuara me skelet druri dhe të suvatuara (si rezultat i ndërtimit të tyre ishin krijuar dy ambiente të rinj në brendësi të divanhanes) ishin të mëvonshme për vetë faktin se suvaja dhe bojatisja me gëlqere në pjesën ku mbështeteshin shtyllat vertikale të skeletit nuk ishin cënuar. Prandaj këto ndarje gjatë restaurimit u hoqën. Fillimisht menduam se dyshemeja prej drrasash në vendin ku përdorej si qoshk ishte origjinale, (sepse thuajse në të gjithë qoshqet dyshemetë i kanë më të lartësuar se ato të ambientit) por lartësia e fillimit të dritareve të qoshkut nga dyshemeja rezultonte shumë e vogël (rreth 15 cm) gjë që s'ishte aspak e justifikueshme nga ana funksionale. Gjithashtu fillimi i kanalit të tymit të oxhakut ndodhesh nën nivelin e dyshemesë në fjalë (Tab. IV, 1), prandaj nxorëm konkluzionin se ajo ishte e mëvonshme, dhe duhej të hiqej. Heqja e shtesave të mësipërme dhe plotësimi i tambureve të oxhakëve bënë që divanhanja të rifitojë përsëri vlerat e humbura (Tab. IV, 2).



Fig. 11

Hamami (banja). Ky ambient u gjet mjaft i dëmtuar. Muri me skelet druri, që e kufizonte këtë nga ana jug lindore ishte i rrëzuar (fig. 9), Megjithatë vendimi për plotësimin e tij u pa i arsyeshëm dhe i mundshëm, sepse kishin mbetur ende gjurmë që hidhnin dritë mbi formulimin fillestar. të tij. Së pari egzistenca e trarëve konsol të dyshemesë ndonse të degraduara ruanin përmasat fillestare. Së dyti gjurmët e kllapave në bishtat e strehës (bishti i fundit i kllaposur binte në një drejtim me traun e fundit të dyshemesë) tregonin se aty mbërthehej tabani i sipërm horizontal i skeletit prej druri. Dyshimi se ky mur kufizues i banjos mund të ishte me teknikën e atij të pamjes kryesore, u hodh poshtë, sepse, si në brezin e murit perimetral, ashtu dhe në kokat e trarëve konsol, mungonin gjurmët ku mbërtheheshin pajantat mbajtës. Prandaj ky skelet u vesh nga ana e jashtme vetëm me drasa vertikale ashtu si tek ambienti sanitar. Restaurimi i banjos përveç plotësimit të anës funksionale bëri që të rritej në maksimum vlera arkitektonike e pamjes jugore (fig. 10). Gjatë restaurimit të çatisë u ruajtën të pa prekura një pjesë e konsiderueshme e elementeve origjinalë sidomos ato që përbënin strehën e saj. Ndërhyrje pati dhe në muret rrethues si pjesë përbërëse të monumentit.

Mbas restaurimit vlera arkitektonike e të gjithë pamjeve të monumentit u rrit në mënyrë të ndjeshme. Veçanërisht kjo u pa në pamjen kryesore[12] (fig. 11).

11) «Koshi» u rindërtua duke pasur parasysh gjurmët e tij dhe një të tillë të ruajtur akoma në një nga banesat e vjetra të fshatit që rezultonte nga mjeshtri që ndërtoi edhe banesën në shqyrtim.

12) Formulimi arkitektonik i kësaj pamje dhe pjesërisht i asaj jugore, të kujton karakterin e pamjeve kryesore të banesës së Çermenikës.

Domotoria

TAB. I

DO NOT COPY

BANESE NE FSHATIN SOPOT
DIBER



1 KATI PERDHES
(PAS RESTAURIMIT)

Shpjegim
SHTESA TE HEQURA GJATE RESTAURIMIT
SHTESA TE LENA GJATE RESTAURIMIT
MBUSHJE GJATE RESTAURIMIT



2



3 KATI I I
(PAS RESTAURIMIT)

PAMJE PERENDIMORE
PARA RESTAURIMIT



PAMJE PERENDIMORE
PAS RESTAURIMIT
4



KATI I II
(PAS RESTAURIMIT)
5

0 1 2 3 4m.



PRERJE A-A
(PAS RESTAURIMIT)
6

DO NOT COPY

Çmimi 10 lekë